



**PARTNERËT** SHQIPËRI  
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

METODOLOGJIA  
E VLERËSIMIT  
TË RREZIKUT TË OJF-VE  
NDAJ FINANCIMIT  
TË TERRORIZMIT  
NË SHQIPËRI



2022

© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara.  
Tiranë, Shqipëri 2022

Ky raport u përgatit nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me mbështetjen e Projektit Global 'Lufta kundër qarkullimit të paligjshëm të fondeve', i zbatuar nga GIZ dhe i financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë.

Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e GIZ, Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, apo të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë.



Implemented by

**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



Norwegian Ministry  
of Foreign Affairs

## PJESA 1 - Raporti i Rrezikut të Qenësishëm

A. Hyrje.....	1
B. Metodologjia.....	3
C. Përmbledhja Ekzekutive.....	7
D. FATF-ja për OJF-të.....	10
E. Profili i FATF-së për OJF-të në Shqipëri.....	14
F. Natyra e kërcënimit të FT-së ndaj OJF-ve në Shqipëri.....	20
G. Identifikimi i OJF-ve potencialisht “në rrezik” nga financimi i terrorizmit.....	26
Shtojca 1. Rekomandimet e FATF-së të rëndësishme për OJF-të.....	38
Shtojca 2. Kategorizimi i vendeve sipas rrezikut terrorist.....	41

## PJESA 2 - Raporti i Rrezikut të Mbetur

A. Hyrje.....	1
B. Metodologjia.....	4
C. Përmbledhja Ekzekutive dhe Vlerësimi i Rrezikut të Mbetur.....	10
D. Analiza e mangësive.....	14
E. Organizata me veprimtari humanitare dhe bamirëse.....	24
F. Veprimtaria bamirëse dhe/ose edukative e organizatave fetare.....	29
G. Shuma të mëdha të financimeve të huaja nga burime me rrezik të lartë.....	33
H. Përdorimi i parave fizike (cash) ose transaksioneve alternative jashtë sistemit zyrtar bankar.....	38
I. Aktivitete në zona të thella.....	42
J. Politika e rivlerësimit.....	45
Shtojca 1. Rekomandimet e FATF-së të rëndësishme për OJF-të.....	46



Pjesa e parë

VLERËSIMI I RREZIKUT  
PËR FINANCIMIN E  
TERRORIZMIT  
NË SEKTORIN E  
OJF-VE NË SHQIPËRI

Raporti i Rrezikut të  
Qenësishëm

## Shkurtime

AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
BSh	Banka e Shqipërisë
DPPPP	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
FATF	Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar
FT	Financimi i Terrorizmit
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH
MF	Ministria e Financave
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MONEYVAL	Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
OJF	Organizata jofitimprurëse
PPP/LFT	Parandalimi i Pastrimit të Parave / Lufta kundër Financimit të Terrorizmit
PP	Pastrimi i Parave
PSh	Policia e Shtetit
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
RVN	Raporti i Vlerësimit të Ndërsjelltë
VKRR	Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut

# A. HYRJE

## Konteksti për Vlerësimin e Rrezikut

1. Fushata e vazhdueshme ndërkombëtare kundër financimit të terrorizmit identifikoi tipologji në mbarë botën ku terroristët dhe organizatat terroriste shfrytëzojnë sektorin e Organizatave Jofitimprurëse (OJF-ve) nëpërmjet: mbledhjes, konsolidimit/grumbullimit, transferimit, shpërndarjes dhe përdorimit të fondeve të mbledhura (ajo që njihet edhe si cikli i financimit); ofrimin të mbështetjes logjistike; nxitjes së rekrutimit të terroristëve; ndryshe mbështetjes së organizatave dhe operacioneve terroriste; krijimit të fushatave mashtruese bamirësie; ose përfshirjes në skema mashtruese të gjenerimit të të ardhurave për qëllime të tilla.
2. Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF) është organi ndërkombëtar i përcaktimit të standardeve në fushën e Parandalimit të Pastrimit të Parave/Luftës kundër Financimit të Terrorizmit (PPP/LFT). Një prej standardeve dhe një prej Rezultateve të Drejtpërdrejta të FATF-së i referohen drejtpërdrejtë OJF-ve - këto përfshijnë Rekomandimin 8 dhe Rezultatin e Drejtpërdrejtë 10 (shih Shtojcën 1).
3. Rekomandimi 8 dhe Rezultati i Drejtpërdrejtë 10 i FATF-së kërkojnë që vendet, si fillim, të identifikojnë nëngrupin e organizatave që bëjnë pjesë në përkufizimin e FATF-së për OJF-të dhe të përdorin të gjitha burimet përkatëse të informacionit me qëllim identifikimin e tipareve dhe llojeve të OJF-ve, të cilat për shkak të aktiviteteve ose karakteristikave të tyre, kanë të ngjarë të jenë në rrezik të abuzimit të financimit të terrorizmit.
4. Shqipëria është anëtare e MONEYVAL (Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit) organi rajonal i FATF-së për Evropën. MONEYVAL përgatiti raportin e parë të vlerësimit për Shqipërinë në vitin 2001 dhe që nga ajo kohë vendi ka kaluar pesë runde vlerësimesh nga FATF-ja. Raporti i fundit i Vlerësimit të Ndërsjellë (RVN) i MONEYVAL për Shqipërinë lidhur mbi përputhshmërinë me standardet e FATF-së, u publikua në korrik 2018<sup>1</sup>, i ndjekur nga raportet përkatëse përcjellëse të vitit 2019 (Raporti i 1-rë Përcjellës – i Zgjeruar) dhe të vitit 2021 (Raporti 2-të Përcjellës – i Zgjeruar)<sup>2</sup>.
5. RVN-ja e fundit e vlerësoi Rekomandimin 8 si Pjesërisht në Përputhje dhe efektivitetin sipas Rezultatit të Drejtpërdrejtë 10, të Moderuar. Çështjet kryesore që u identifikuan janë si më poshtë:
  - » Analiza mbi sektorin e OJF-ve nuk ka identifikuar ato në rrezik ndaj abuzimit të Financimit të Terrorizmit (FT) dhe natyrën e kërcënimeve të paraqitura.
  - » Nuk është ndërmarrë asnjë rishikim i kuadrit ligjor dhe masave nga këndvështrimi i FT-së.
  - » Shqipëria nuk ka politika të qarta, për të promovuar përgjegjshmërinë, integritetin dhe besimin e publikut në administrimin dhe menaxhimin e OJF-ve.
  - » Shqipëria ka një kontaktim (outreach) të kufizuar në sektorin e OJF-ve dhe komunitetin e donatorëve në lidhje me çështjet e FT-së.
  - » Shqipëria nuk ka asnjë dokument të praktikave më të mira të hartuar me përfshirjen e OJF-ve.
  - » Shqipëria nuk ka ndërmarrë hapa për të promovuar mbikëqyrjen ose monitorimin sipas një qasjeje të bazuar në rrezik ndaj OJF-ve. Kompetencat mbikëqyrëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) janë të kufizuara dhe nuk mbulojnë gjerësisht aspektet e LFT-së.

<sup>1</sup> MONEYVAL, 2018, "Masat Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Raporti i Raundit të 5-të i Vlerësimit të Ndërsjellë për Shqipërinë" [Online] <https://rm.coe.int/committee-of-experts-on-the-evaluation-of-anti-money-laundering-measur/1680931f70>

<sup>2</sup> Të gjitha raportet janë dokumente të aksesueshme për publikun në faqen e internetit të Këshillit të Evropës.

6. Në dhjetor 2019, MONEYVAL publikoi Raportin e Parë Përcjellës të Zgjeruar<sup>3</sup>, dhe vendosi që Shqipëria të qëndrojë me të njëjtin status “për përmirësime të mëtejshme” dhe të vazhdojë të raportojë në MONEYVAL mbi progresin e mëtejshëm për të forcuar zbatimin e kërkuar të masave PPP/LFT. Në këtë raport, Rekomandimi 8 u rivlerësua si Gjerësisht në Përputhje. Rivlerësimi u bazua në arritjet e mëposhtme:
- » Shqipëria ka kryer një raund të dytë të rishikimit të Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut (VKRR) të PP-së dhe FT-së, i cili përfshiu një vlerësim të përgjithshëm të rrezikut rreth cënueshmërisë dhe kërcënimeve të OJF-ve.
  - » Gjithashtu, Shqipëria ka miratuar udhëzimet e reja “Për Mbikëqyrjen e Organizatave Jofitimprurëse në funksion të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit” (Udhëzimet) duke përmirësuar bashkëpunimin ndërinstytucional ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP<sup>4</sup>) dhe DPT-së në lidhje mbi mbikëqyrjen e OJF-ve, të cilat parashikojnë publikimin e një raporti vjetor për çështjet e identifikuar në lidhje me OJF-të e mbikëqyrura dhe rivlerësimin periodik të sektorit të OJF-ve. Udhëzimet parashikojnë gjithashtu masa për mbikëqyrjen dhe monitorimin e OJF-ve nga DPT-ja duke zbatuar qasjen e bazuar në rrezik.
  - » Gjithashtu, Shqipëria ka prezantuar disa masa të rëndësishme për të promovuar përgjegjshmërinë, integritetin dhe besimin e publikut në administrimin dhe menaxhimin e OJF-ve, nëpërmjet ndryshimeve në Ligjin për Procedurat Tatimore dhe nëpërmjet Udhëzimit “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Këto masa përfshijnë detyrimin që OJF-të të kenë një llogari bankare dhe ta deklarojnë atë në administratën tatimore. Kjo kërkesë e re inkurajon OJF-të të kryejnë transaksione nëpërmjet kanaleve financiare të rregulluara. Ndryshimet në Ligjin për Procedurën Tatimore gjithashtu vendosën sanksione për mospërbushjen e detyrimeve lidhur me regjistrimin apo përditësimin e të dhënave.
  - » Për sa i përket shtrirjes me sektorin e OJF-ve mbi cënueshmëritë e mundshme të OJF-ve në lidhje me çështjet e FT-së, DPT-ja ka zhvilluar disa takime me përfaqësues të sektorit të OJF-ve duke ndarë dhe shkëmbyer informacionin përkatës mbi rreziqet e FT-së.
7. Megjithatë, Shqipëria ka ende nevojë të hartojë dokumentin përkatës të praktikave më të mira me përfshirjen e sektorit të OJF-ve.
8. Raporti i fundit Kombëtar i Vlerësimit të Rrezikut për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, daton në vitin 2019, dhe është realizuar nga një sërë autoritetesh shtetërore, nën koordinimin e DPPPP – i cili nuk është publik.
9. Për sa i përket sektorit të OJF-ve, deri më sot, nuk ka asnjë raport specifik të vlerësimit të rrezikut të OJF-ve për Shqipërinë.

<sup>3</sup> MONEYVAL, 2019, “Masat Kundër Pastrimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Raporti Pasues” [Online] <https://rm.coe.int/committee-of-experts-on-the-evaluation-of-anti-money-laundering-measur/1680931f70>

<sup>4</sup> Njësia e Inteligjencës Financiare në Shqipëri është Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave



# B. METODOLOGJIA

10. Qëllimi i këtij vlerësimi të rrezikut është kryerja e një rishikimi gjithëpërfshirës për të kuptuar karakteristikat dhe llojet e OJF-ve në rrezik ndaj abuzimit të FT-së dhe natyrën e kërcënimit.
11. Standardet e FATF-së “nuk paraqesin një metodë apo format të veçantë mbi vlerësimin e rrezikut” të financimit të terrorizmit për OJF-të.<sup>5</sup>
12. Praktikrat më të mira për vlerësimin e rrezikut të sektorit të OJF-ve përfshihen në Udhëzuesin e FATF-së mbi Vlerësimin e Rrezikut ndaj Financimit të Terrorizmit (FATF, 2019). Për më tepër, Udhëzimi i FATF-së: Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (FATF, 2013) ofron udhëzime për vlerësimet e rrezikut në përgjithësi.
13. Ky vlerësim rreziku synon që të përmbushë kërkesat dhe udhëzimet e FATF-së. Paragrafi 8.1 i Metodologjisë së FATF-së thotë se shtetet duhet:
- (a) Pa paragjykuar kërkesat e Rekomandimit 1, meqenëse jo të gjitha OJF-të paraqesin një rrezik të lartë (disa mund të përfaqësojnë pak ose aspak rrezik), shtetet duhet të identifikojnë se cili grup i organizatave bën pjesë në përkufizimin e FATF-së për OJF-të. Për të arritur këtë, vendet duhet të përdorin të gjitha burimet përkatëse të informacionit, në mënyrë që të identifikojnë tiparet dhe llojet e OJF-ve, të cilat për shkak të aktiviteteve ose veçorive të tyre, mund të jenë në rrezik nga abuzimi i financimit terrorist;
  - (b) të identifikojnë natyrën e kërcënimeve të paraqitura nga subjektet terroriste ndaj OJF-ve të cilat janë në rrezik, si dhe mënyrën se si aktorët terroristë abuzojnë me OJF-të e caktuara;
  - (c) të rishikojnë përshtatshmërinë e masave, përfshirë ligjet dhe rregulloret, që kanë të bëjnë me nëngrupin e OJF-ve që mund të abuzohen për mbështetjen e financimit të terrorizmit, në mënyrë që të jenë në gjendje të ndërmarrin veprime proporcionale dhe efektive për të adresuar rreziqet e identifikuara; dhe
  - (d) të rivlerësojnë periodikisht sektorin duke riparë informacionin e ri mbi cënueshmëritë e mundshme të sektorit ndaj aktiviteteve terroriste, për të siguruar zbatimin efektiv të masave.
14. Metodologjia e përdorur nga Shqipëria për vlerësimin e rrezikut të OJF-ve është krijuar për të përmbushur kërkesat e mëposhtme:

Parag.	Kërkesa	Seksioni përkatës
8.1(a)	të identifikojë se cili nëngrup organizatash bën pjesë në përkufizimin e FATF-së për OJF-të.	Pjesa C: “Qëllimi i këtij Raporti”
8.1(a)	të identifikojë tiparet dhe llojet e OJF-ve të cilat për shkak të aktiviteteve ose karakteristikave të tyre, kanë të ngjarë të jenë në rrezik të abuzimit me financimin e terrorizmit.	Pjesa F: “Identifikimi i OJF-ve potencialisht në rrezik të financimit të terrorizmit”
8.1(b)	të identifikojë natyrën e kërcënimeve të paraqitura nga subjektet terroriste ndaj OJF-ve të cilat janë në rrezik, si dhe mënyrën se si aktorët terroristë abuzojnë OJF të tilla.	Pjesa E: “Identifikimi i natyrës së kërcënimit”

<sup>5</sup> Udhëzime për Vlerësimin e Rrezikut të Financimit të Terrorizmit (FATF, 2019)

15. Ky vlerësim rreziku do të plotësohet nga një vlerësim i veçantë i përshtatshmërisë së masave zbutëse. Vlerësimi do të “të rishikojë përshtatshmërinë e masave, përfshirë ligjet dhe rregulloret, që kanë të bëjnë me nëngrupin e OJF-ve që mund të abuzohen për mbështetjen e financimit të terrorizmit, në mënyrë që të jenë në gjendje të ndërmarrin veprime proporcionale dhe efektive për të adresuar rreziqet e identifikuara” në përputhje me paragrafin 8.1(c) të Metodologjisë të FATF-së.
16. Vlerësimi aktual i rrezikut përdor të dhëna cilësore dhe sasiore, dhe në përputhje me udhëzimet e FATF-së<sup>6</sup>, kërkon të sigurojë që të dhënave cilësore t’u jepet pesha e duhur. Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke patur parasysh mungesën e të dhënave sasiore për rrezikut e FT-së në sektorin e OJF-ve në Shqipëri.
17. Vlerësimi i rrezikut u hartua duke përdorur një metodologji të ofruar nga Greenacre Associates. Ai u zbatua nga një Ekip Lokal i Vlerësimit dhe u mbikëqyr nga Grupi Mbikëqyrës i Metodologjisë së Vlerësimit të Rrezikut të OJF-ve, i përbërë nga përfaqësues të institucioneve dhe organizatave të mëposhtme:
- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)
  - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)
  - Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë (KNFSh)
  - Prokuroria e Përgjithshme (PP)
  - Policia e Shtetit Shqiptar
  - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Zyra përgjegjëse për regjistrin e OJF-ve)
  - Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri (CVE)
  - Komiteti Shtetëror për Kultet
  - Komuniteti Mysliman Shqiptar
  - Dorcas Aid International Albania
  - Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS
  - Qendra “Hapa të Lehta”
  - Qendra “Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim” (SCiDEV)

## Të dhënat dhe burimet

18. Për kryerjen e këtij vlerësimi janë përdorur informacione parësore dhe burimet e të dhënave si më poshtë:
- **Kërkesa për të dhëna dhe pyetësi.** Kërkesat me shkrim mbi të dhëna për financimin e terrorizmit në sektorin e OJF-ve, rastet studimore dhe anketimi i perceptimeve mbi rrezikun e FT-së, kërcënimeve dhe cënueshmërive të FT-së u siguruan nga përfaqësues të agjencive të mëposhtme:
- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)
  - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)
  - Prokuroria e Përgjithshme (PP)
  - Policia e Shtetit Shqiptar
  - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Zyra që është përgjegjëse për regjistrin e OJF-ve)
  - Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri (CVE)
  - Komiteti Shtetëror për Kultet
  - Banka e Shqipërisë
  - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)

<sup>6</sup> “Edhe pse vlerësimet sasiore (d.m.th., të bazuara kryesisht në statistika) mund të duken shumë më të besueshme dhe kanë mundësi për t’u përsëritur me kalimin e kohës, mungesa e të dhënave sasiore të disponueshme në fushën e PP/FT e bën të vështirë mbështetjen vetëm në një informacion të tillë. Për më tepër, informacioni për të gjithë faktorët përkatës mund të mos shprehet ose shpjegohet në formë numerike ose sasiore, dhe ekziston rreziku që vlerësimet e rrezikut që mbështeten më shumë në informacionin sasior të disponueshëm mund të jenë të njëanshme ndaj rreziqeve që janë më të lehta për tu matur dhe zhvlerësojnë ato për të cilat informacioni sasior nuk është i disponueshëm. Për këto arsye, këshillohet që të plotësohet një vlerësim i rrezikut të PP/FT me informacion cilësor përkatës të tillë si i përshtatshëm, informacion i inteligjencës, gjykime të ekspertëve, të dhëna të sektorit privat, raste studimore, vlerësime tematike, studime tipologjish dhe të tjera (rajonale ose ndërkombëtare) vlerësimet e rrezikut, përveç të dhënave sasiore të disponueshme.” Paragrafi 30-31, Udhëzimi i FATF: Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (FATF 2013).

- **Pyetësori.** Anketimi i perceptimeve për rreziqet, kërcënimet dhe cënueshmëritë e FT-së për OJF-të janë marrë nga përfaqësues të Institucioneve Financiare (7 institucione bankare dhe 8 institucione jo bankare):

- Alpha Bank
- BKT
- Banka Credins
- Fibank
- Banka OTP
- Tirana Bank
- Union Bank
- EasyPay
- AK Invest
- Crimson Finance Fund Albania
- Final
- Fondi Besa
- Kastrati
- Micro Credit Albania
- Raiffeisen Leasing Albania

- **Intervistat:** Intervistë ballë për ballë me Kishën Orthodokse Autoqefale Shqiptare.

- **Anketimi me OJF-të:** Një anketim me 153 OJF, nga 2,372 OJF aktive të regjistruara në DPT deri në maj 2021, u krye mbi perceptimin e rrezikut të FT-së dhe efektivitetin e masave zbutëse. Kampioni u zgjodh rastësisht nga lista e OJF-ve aktive të ofruara nga DPT dhe kontaktet u nxorrën nga databaza e OJF-ve e Partnerëve Shqipëri. Pjesëmarrja në anketim u bazua në gatishmërinë e OJF-ve për të marrë pjesë në të. Anketimi u krye gjatë periudhës korrik – gusht 2021 nëpërmjet telefonit. Niveli i besimit është 80% dhe vlera reale është brenda ±5% të vlerës së matur/anketuar.

- **Rishikimi ligjor.** Rishikimi ligjor konsistoi në ligjet dhe rregulloret e mëposhtme:

- Ligji nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.<sup>7</sup>;
- Ligji nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar (“Ligji për PPP”<sup>8</sup>);
- Ligji nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar (“Ligji i OJF-ve”)
- Ligji nr.8789, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”; dhe Ligji nr. 80/2021 datë 02.08.2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”;
- Ligji nr.119/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”;
- Ligji nr.112/2020 “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues”;
- Ligji nr.154, datë 17.12.2020 “Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare”;
- Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Ligjin e Procedurave Tatimore”, i ndryshuar;
- Ligji nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor”, i ndryshuar;
- Ligji nr.8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9640, datë 9.11.2006 “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimin”<sup>9</sup>;
- Ligji nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar”;
- Ligji nr.8391, datë 28.10.1998 “Për shërbimin informativ shtetëror”, i ndryshuar.<sup>10</sup>
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave 16/2009;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave 19/2019;
- Vendimi nr.44/2009 i Bankës së Shqipërisë;dhe
- Dispozita të tjera ligjore përkatëse.

<sup>7</sup> Neni 46 i Kushtetutës Shqiptare “Liria e Organizimit”.

<sup>8</sup> Ligji nr.9917/2008.

<sup>9</sup> Ndryshuar me ligjin nr.9807, datë 20.09.2007.

<sup>10</sup> Ligji nr.8391, datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ Shtetëror”, i ndryshuar, neni 9, parashikon: “Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) nuk ushtron veprimtari ushtarake apo policore. Pasi SHISH krijon bindjen për shkelje të ligjit, informon institucionin përkatës, duke mbrojtur burimet dhe metodat e informimit”.

**19.** Raportet e mëposhtme për PPP/LFT për Shqipërinë u morën në konsideratë:

- o Raporti i Vlerësimit të ndërsjellë të MONEYVAL për Shqipërinë 2018<sup>11</sup>
- o Raporti i parë Përcjellës i Përmirësuar i MONEYVAL, dhjetor 2019<sup>12</sup>
- o Raporti i 2-të Përcjellës, i Përmirësuar, prill 2021<sup>13</sup>
- o Raporti i Vlerësimit për Kuadrin Ligjor dhe Rregullator mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftën kundër Financimit të Terrorizmit për Organizatat Jofitimprurëse në Shqipëri<sup>14</sup>.
- o Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë 2020<sup>15</sup>.
- o Raporti Vjetor për Terrorizmin në Botë nga Departamenti Amerikan i Shtetit 2020<sup>16</sup>.
- o Raporti i Progresit i Bashkimit Evropian - 2021<sup>17</sup>.

**20.** Informacioni dhe të dhënat dytësore të mëposhtme u përdorën për hartimin e këtij raporti. Informacioni dhe të dhënat dytësore nuk patën të njëjtën peshë si të dhënat parësore. Ato u përdorën jo vetëm për të ushqyer qasjen metodologjike, por edhe për të plotësuar me informacion vlerësimin për ato çështje ku të dhënat parësore nuk ishin të disponueshme:

- o Shënimi interpretues për Rekomandimin 8 (shih Standardet Ndërkombëtare për Luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe Përhapjes së Armëve të Shkatërrimit në Masë) – Rekomandimet e FATF-së (2012, përditësuar 2016).
- o Metodologjia për Vlerësimin e Përputhshmërisë Teknike me Rekomandimet e FATF-së dhe Efektivitetin e Sistemeve PPP/LFT (FATF, 2013).
- o Praktikrat më të mira ndërkombëtare: Lufta kundër Abuzimit të Organizatave Jofitimprurëse (FATF, 2015).
- o Rreziku i Abuzimit Terrorist në Organizatat Jofitimprurëse (FATF, 2014).
- o Udhëzimi për Vlerësimin e Rrezikut të Financimit të Terrorizmit (FATF, 2019).
- o Përgjigjja nga Forumi Konsultativ i Sektorit Privat të FATF-së (Vjenë, Mars 2016).

<sup>11</sup> <https://rm.coe.int/committee-of-experts-on-the-evaluation-of-anti-money-laundering-measur/1680931f70>

<sup>12</sup> <https://rm.coe.int/anti-money-laundering-and-counter-terrorist-financing-measures-albania/16809988c0>

<sup>13</sup> <https://rm.coe.int/moneyval-2021-2-fur-albania/1680a2982c>

<sup>14</sup> <https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2021/07/Assessment-Report-on-Legal-and-Regulatory-Framework-on-Anti-Money-Laundering-for-NPOs.pdf>

<sup>15</sup> [https://www.bankofalbania.org/Publications/Annual\\_Report\\_2020.html](https://www.bankofalbania.org/Publications/Annual_Report_2020.html)

<sup>16</sup> [https://www.state.gov/wp-content/uploads/2021/07/Country\\_Reports\\_on\\_Terrorism\\_2020.pdf](https://www.state.gov/wp-content/uploads/2021/07/Country_Reports_on_Terrorism_2020.pdf)

<sup>17</sup> [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2021\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2021_en)

# C. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

- 21.** Kjo metodologji e vlerësimit të rrezikut të OJF-ve u zbatua në kuadrin e një Marrëveshjeje Mirëkuptimi ndërmjet Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ). Ajo u finalizua me mbështetjen e Greenacre Associates përmes financimit të GIZ. Metodologjia është në përputhje me angazhimin e Qeverisë së Shqipërisë si anëtare e Rrjetit Global të Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (FATF)<sup>18</sup> për të luftuar financimin e terrorizmit.
- 22.** Vlerësimi i rrezikut plotëson kërkesat thelbësore të FATF-së në lidhje me Rekomandimin 8 dhe Rezultatin e Drejtpërdrejtë 10. Në mënyrë të veçantë, paragrafi 8.1 i Metodologjisë së FATF-së deklaron se vendet duhet:
- 8.1 (a) të identifikojnë se cilat nëngrupe të organizatave bëjnë pjesë në përkufizimin e FATF të OJF-ve...;
- (a) të identifikojnë tiparet dhe llojet e OJF-ve të cilat për shkak të aktiviteteve ose karakteristikave të tyre, kanë të ngjarë të jenë në rrezik të abuzimit të financimit të terrorizmit;
- (b) të identifikojnë natyrën e kërcënimeve të paraqitura nga subjektet terroriste ndaj OJF-ve të cilat janë në rrezik, si dhe mënyrën se si aktorët terroristë abuzojnë me OJF të tilla.
- 23.** Vlerësimi i rrezikut identifikoi 3 (tre) llojet e mëposhtme të OJF-ve që bëjnë pjesë në përkufizimin e FATF-së për OJF-të.

	Lloji	Ligji përkatës	FATF ekskluzivisht për OJF-të
1	OJF-të (përfshirë shoqatat, fondacionet, qendrat, degët e OJF-ve të huaja e ndërkombëtare) të regjistruara në Shqipëri <sup>19</sup> .	Ligji nr.8788, datë 07.05.2001 për OJF-të (i ndryshuar)	Në masë të gjerë

<sup>18</sup> Shqipëria është anëtare e MONEYVAL, Struktura Përgjegjëse për Evropën.

<sup>19</sup> OJF-të që nuk plotësojnë përjashtimet e mëposhtme: a) Grupe joformale njerëzish që nuk plotësojnë përkufizimin e rregullimit ligjor; b) Personat juridikë ose aranzhimet ose organizatat që nuk janë krijuar për "punë të mira", të tilla si partitë politike, sindikatat ose kooperativat të cilat janë të angazhuara kryesisht në aktivitete ekonomike për përfitimin financiar të anëtarëve; c) Persona juridikë ose organizime ose organizata që nuk janë të angazhuara në ngritjen ose shpërndarjen e fondeve si qëllim kryesor. Kjo mund të përfshijë ato klube sportive, shoqata sociale ose grupe fetare që nuk angazhohen ose vetëm rastësisht në mbledhjen ose disbursimin e fondeve.

2	Pesë bashkësitë fetare (vendase) të themeluara si subjekte juridikë përmes marrëveshjeve me Qeverinë (të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë).	Ligji nr.8902 “Mbi Marrëveshjen me Selinë e Shenjtë”. Ligji nr. 9365 “Për Procedurat për Njohjen e Zotësisë juridike të Subjekteve Juridikë të Kishës Katolike”. Ligji nr. 10056 “Për Marrëveshjen me Komitetin Mysliman Shqiptar”. Ligji nr. 10057 “Për Marrëveshjen me Kishën Ortodokse”. Ligji Nr. 10058 “Për Marrëveshjen me komunitetin Bektashi”. Ligji nr. 10394 “Mbi Marrëveshjen me Vëllazërinë Ungjillore”.	Po
3	Kryqi i Kuq Shqiptar	Ligji nr.7864, datë 29.9.1994 “Për Kryqin e Kuq Shqiptar”	Po

24. Të dhënat e përdorura në këtë vlerësim rreziku përfshijnë një anketim të kryer me 153 OJF; të dhënat e marra nga institucionet (shih seksionin A për listën); një pyetësor i kryer me 10 agjenci të zbatimit të ligjit dhe inteligjencës (shih seksionin A për listën); intervista me Kishën Orthodokse Autoqefale Shqiptare; një pyetësor i kryer me 15 institucione financiare, rishikimi i kuadrit ligjor dhe rregullator, si dhe të dhëna të tjera plotësuese. Vlerësimi i kryer konsiston në të dhënat cilësore dhe sasiore.

25. Ka 4 raste të dyshimta nën hetim për abuzimin mbi financimin e terrorizmit të OJF-ve në Shqipëri.

26. Vlerësimi mori parasysh:

- Madhësinë dhe natyrën e kërcënimit të përgjithshëm të FT-së në Shqipëri;
- Analizën e abuzimit të FT-së për OJF-të në juridiksione të tjera; dhe forma të tjera të abuzimit financiar të OJF-ve në Shqipëri;
- Vlerësimet cilësore të natyrës së mundshme të rrezikut nga zyrtarët e zbatimit të ligjit, agjencitë mbikëqyrëse, institucionet financiare dhe zyrtarë përgjegjës për OJF-të.

27. U identifikuan pesë kërcënime të mundshme të TF-së ndaj OJF-ve në Shqipëri.

<p><b>OJF-të dhe aktivitetet e OJF-ve që ka të ngjarë të jenë në rrezik në rritje të abuzimit me TF-në</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. OJF-të me veprimtari humanitare dhe bamirëse.</li> <li>2. Veprimtari bamirëse dhe/ose edukative e OJF-ve fetare.</li> <li>3. Shuma të mëdha financimi të huaja nga burime me rrezik të lartë.</li> <li>4. Përdorimi i parasë fizike (cash) apo transaksioneve alternative jashtë sistemit formal bankar.</li> <li>5. Aktivitete në zona të thella.</li> </ol>
--

28. Katër tipare, karakteristika ose aktivitete u identifikuan, të cilat rrisin rrezikun e abuzimit të TF-së midis OJF-ve në Shqipëri.

29. Në përgjithësi, vlerësimi i rrezikut vuri në pah se nuk ka prova përfundimtare të abuzimit të OJF-ve për financimin e terrorizmit në Shqipëri, megjithëse ka katër raste investigimi nën hetim. Perceptimi i rrezikut ndryshon, megjithëse vihet re se autoritetet me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për luftën e financimit të terrorizmit vlerësojnë vazhdimisht rrezikun më të ulët, në dallim nga të anketuarit e tjerë. Ndërsa vlerësimi i përgjithshëm i nivelit të rrezikut nuk është i qartë, ka më shumë konsistencë me faktorët specifikë të rrezikut (shih më lart).

Në këtë kontekst, rreziku i përgjithshëm i qenësishëm për abuzimin e financimit të terrorizmit të OJF-ve në Shqipëri u vlerësua i Ulët. Për shumicën e OJF-ve rreziku është shumë i ulët, ndërsa për organizatat humanitare, bamirëse dhe organizatat fetare që ushtrojnë veprimtari edukuese dhe/ose bamirësie rreziku është i ulët-mesatar.

## Rreziku i Qenësishëm i FT-së për OJF-të në Shqipëri

### I ULËT

30. Ky vlerësim i rrezikut do të plotësohet nga një Rishikim i Veçantë i Masave Zbutëse, i cili do të shqyrtojë përshtatshmërinë e masave për të zbutur rreziqet e identifikuar të TF-së për OJF-të dhe do të ofrojë rekomandime për përmirësim.

# D. FATF-JA PËR OJF-TË

31. Paragrafi 8.1(a) i Metodologjisë së FATF-së deklaron se vendet duhet të "identifikojnë se cila nëngrupe organizatash bëjnë pjesë në përkufizimin e FATF-së për OJF-të".
32. FATF-ja përkufizon termin OJF "një person juridik, marrëveshje apo organizatë që kryesisht përfshihet në mbledhjen ose shpërndarjen e fondeve për qëllime të tilla si qëllime bamirësie, fetare, kulturore, arsimore, sociale ose vëllazërore, ose për kryerjen e llojeve të tjera të "punëve të mira".
33. Ky përkufizim përfshihet:
- Grupet joformale të njerëzve që nuk bëjnë pjesë në përkufizimin e rregullimit ligjor;
  - Personat juridikë, marrëveshje apo organizatat që nuk janë krijuar për "punë të mira", të tilla si partitë politike, sindikatat ose kooperativat, të cilat janë të angazhuara kryesisht në aktivitete ekonomike për përfitimin financiar të anëtarëve;
  - Persona juridikë, marrëveshje apo organizata që nuk janë të përfshirë në mbledhjen ose shpërndarjen e fondeve si qëllim kryesor. Kjo mund të përfshijë ato klube sportive, shoqata sociale ose grupe fetare që nuk angazhohen ose angazhohen rastësisht në mbledhjen apo shpërndarjen e fondeve.
34. FATF-ja paraqet figurën në vijim <sup>20</sup> për të ilustruar se cilat OJF duhet të mbulohen nga vlerësimi i rrezikut.

Figura 1: FATF-ja për OJF-të.



(Burimi: Udhëzues për Vlerësimin e Rrezikut të FT-së, FATF).

## Identifikimi i "OJF-ve sipas FATF-së" në Shqipëri

35. Më 7 tetor 2021, Ekipi Vendor i Vlerësimit dhe një konsulent i jashtëm rishikuan udhëzimin për "OJF-të sipas FATF-së" dhe qëllimin e Rekomandimit 8 për vlerësimet e rrezikut. Grupi identifikoi se cilat OJF bëjnë pjesë në përkufizimin e FATF-së dhe si rrjedhojë duhet të përfshihen në kuadrin e këtij vlerësimi rreziku.

<sup>20</sup> Figura 4.1, Udhëzues për Vlerësimin e Rrezikut të Financimit të Terrorizmit, (FATF, 2019)



36. Aktiviteti i Ekipit Vendor të Vlerësimit nisi punën me identifikimin e të gjithë organizatave në vend që janë pjesë e sektorit jofitimprurës, përfshirë ato që:

- nuk janë subjekte tregtare,
- janë krijuar për një interes më të ngushtë dhe specifik ekonomik, ose politik të themeluesve dhe anëtarëve të tyre,
- nuk veprojnë për promovimin e “punëve të mira” apo interesit të publikut të gjerë.

Kategoritë e mëposhtme u identifikuan:

- Organizatat jofitimprurëse, veprimtaria e të cilave rregullohet në Ligjin nr.8788 datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar, të cilat janë:
  - shoqatat (përfshirë shoqatat e themeluara nga OJF-të e huaja).
  - fondacionet (përfshirë fondacionet e themeluara nga OJF-të e huaja).
  - qendrat (përfshirë qendrat e themeluara nga OJF-të e huaja).
  - degët e OJF-ve të huaja dhe ndërkombëtare.
  - OJF-të e huaja që ushtrojnë veprimtari në Shqipëri pa u regjistruar për një periudhë jo më pak se 30 ditë rradhazi dhe jo më shumë se 6 muaj (përcaktuar si aktivitet i përkohshëm).
  - OJF-të e huaja që ushtrojnë veprimtari në Shqipëri të pa regjistruara<sup>21</sup> dhe në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin shqiptar.<sup>22</sup>
  - grupe informale njerëzish që nuk regjistrojnë organizimin e tyre.
- Ndërmarrjet Sociale, të rregulluara në Ligjin nr.65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”. Këto janë OJF të cilat kanë aplikuar dhe u janë dhënë përfitime shtesë të zbatueshme vetëm për ndërmarrjet sociale.
- Bashkësitë fetare të krijuara me marrëveshje të veçanta me Qeverinë Shqiptare. Ekzistojnë pesë bashkësi të tilla<sup>23</sup>, si në vijim:
  - Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare (Ligji nr.10057, datë 22.01.2009).
  - Kisha Katolike (Ligji nr.8902, datë 23.05.2002).
  - Komuniteti Mysliman i Shqipërisë (Ligji nr.10056, datë 22.01.2009).
  - Kryegjyshata Botërore Bektashiane (Ligji nr. 10058, datë 22.01.2009).
  - Bashkësia Fetare “Vëllazërisë Ungjillore e Shqipërisë” (Ligji nr.10394 datë 10.03.2011).
- Degët e grupeve fetare ndërkombëtare dhe grupet e tjera fetare të organizuara në bazë të Ligjit nr.8788, datë 7.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar, por që nuk njihen si Komunitete Fetare dhe nuk kanë marrëveshje me Qeverinë Shqiptare.
- Kryqi i Kuq, themeluar në bazë të Ligjit nr.7864, datë 29.09.1994 “Për Kryqin e Kuq Shqiptar”, i ndryshuar, dhe regjistruar në Regjistrin e OJF-ve.
- Sindikatat, të rregulluara me dispozita të veçanta të përfshira në Kodin e Punës (Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar).
- Partitë politike, rregulluar me Ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar.
- Dhomat e Tregtisë, rregulluar në bazë të Ligjit nr.9640, datë 09.11.2006 “Për Dhomat e Tregtisë”, i ndryshuar.

<sup>21</sup> OJF-të e huaja që ushtrojnë veprimtari në Shqipëri pa qenë të regjistruara dhe në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin shqiptar mund të ushtrojnë veprimtari pavarësisht nga dispozita ligjore përkatëse (neni 11/1 paragrafi 2) të parashikuar në Ligjin për OJF-të. Këto OJF të huaja mund të funksionojnë nëpërmjet punonjësve kontraktues ose profesionistëve të pavarur në Shqipëri pa pasur prezencë të ligjshme në Republikën e Shqipërisë.

<sup>22</sup> Neni 11/1 paragrafi 2 i ligjit nr.8788 datë 7.05.2001, i ndryshuar.

<sup>23</sup> Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë: [www.knfsh.al](http://www.knfsh.al)

- Shoqatat e qiramarrësve, rregulluar në Ligjin nr.10112, datë 09.04.2009 “Për Administrimin e Bashkëpronësisë në Ndërtesat e Banimit”, i ndryshuar.
- Shoqëri të Kursim-Kreditit, të rregulluara me Ligjin nr.52/2016 “Për Shoqëritë e Kursim-Kreditit dhe Unionet e tyre”.
- Organizatat e Bashkëpunimit të Ndërsjelltë, rregulluar me Ligjin nr.8088, datë 21.03.1996 “Për Organizatat e Bashkëpunimit të Ndërsjelltë”, i ndryshuar.
- Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor, rregulluar me Ligjin nr.38/2012 “Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor”.
- Përmirësimi i Zonave të Biznesit të Pa inkorporuar (BID), i rregulluar sipas Ligjit nr.63/2020 “Për Përmirësimin e Zonave të Biznesit (BID)”.
- Organizata e Punëdhënësve, rregulluar me dispozita të veçanta të përfshira në Kodin e Punës (Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar).
- Klubet dhe federatat sportive, të rregulluara me Ligjin nr.79/2017 “Për Sportin”, i ndryshuar, në formën e OJF-ve.
- Organizatat profesionale të rregulluara sipas ligjeve të veçanta përkatëse ose sipas ligjit për OJF-të, si Dhoma Kombëtare e Avokatisë, e Noterëve, Ndërmjetësit, Përmbartuesit, Audituesit, Vlerësuesit e Pasurive të Paluajtshme, etj.
- Organizata të tjera të Shoqërisë Civile të pa përmendura më sipër, por të njohura sipas Ligjit nr.119/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”.

## Analiza e të gjitha kategorive të identifikuara

- 37.** Kategoria ligjore e organizatave jofitimprurëse sipas Ligjit Shqiptar për OJF-të është më e gjerë se përkufizimi i FATF-së dhe përfshin disa subjekte që nuk janë OJF sipas përkufizimit të FATF-së. Megjithatë, pjesa më e madhe e subjekteve (përfshirë ndërmarrjet sociale) bëjnë pjesë në përkufizimin e FATF-së dhe rrjedhimisht do të konsiderohen të gjitha OJF-të të përcaktuara me ligj në linjë me përkufizimin e FATF-së. Kategoritë e përjashtuara janë si në vijim: (i) OJF-të e huaja që funksionojnë për një periudhë afatshkurtër në Shqipëri me miratim nga shteti, pa krijuar një prani ligjore të brendshme (duke ushtruar veprimtari të përkohshme); (ii) OJF-të e huaja që funksionojnë nëpërmjet punonjësve ose profesionisteve të pavarur në Shqipëri pa prani ligjore përjashtohen, pasi nuk janë subjekte juridikë ose marrëveshje (d.m.th. shoqëri e thjeshtë e përcaktuar në nenin 1074 të Kodit Civil Shqiptar); (iii) grupe joformale njerëzish që nuk themelojnë një organizatë formale anëtarësie; (iv) OJF të cilat janë krijuar për të ofruar shërbime për anëtarët e tyre dhe nuk ushtrojnë veprimtari të “punëve të mira”.
- 38.** Komunitetet fetare, të krijuara përmes marrëveshjeve të veçanta me qeverinë, degët e grupeve fetare ndërkombëtare, grupet fetare të regjistruara si OJF përshtaten me përkufizimin e FATF-së për OJF-të. Grupet fetare të paregjistruara përjashtohen pasi nuk janë persona juridikë ose marrëveshje (d.m.th. shoqëri e thjeshtë e përcaktuar nga neni 1074 i Kodit Civil Shqiptar).
- 39.** Kryqi i Kuq është themeluar me ligj të veçantë si organizatë humanitare vullnetare, masive, autonome dhe e pavarur që i përket qytetarëve. Qëllimi humanitar dhe funksionimi si jofitimprurës i kësaj organizate i plotëson kriteret e përkufizimit.
- 40.** Përjashtohen marrëveshjet, organizatat dhe grupet joformale të paregjistruara. Kuadri ligjor dhe rregullator në Shqipëri parashikon kërkesa të rrepta për grupimet jo formale që të zyrtarizojnë statusin e tyre nëse dëshirojnë të angazhohen në mbledhje ose shpërndarje të fondeve. Si rezultat, është vlerësuar se OJF-të jo formale nuk mbledhin ose nuk mund të shpërndajnë fonde në ndonjë mënyrë të rëndësishme materiale pa u inkorporuar dhe regjistruar në Shqipëri.
- 41.** Sindikatat, partitë politike, dhomat e tregtisë, shoqatat e qiramarrësve, shoqëri të kursim-kreditit, organizatat e bashkëpunimit të ndërsjelltë, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor dhe organizatat e punëdhënësve,

organizatat e profesionistëve, klubet sportive dhe federatat u përjashtuan nga objekti i përkufizimit duke qenë se janë krijuar për një interes më të ngushtë dhe specifik social, ekonomik ose politik të themeluesve dhe anëtarëve të tyre, dhe jo për promovimin e “punëve të mira” dhe interesit të publikut të gjerë.

42. Përjashtohen organizatat kontraktuale “Përmirësimi i Zonave të Biznesit (BID)” dhe organizatat BID, të cilat janë krijuar dhe regjistruar si OJF, pasi ato kombinojnë “punë të mira” me interesa tregtarë.
43. Organizatat e tjera të shoqërisë civile që nuk janë përmendur më sipër, por të miratuara në Ligjin nr.119/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile” përjashtohen pasi nuk ka të dhëna që kjo formë të përdoret në praktikë.
44. Si përfundim, tre kategoritë e mëposhtme përfshijnë subjekte juridikë që janë OJF sipas përkufizimit të FATF-së.

Shënim: jo të gjitha subjektet e këtyre kategorive janë nën përkufizimin e FATF-së për OJF-të.

**Tabela 1: OJF-të në Shqipëri që janë në përputhje me përkufizimin e FATF.**

	Lloji	Ligji përkatës	FATF për OJF-të
1.	OJF-të (përfshirë shoqatat, fondacionet, qendrat, degët e OJF-ve të huaja dhe ndërkombëtare) të regjistruara në Shqipëri.	Ligji për OJF-të	Në masë të gjerë
2	Pesë bashkësi fetare (vendase) të themeluara si subjekte juridikë përmes marrëveshjeve me qeverinë (ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë).	Marrëveshje me qeverinë	Po
3	Kryqi i Kuq Shqiptar	Ligji për Kryqin e Kuq Shqiptar	Po

# E. PROFILI I FATF-SË PËR OJF-TË NË SHQIPËRI

45. Tre kategori organizatash u identifikuan sipas përkufizimit të FATF-së për OJF-të. Këto janë:
1. OJF-të (përfshirë shoqatat, fondacionet, qendrat, degët e OJF-ve të huaja dhe ndërkombëtare dhe ndërmarrjet sociale) të regjistruara në Shqipëri sipas Ligjit Shqiptar për OJF-të;
  2. Pesë bashkësi fetare (vendase) të themeluara si subjekte juridikë përmes marrëveshjeve me qeverinë;
  3. Kryqi i Kuq Shqiptar.
46. Në regjistrin e OJF-ve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, autoriteti i vetëm publik që ka të drejtën e regjistrimit të OJF-ve në vend, kishte gjithsej 11,962 OJF të regjistruara deri në fund të vitit 2020. Prej tyre, deri në maj 2021, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) ishin të regjistruara 5,295 organizata, nga të cilat vetëm 2,372 kishin status aktiv. Këto organizata ndahen nga DPT-ja, në tre kategori: organizata fetare, humanitare dhe bamirëse (3.1%), organizata politike (1.1%) dhe organizata jofitimprurëse (95.8%).
47. OJF-të udhëhiqen nga legjislacioni kryesor përkatës ekzistues, i cili përfshin, por nuk kufizohet me: Kushtetutën Shqiptare, e ndryshuar, Kodin Civil ("KC"), i ndryshuar, Ligjin nr.8788, datë 7.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar ("Ligji për OJF-të") dhe Ligji nr.80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse". OJF-të e huaja ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri në përputhje me Kushtetutën Shqiptare dhe legjislacionin e organizatave jofitimprurëse.
48. Aktualisht, ka pesë komunitete fetare të krijuara në Shqipëri me marrëveshje specifike me Qeverinë Shqiptare. Këto janë: Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare, Kisha Katolike, Komuniteti Mysliman, Komuniteti Bektashi dhe Komuniteti i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë. Ka edhe degë të grupeve fetare ndërkombëtare dhe grupe të tjera fetare që janë të organizuara në bazë të Ligjit nr.8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar, por që nuk njihen si komunitete fetare dhe nuk kanë marrëveshje me Qeverinë Shqiptare.
49. Rregulloret në fuqi nuk kërkojnë regjistrimin ose licencimin e grupeve fetare, por një grup fetar duhet të regjistrohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë si një organizatë jofitimprurëse për t'u kualifikuar për përfitime të caktuara, duke përfshirë hapjen e një llogarie bankare, selinë e tij, dhe përjashtimin nga taksa të caktuara. Nëse është e regjistruar, organizata jofitimprurëse fetare i nënshtrohet dispozitave ligjore përkatëse si çdo organizatë tjetër jofitimprurëse e krijuar dhe e regjistruar në Republikën e Shqipërisë.
50. Kryqi i Kuq është themeluar në bazë të Ligjit nr.7864, datë 29.09.1994 "Për Kryqin e Kuq Shqiptar", i ndryshuar, i regjistruar në Regjistrin e OJF-ve.
51. Analiza në këtë seksion bazohet në një anketim të kryer me 153 OJF, nga 2,372 të cilat janë aktive dhe të regjistruara në DPT (deri në maj 2021). Kampioni u zgjodh në mënyrë rastësore nga lista e OJF-ve aktive të ofruara nga DPT-ja dhe kontaktet u nxorrën nga databaza e OJF-ve të Partnerëve Shqipëri, e përdorur për vëzhgimin me OJF-të për përgatitjen e raportit vjetor të vendit "Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile". Pjesëmarrja në këtë anketim u bazua në gatishmërinë e OJF-ve për të marrë pjesë në të. Anketimi u krye gjatë periudhës korrik – gusht 2021 nëpërmjet telefonit. Niveli i besimit është 80% dhe vlera reale është brenda ±5% të vlerës së matur/anketuar.
52. Një sfidë në kryerjen e këtij anketimi ishte gjetja e informacionit të kontakteve të organizatave fetare. Bazuar në listën e ofruar nga DPT-ja,<sup>24</sup> Partnerët Shqipëri hulumtoi platformat e komunikimit dhe medias online të këtyre organizatave, për të identifikuar kontaktet e tyre.


<sup>24</sup> Për shkak të konfidencialitetit, në bazën e të dhënave të ofruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mungonin të dhënat e kontaktit të OJF-ve, të tilla si adresat e telefonit dhe emailit.

Në shumicën e rasteve ky informacion nuk ishte i saktë, nuk përputhej me organizatën, apo numri i kontaktit dhe adresat e emailit nuk funksiononin.

### 53. Vëzhgimet nga anketimi për OJF-të:


Sipas formës ligjore, 48% e OJF-ve të anketuara janë shoqata, ndjekur nga qendrat (41%) dhe fondacione (11%).

**Figura 2: OJF-të sipas formës ligjore (Burimi: Anketimi me OJF-të; nr. = 153 OJF)**




Dhënia e ndihmës për grupet e marginalizuara dhe personat me aftësi të veçanta është veprimtaria kryesore e OJF-ve që morën pjesë në anketim. Ajo u raportua si aktivitet nga 47% e OJF-ve të anketuara. Të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve, si dhe veprimtaritë e trajnimeve profesionale u raportuan nga 40% e të anketuarve, ndërsa 37% e tyre raportuan të kryejnë aktivitete mbi të drejtat e njeriut dhe anti diskriminimin.

**Figura 3: Aktivitetet e OJF-ve për 12 muajt e fundit (Burimi: Anketimi me OJF-të; nr. = 153 OJF).**




Shumica e OJF-ve që morën pjesë në anketim raportojnë të ardhura më pak se 5 milionë lekë (rreth 41,000 EUR) për vitin e fundit (2020), ndërsa 8 OJF raportojnë se nuk kanë marrë financim nga asnjë burim të ardhurash për vitin e fundit (2020) për mbështetjen e veprimtarive të tyre.

**Figura 4: Të ardhurat vjetore të OJF-ve (Burimi: Anketimi me OJF-të; nr. = 153 OJF).**




**Grantet apo kontratat janë burimi më i madh i të ardhurave për OJF-të.** Kur u pyetën për të zgjedhur burimet e të ardhurave që përbëjnë më shumë se 5% të të ardhurave të tyre vjetore, 90% e OJF-ve zgjedhën grantet ose kontratat. Për këtë grup OJF-sh, 92% e tyre kanë marrë fonde përmes granteve ose kontratave me institucione të huaja shtetërore. Shumica e OJF-ve që ofrojnë ndihmë për grupet e marginalizuara dhe personat me aftësi të veçanta, mbrojtje sociale dhe ndihmë humanitare, raportojnë se marrin fonde nga grante apo kontrata me burime filantropike të huaja dhe individë privatë të huaj.

**Figura 5: Ofruesit e granteve ose kontratave (Burimi: Anketimi me OJF-të; nr. = 138 OJF)**




**Figura 6: Ofruesit e granteve ose kontratave sipas formës ligjore të OJF-ve (Burimi: Anketimi me OJF-të; nr. = 138 OJF)\***



\*Ky rezultat u llogarit në bazë të 138 OJF-ve (66 shoqata, 15 fondacione dhe 57 qendra) të cilat raportojnë se kanë të ardhura nga grantet apo kontratat.


**Dhurimet në para fizike (cash) janë të rralla.** Vetëm 6% e OJF-ve që morën pjesë në anketim raportojnë se marrin fonde që përfshijnë para fizike (cash), të cilat përbëjnë më shumë se 5% të të ardhurave të tyre totale. Individët privatë kanë më shumë gjasa të dhurojnë para fizike (cash) të ndjekur nga korporatat dhe OJF-të.

**Figura 7: Dhurime në para fizike (Burimi: Anketimi me OJF-të; nr. = 153 OJF)**



Referuar burimeve të tjera të të ardhurave konstatohet se pak OJF kanë më shumë se 5% të të ardhurave nga burimet në vijim: 8% e shoqatave nga pagesat e anëtarësimit, 5% e OJF-ve përmes mbështetje jo financiare, 3% e tyre nga shitjet e mallrave apo shërbimeve dhe asnjë nga OJF-të e anketuara nuk kanë të ardhura nga investimet.

**Figura 8: Burimi i të ardhurave nga anëtarësimi (Burimi: Anketimi me OJF-të; nr. = 73 OJF)**




Asnjë nga OJF-të që morën pjesë në anketim nuk raportuan marrjen e fondeve që përbëjnë më shumë se 5% të të ardhurave të tyre totale përmes kanaleve jo-bankare, si ofruesit e shërbimeve monetare, apo përmes krypto-valutave.

OJF-ve pjesëmarrëse në anketim iu kërkua të jepnin detaje mbi lidhjet e tyre me të huajt. Konkretisht, ata u pyetën nëse:

- kanë marrë fonde, mallra ose shërbime nga shtete të tjera
- kanë dërguar para ose mallra drejtpërdrejtë njerëzve në nevojë në shtete të tjera
- kanë ofruar shërbime ose drejtuar projekte në shtete të tjera
- kanë punuar në partneritet me OJF në shtete të tjera
- është /ka qenë themeluar, mbikëqyrur dhe/ose menaxhuar nga shtetas të huaj
- punëson ose ka marrë leje pune për shtetas të huaj

Të dhënat e anketimit tregojnë se Shqipëria është një importues neto i fuqishëm fondesh. Pjesa më e madhe e OJF-ve që morën pjesë në anketim (86%) marrin fonde, mallra ose shërbime nga shtete të tjera. Një pakicë shumë e vogël (2%) dërgon fonde ose ofron shërbime në vende të tjera. Të gjitha këto janë organizata që zbatojnë veprimtari të ndryshme, si: fuqizimi i gruas, barazia dhe politikat gjinore, ndihma për grupet e marginalizuara dhe personat me aftësi të veçanta, mbrojtja sociale, të drejtat e njeriut dhe antidiskriminimi, si dhe trajnime arsimore dhe profesionale. Dy prej tyre janë krijuar, mbikëqyrur dhe/ose menaxhuar nga shtetas të huaj. Dy prej tyre kanë të ardhura mbi 30 milionë lekë dhe vetëm një organizatë raportoi të ardhura vjetore nga 14 – 30 milionë lekë.


**Figura 9: Lidhjet me të huajt (Burimi: Anketimi me OJF-të; nr. = 153 OJF)**






Qendrat dhe shoqatat kanë më shumë mundësi të kenë partneritet me vendet jashtë (10.5% / 10%), ose të themelohen dhe menaxhohen nga shtetas të huaj (10% / 10%).

**Figurat 10 dhe 11: Lidhjet me të huajt të qendrave dhe shoqatave (Burimi: Anketimi me OJF-të; nr. = 63 qendra dhe 73 shoqata)**



Në dallim, shumë pak fondacione kanë partneritete apo krijohen dhe menaxhohen nga shtetas të huaj.

**Figura 12. Lidhjet me të huajt të fondacioneve (Burimi: Anketimi me OJF-të, nr. = 17 fondacione)**



# F. NATYRA E KËRCËNIMIT TË FT-SË NDAJ OJF-VE NË SHQIPËRI

54. Paragrafi 8.1 (b) i Metodologjisë së FATF-së deklaron se vendet duhet të “identifikojnë natyrën e kërcënimeve të paraqitura nga subjektet terroriste ndaj OJF-ve që janë në rrezik, si dhe mënyrën se si aktorët terroristë abuzojnë me OJF të tilla”.
55. Kjo pjesë e vlerësimit të rrezikut vlerëson natyrën e kërcënimit. Ky vlerësim kombinon të dhënat sasiore (dëshminë e shfaqjes së këtij kërcënimi) dhe të dhënat cilësore (pikëpamjet e ekspertëve mbi atë që ka të ngjarë të jetë kërcënim).

## Shqipëria dhe Kërcënimi i Financimit të Terrorizmit – Rishikim i Literaturës

56. Shqipëria ndërmori Vlerësimin e parë Kombëtar të Rrezikut (VKRR) të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në vitin 2012, vlerësimin e dytë në vitin 2015, dhe vlerësimin e fundit në vitin 2019, i cili mbuloi edhe sektorin e OJF-ve. Procesi u koordinua nga Njësia e Inteligjencës Financiare Shqiptare, me të dhëna nga një sërë përfaqësuesish të sektorit publik, duke përfshirë inteligjencën shtetërore, Agjencitë e Zbatimit të Ligjit (AZL) dhe autoritetet mbikëqyrëse. Të dhënat e përdorura për vlerësimin e fundit (2019) mbuluan periudhën 2015-2018.
57. VKRR-ja ofron një analizë të faktorëve lehtësues të rrezikut, faktorëve që rrisin rrezikun (dobësitë), kërcënimeve dhe pasojave të përdorimit të institucioneve të sektorit financiar dhe të veprimtarive e profesioneve jo-financiare të përcaktuara . Gjithashtu, VKRR-ja analizon kërcënimet dhe dobësitë e përgjithshme duke përdorur të dhëna mbi veprat penale, aktivitetet e organeve të sektorit publik (p.sh. kontrollet kufitare, veprimet policore, bashkëpunimet ndërkombëtare, ndjekjet penale, konfiskimet) dhe burimet publike. Metodologjia e përdorur për VKRR ishte e vetë-përpunuar nga autoritetet.
58. Shqipëria i klasifikon rreziqet e saj të FT-së si “të ulëta”, duke e argumentuar këtë me nivelin e ulët të kërcënimeve nga terrorizmi në vend. Megjithatë, sipas VKRR-së (periudha 2010-2014) u konstatua një rritje e radikalizmit fetar dhe u identifikuan raste të rekrutimit të Luftëtarëve të Huaj Terrorist (LHT). Ka patur një numër të kufizuar ndjekjesh dhe dënimesh të suksesshme kundër terrorizmit, të cilat përfshijnë akt akuza në rastet e luftimeve të shtetasve të huaj të lidhura me konfliktin sirian. Megjithatë, asnjë ndjekje penale apo dënim për vepra penale të FT-së nuk ka ndodhur, qoftë kjo ndjekje e pavarur, apo si pjesë e një ndjekjeje kundër terrorizmit. (VRN 2018)
59. Sipas autoriteteve, kërcënimi kryesor i lidhur me terrorizmin në Shqipëri është fenomeni i ekstremizmit/radikalizmit me bazë fetare, i shfaqur qoftë në nivel vendor ose rajonal, në përpjekje terroriste të izoluar, apo në rekrutimin dhe financimin e personave që udhëtojnë për të marrë pjesë në konflikte jashtë vendit (LHT). Faktorët që ndikojnë në organizimin e aktiviteteve të tilla janë të ndryshëm, si pozicioni gjeopolitik strategjik i vendit, mungesa e barrierave gjuhësore në rajonin fqinj, ndërgjegjësimi i ulët i komuniteteve fetare vendase, niveli i ulët ekonomik i grupeve të caktuara të shoqërisë që lehtëson përhapjen dhe përfaqimin e doktrinave ekstremiste, si dhe mungesa e përvojës së duhur të autoriteteve lokale në fushën përkatëse. (RVN, 2018).

60. Sipas RVN 2018, vlerësimet e rrezikut të FT-së në vlerësimet e VKRR-ve janë shumë të kufizuara dhe përmbajnë analiza të limituara të rrezikut të FT-së. Asnjë nga VKRR-të nuk është publikuar. Asnjë nga VKRR-të nuk u pasua nga një plan veprimi të shkruar apo dokument strategjik zyrtar për të adresuar rreziqet e identifikuar.<sup>25</sup>
61. Raporti i Vlerësimi të Ndërsjelltë 2018 kostanton se nuk ka pasur dënime për vepra penale të FT-së në Shqipëri. Autoritetet shqiptare kanë konfirmuar se ka pasur vetëm një rast ku procedimet penale për FT-në ishin regjistruar gjatë periudhës së vlerësimi, ndërsa pjesa tjetër e shifrave të lidhura me FT të cituara në VKRR-në me sa duket kishin qenë të gabuara (ato në fakt lidhen me akte të veçanta terrorizmi që konsistojnë në shkatërrimin e shtyllave të transmetimit të energjisë elektrike pa ndonjë akuzë të lidhur me FT-në). Organizata e vetme kriminale, që është ndjekur penalisht dhe dënuar ndonjëherë në Shqipëri për krime të tilla (çështja e Genci Ballës), kishte rekrutuar 74 shtetas shqiptarë, të cilët u larguan nga vendi në vitet 2012-2014 për të luftuar për ISIS-in.
62. Sipas RVN-së 2018, numri i Raporteve të Aktivitetit të Dyshimtë (RAD) në lidhje me dyshimet për FT duket i papërfillshëm ndaj numrit total të raporteve, megjithëse shifrat tregojnë një rritje të qendrueshme. Kjo për shkak të rritjes së ndërgjegjësimi të Entiteveve Raportuese (ER) dhe jo për shkak të rritjes aktuale të transaksioneve të lidhura me FT-në. Shumica e RAD-ve janë kryer nga bankat.

### Referimet e DPPPP-së për FT-në

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
RTD-të e lidhura me FT	1	3	4	8	6	29	2
FT të lidhura me referimet	0	1	1	3	2	8	3

63. RVN 2018 vuri në dukje mungesën e një qasjeje sistematike në identifikimin dhe hetimin e aspekteve financiare të veprave të lidhura me terrorizmin, dhe dëshmoi shqetësimin se aspektet financiare të veprave penale të lidhura me terrorizmin nuk hetohen gjithmonë siç duhet. Për më tepër, ky raport vuri në dukje se perceptimi dhe kuptimi i rreziqeve të lidhura me FT-në nuk duken se trajtojnë siç duhet karakteristikat e aktiviteteve të mundshme të FT-së në vend dhe rajon. Njësitë inteligjente dhe APL-të u treguan vigjilentë ndaj rreziqeve terroriste, por nuk arritën të vërtetonin kuptimin e duhur të rreziqeve të lidhura me financimin e terrorizmit.
64. Në “Raportin Vjetor për Terrorizmin në Botë 2020” të Departamentit Amerikan të Shtetit<sup>26</sup> u raportua se kërcënimi nga terrorizmi në Shqipëri përfshin LHT-të që kthehen nga Iraku dhe Siria, përpjekjet e simpatizantëve të ISIS-it për të radikalizuar të rinjtë shqiptarë drejt dhunës, si dhe aktivitetet e sponsorizuara nga shteti i Iranit të drejtuar kryesisht kundër grupit opozitar iranian Mujahedeen-e-Khalq, anëtarët e të cilit u zhvendosën në Shqipëri. Në këtë raport theksohet se nuk ka pasur ndodhi terroriste të raportuara në Shqipëri gjatë vitit 2020.
65. “Progres Raporti i BE-së për Shqipërinë 2021”<sup>27</sup> zbuloi se perceptimi dhe kuptimi i rreziqeve të lidhura me FT-në nuk trajtojnë siç duhet karakteristikat e aktiviteteve të mundshme të FT-së në vend dhe rajon. Raporti evidentoi se radikalizmi fetar dhe rastet e rekrutimit të LHT-ve janë rritur në Shqipëri gjatë vitit 2020.
66. Raporti “Global Terrorist Impact 2021” e renditi Shqipërinë në vendin e 93-të në nivel global për sa i përket shfaqjes kombëtare të sulmeve terroriste, me vlerësimin “pa ndikim”.

<sup>25</sup> RVN 2018 i referohet Vlerësimeve Kombëtare të Riskut 2012 dhe 2015. Ndërkohë, sipas të dhënave nga DPPPP, VKRR i vitit 2019 u shoqërua nga një plan veprimi me masa konkrete dhe afate, masat e të cilave u realizuan gjatë periudhës 2021-2022.

<sup>26</sup> <https://www.state.gov/reports/country-reports-on-terrorism-2020/>

<sup>27</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52021SC0289>

# Kërcënimi i financimit të terrorizmit ndaj OJF-ve në Shqipëri - Rishikim i literaturës

67. Siç vërehet në vlerësimet e FATF-së, autoritetet shqiptare kanë vlerësuar dy herë rreziqet e financimit të terrorizmit ndaj OJF-ve.

- Në vitin 2012, DPPPP-ja publikoi një dokument "Vlerësimi i Sektorit Jofitimprurës në Shqipëri".
- Në vitin 2015, analiza e kufizuar e rrezikut për sektorin e OJF-ve u krye në kuadër të VKRR-së.

Asnjë nga këto dy analiza nuk identifikoi nëngrupin e organizatave sipas përkufizimit të FATF-së për OJF-të.

68. Në vitet 2015-2016 u ndërmorrën shumë veprime, përtej dy vlerësimeve të përmendura më sipër. DPPPP-ja, duke përfshirë DPT-në dhe Shërbimin Informativ të Shtetit (SHISH), nisi një vlerësim njëvjeçar të një numri të caktuar OJF-sh të përfshira në aktivitete bamirësie nga perspektiva e luftës kundër FT-së. Të gjitha OJF-të e marra në vlerësim ishin shqiptare. SHISH-i i siguroi DPPPP-së një listë të OJF-ve që konsiderohen të ekspozuara ndaj rreziqeve të FT-së, sipas kriterëve dhe të dhënave të SHISH-it. DPT-ja siguroi të dhënat përkatëse për këto OJF (p.sh. të dhëna për strukturën, donatorët, informacionin lidhur me taksat). DPPPP-ja kreu një analizë të detajuar duke u bazuar në informacionin bankar dhe dokumentacionin e plotë mbikëqyrës nga DPT-ja. Vëmendje e veçantë iu kushtua sjelljes së personave brenda stafit drejtues (drejtorë, administratorë) të OJF-ve. Vlerësimi arriti në përfundimin se OJF-të e analizuar nuk ishin të përfshira në FT-në. Rezultatet e kësaj praktike u ndanë vetëm me SHISH-in.

69. VRN-ja e vitit 2015 vuri në dukje se në fillim të viteve 2000 dyshimet për FT-në lidheshin me OJF-të e kontrolluara nga subjekte të huaja (duke përfshirë ato të renditura nga Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (UNSCR-të përkatëse). Ekzistonte një shqetësim se këto OJF shërbenin si qendra për kanalizimin e parave në Shqipëri me qëllim shpërndarjen e materialeve që inkurajonin fundamentalizmin fetar. Si rezultat i veprimeve të qeverisë, rreth vitit 2010, përafërsisht 25 OJF të dyshuara ndërprejnë veprimtarinë ose funksionimin e tyre në Shqipëri. Mbështetja e tyre financiare nga grupet ekzistuese radikale fetare të marra nga jashtë (p.sh. xhamitë e improvizuara me imamë të vetëshpallur që përhapin ekstremizmin) tani kryhen kryesisht nga korrierët e parave fizike që transportojnë shuma të vogla, por të qëndrueshme parash. Sipas autoriteteve një mbështetje e tillë nuk vjen drejtpërdrejtë nga organizatat aktuale terroriste. Gjithashtu, paratë e mbledhura nga besimtarë anonimë janë përdorur edhe për qëllime të FT-së nga organizatorët dhe rekrutuesit e LHT-së.

70. Raporti i Vlerësimit të Ndërsjelltë 2018 konstaton se sipas DPPPP-së, ishin gjithsej 28 RAD-e, të cilat janë dorëzuar nga ER-et për aktivitetet e OJF-ve gjatë periudhës së vlerësimit. Edhe pse këto RAD-e ishin më tepër të lidhura me PP-në dhe jo FT-në, këto statistika mund të jenë tregues për rolin që luajtën ER-të si parandalues. Gjithashtu, DPPPP-ja raportoi 2 raste të nisura në bazë të RAD-ve të marra nga bankat, në lidhje me OJF-të e dyshuara për FT/radikalizëm/ekstremizëm gjatë periudhës në shqyrtim: 1 rast në vitin 2013 dhe 1 rast në vitin 2014. Rasti në vitin 2013 lidhej me një transfertë bankare me vlerë 16,701 EUR, nga një vend në Lindjen e Mesme, dërguesi i të cilit ishte përfshirë në FT. Rasti tjetër kishte të bënte me keqpërdorimin e fondeve të OJF-ve për qëllime radikalizmi. Të dyja rastet janë transferuar nga DPPPP-ja pranë APL-ve për hetime të mëtejshme, të cilat nuk kishin përfunduar në momentin e vizitës në vend.

## Të dhënat sasiore

71. Kërkesat me shkrim për të siguruar të dhëna mbi financimin e terrorizmit në sektorin e OJF-ve iu dërguan 10 agjencive qeveritare dhe institucioneve publike. Këto agjenci dhe institucione u pyetën të jepnin të dhëna për pesë vitet e fundit, mbi:

- Dënimet ose ndjekjet penale të OJF-ve për FT;
- Ndihmën ligjore të ndërsjellë ose kërkesa të ngjashme (kërkesa formale ndër-qeveritare për informacion) lidhur me OJF-të;
- Hetimin e OJF-ve për FT;

- Veprimet e sigurisë/inteligjencës kombëtare së OJF-ve për FT;
- Ndërhyrjet rregullatore të OJF-ve për FT;
- Statistikat mbi Raportet e Transaksioneve të Dyshimta (RTD)/Raportet e Aktiviteteve të Dyshimta (RAD) në lidhje me OJF-të;
- Shkëmbimin e informacionit (mbikëqyrësit, DPPPP-ja, agjencitë zbatuese të ligjit) për FT-në tek OJF-të;
- Dhe çështje të tjera që nuk janë trajtuar më sipërlidhur me OJF-të për FT.

**72.** Ekipi mori përgjigje nga 9 (nëntë) agjenci qeveritare dhe institucione publike.

**73.** Pesë (5) raste të dënimit apo ndjekjes penale të OJF-ve për FT janë referuar nga Policia e Shtetit Shqiptar. Katër prej këtyre OJF-ve janë nën hetim, ndërsa hetimi për 1 OJF është ndërprerë për shkak të mungesës së provave dhe evidencave. Sipas informacionit të siguruar nga Policia e Shtetit, 4 OJF-të janë nën hetim për shkak se kanë marrë një sasi të konsiderueshme ose të lartë fondesh përmes kanaleve bankare nga vende të konsideruara me rrezik të lartë si Katari, Kuvajti, Irani, Arabia Saudite, por edhe nga Mbretëria e Bashkuar (1 çështje). Qëllimi dhe veprimtaritë e tyre janë të fokusuar në edukimin, veçanërisht të brezit të ri, inkurajimin dhe promovimin e Islamit (3 raste) dhe besimi fetar Shia (1 rast). Dy prej tyre janë në pronësi shqiptare ndërsa dy të tjerat janë në pronësi të shtetasve të huaj. Policia e Shtetit raportoi marrjen dhe shkëmbimin e informacionit me autoritetin e DPPPPP-së për të gjitha çështjet.

**74.** Katër (4) çështje të OJF-ve të dyshuara për evazion fiskal, me vlerë 54,196,234 lekë janë nën hetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT). Tri raste referohen për vepra penale: fshehja e të ardhurave, siç përcaktohet në nenin 180 të Kodit Penal të Shqipërisë. Karakteristikat e këtyre OJF-ve dhe veprimtaritë e tyre janë të shumëllojshme, si menaxhimi i burimeve natyrore, aktivitetet në fushën e arsimit dhe kulturës, shtëpi shërbimi për të moshuarit dhe personat me çrregullime të rënda mendore, si dhe aktivitetet e shoqatave dhe organizatave ekonomike e të punëdhënësve.

**75.** DPPPPP-ja raportoi se numri i RAD-ve<sup>28</sup> të referuara nga subjektet raportuese me dyshime për FT-në në lidhje me OJF-të është shumë i ulët në krahasim me numrin total të RAD-ve. Pra, për periudhën 2015-2018, vetëm 10 nga 5,520 RAD-e ishin të lidhura me OJF-të (0.18%). E njëjta tendencë vërehet për periudhën 2019 - 2021, rreth 2 -3 RAD-e në vit lidhur me OJF-të. Njësia e inteligjencës, DPPPPP-ja shkëmben informacione lidhur me dyshimet për FT-në me Prokurorinë, Policinë e Shtetit Shqiptar dhe DPT-në si autoriteti mbikëqyrës i OJF-ve dhe tipologjitë e këtyre rasteve përfshijnë:

- Tërheqje të shpeshta nga llogaria e OJF-ve që funksionojnë në Shqipëri pa një dokument mbështetës apo bindës mbi përdorimin e fondit;
- Transfertat në formën e dhurimeve për OJF-të nga donatorë të huaj pa një dokument mbështetës apo bindës;
- Depozitimi me para në dorë në llogarinë e OJF-së nga një burim financimi që nuk vërtetohet me dokumente.

## Të dhënat cilësore

**76.** Krahas kërkesës me shkrim për të siguruar të dhëna, me të njëjtat agjenci qeveritare dhe institucione publike u krye një anketim, përmes të cilit u analizua opinioni i tyre mbi natyrën e kërcënimit të FT-së ndaj OJF-ve në vend. Një anketë e ngjashme u krye edhe me institucionet financiare. Anketa u dërgua tek të gjitha institucionet financiare në vend (12 banka dhe 32 institucione financiare jo-banka). Si rezultat, 15 institucione kthyhen përgjigje: 7 banka dhe 8 institucione financiare jo-banka. (shih Seksionin A për detaje). Gjetjet kryesore në lidhje me natyrën e kërcënimit të FT-së ndaj OJF-ve janë si më poshtë:

**77.** Pothuajse të gjitha institucionet financiare dhe shumica e institucioneve publike identifikuan OJF-të që punojnë në fushën e bamirësisë, ndihmës humanitare dhe veçanërisht në promovimin e ideve fetare si më të rrezikuara për FT-në.

<sup>28</sup> Raporte të Aktivitetit të Dyshimtë.

78. Policia e Shtetit pohoi se OJF-të mund të shfrytëzohen për të përhapur ide radikale që nuk përshtaten me komunitetin tradicional fetar. Flukset e parave të përdorura për qëllime radikalizmi vijnë nga jashtë dhe kanalizohen nëpërmjet degëve të hapura në Shqipëri me një administrator shqiptar ose të huaj.
79. Transferimi dhe përdorimi i fondeve për llogari të organizatave terroriste ose individëve të lidhur me këto organizata përmendet si një kërcënim me rrezik të ulët nga Policia e Shtetit, duke qenë se nuk ka të dhëna për OJF-të e krijuara në Shqipëri që veprojnë në zona konflikti (në lidhje me terrorizmin) ose pranë zonave të tyre kufitare, OJF-të e krijuara në zonat e konfliktit (të lidhura me terrorizmin) ose pranë zonave të tyre kufitare, apo OJF-të e përfshira ose në rrezik të rekrutimit të personave.
80. Kërcënimi i FT-së ndaj OJF-ve lidhet me shfrytëzimin e OJF-ve nga terroristët dhe organizatat terroriste që financojnë aktivitetet e terrorizmit për të mbledhur fonde, për të ofruar mbështetje logjistike dhe për të inkurajuar ose lehtësuar rekrutimin e terroristëve. Kjo e fundit përmendet edhe nga një bankë, e cila konsideron se natyra e rrezikut të FT-së mund të jetë edhe e natyrës ekonomike. Ofrimi i ndihmës ekonomike për njerëzit e varfër mund të përdoret për të kanalizuar fonde të dyshimta dhe për të rekrutuar këta banorë vendas për t'u përfshirë në akte terroriste. Puna me grupet e marginalizuara, i ekspozon OJF-të ndaj kërcënimit të përfshirjes në veprimtarinë e tyre të përditshëm të njerëzve dhe flukseve të paligjshme financiare. Dy banka raportojnë se niveli i lartë i varfërisë konsiderohet si kërcënim.
81. Prania e një grupi individësh si muxhahedinët, refugjatët afganë, të kthyerit nga lufta në Siri dhe aleancat e forta me vendet perëndimore që janë kryesisht objektivi i terrorizmit konsiderohen si një faktor rreziku nga një institucion financiar.

## Identifikimi i natyrës së kërcënimit

82. Ekziston një konsensus i gjerë në vlerësimet e rrezikut dhe vlerësimet e jashtme se kërcënimi i terrorizmit dhe financimi i terrorizmit në Shqipëri është i ulët. Pavarësisht disa mangësive të konstatuara në vlerësimet e rrezikut të ndërmarra nga autoritetet, si dhe në aftësinë e autoriteteve për të zbuluar ose hetuar FT-në, asnjë nga vlerësimet e jashtme të shqyrtuara nuk e vë në dyshim këtë vlerësim të rëndësishëm se kërcënimi ka gjasa të jetë i ulët.
83. Pyetësi i perceptimeve me institucionet publike dhe financiare (si dhe përgjigja ligjore) qëndron në kontrast me përfundimet e këtyre vlerësimeve, me një opinion të ndarë gjerësisht që OJF-të kanë rrezik të lartë për qëllime FT-je, duke variuar nga i vogël tek i mesëm për institucionet publike dhe nga i mesëm tek i lartë për institucionet financiare. Kjo mund të jetë si trashëgimi e sfidave që autoritetet kanë ndeshur me radikalizmin fetar gjatë viteve 2000-2010.
84. Pavarësisht se nuk ka patur ndodhi terroriste, provat cilësore zbuluan një numër të vogël dyshimesh për financimin e terrorizmit, me katër hetime dhe një numër të vogël RTD-sh.
85. Vlerësimet mbi kërcënimet dhe provat cilësore treguan se ka një konsensus të gjerë mbi ekzistencën e një kërcënimi të mundshëm nga ndikimi ekstremist mbi grupet fetare vendase. Kjo mund të manifestohet në tre mënyra: financimi i aktorëve radikalë vendas nga grupe të huaja; shpërndarja e materialeve ekstremiste; dhe mbështetje për luftëtarët e huaj terroristë.

## Përfundime

86. Mungesa e ndodhive terroriste dhe vlerësimeve të ndryshme të rrezikut tregojnë një nivel të ulët të kërcënimit terrorist. Pavarësisht kësaj, hetimet e vazhdueshme dhe në kohë, si dhe vlerësimet e zgjeruara mbi kërcënimet tregojnë për një kërcënim të mundshëm nga grupet ekstremiste fetare, veçanërisht nga jashtë. Megjithatë, mangësitë e vërejtura në vlerësimet e kërcënimeve deri më sot dhe mungesa e konsistencës në përgjigje do të thotë se ky përfundim nuk paraqet një nivel të lartë besimi.

### **Kërcënimi i mundshëm i FT-së për OJF-të në Shqipëri**

1. Grupet ekstremiste fetare (të huaja)

### **Si mundet që terroristët të abuzojnë me OJF-të**

1. Financimi i huaj për simpatizantët vendas të lidhur me OJF-të
2. Përdorimi i OJF-ve për të përhapur propagandën ekstremiste
3. Përdorimi i OJF-ve për të rekrutuar luftëtarë të huaj terroristë (LHT)

# G. IDENTIFIKIMI I OJF-VE POTENCIALISHT “NË RREZIK” NGA FINANCIMI I TERRORIZMIT

87. Paragrafi 8.1(a) i Metodologjisë së FATF-së thotë se vendet duhet “të përdorin të gjitha burimet përkatëse të informacionit, për të identifikuar tiparet dhe llojet e OJF-ve të cilat, në bazë të veprimtarive apo karakteristikave të tyre, ka të ngjarë të jenë në rrezik ndaj abuzimit me financimin e terrorizmit”.
88. Kjo pjesë e vlerësimit të rrezikut fokusohet në faktorët ose tiparet e përbashkëta të rrezikut të FT-së për OJF-të në Shqipëri. Cili është rreziku që një OJF të abuzohet për qëllime të FT-së? A ka lloje të veçanta të OJF-ve, apo veprimtari të veçanta, të cilat shfaqin rrezik të qenësishëm? Ky vlerësim kombinon të dhënat sasiore (dëshmitë e shfaqjes së këtij rreziku) me të dhënat cilësore (pikëpamjet e ekspertëve mbi atë që rrezikukat të ngjarë të jetë).

## Ndodhi të njohura të financimit të terrorizmit në sektorin e OJF-ve

89. Kërkesa me shkrim mbi të dhënat për financimin e terrorizmit në sektorin e OJF-ve u dërguan tek 10 (dhjetë) agjenci qeveritare dhe institucione publike. Këtyre institucioneve iu kërkuar të jepnin të dhëna mbi:
- Dënimet ose ndjekjet penale të OJF-ve për financimin e terrorizmit;
  - Kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike ose kërkesa të ngjashme (kërkesa zyrtare ndërqeveritare për informacion) në lidhje me OJF-të;
  - Hetimin e OJF-ve për FT;
  - Veprimet e sigurisë kombëtare/inteligjencës së OJF-ve për FT;
  - Ndërhyrjet rregullatore të OJF-ve për FT;
  - Statistikat për RTD/RAD në lidhje me OJF-të;
  - Shkëmbimin e informacionit (mbikëqyrësit, DPPPP, agjencitë e zbatimit të ligjit) për FT tek OJF-të;
  - Dhe çështje të tjera që nuk janë trajtuar më sipër, lidhur me OJF-të për FT.
90. Siç përmendet në seksionin E, ekipi mori përgjigje nga 9 (nëntë) agjenci qeveritare dhe institucione publike, nga 10 (dhjetë) kërkesa të dërguara. Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar nuk u përgjigj.
91. Policia e Shtetit raportoi 5 (pesë) çështje të hetimit për financim terrorizmi. Një prej çështjeve është pezulluar për mungesë provash, ndërsa katër të tjerat janë ende nën hetim. Të gjitha çështjet kanë qenë ose janë nën hetim për marrjen e një sasive të konsiderueshme parash përmes sistemit bankar nga OJF të huaja me dyshime për FT-në dhe PP-në, apo nga vende të konsideruara me rrezik të FT-së.



### *Rasti studimor 1* *Anonim*

Org. X operon në Shqipëri prej 22 vitesh. Është një organizatë bamirëse dhe veprimtaritë e saj kryesore lidhen me ndërtimin e xhamive, medreseve, shtëpive për të varfrit, mbështetje për jetimët, arsimin islam, etj. Ajo operon në Elbasan, Kavajë, Shkodër, etj. Është degë e një organizate ndërkombëtare për të cilin ka pasur dyshime se veprimtaria e realizuar nga organizata është e ndryshme nga ajo bamirëse, gjithashtu dhe për keqpërdorim fondesh, për qëllime të ndryshme nga licenca e dhënë. Sipas verifikimeve rezultoi se organizata ka qarkulluar shuma të konsiderueshme parash në sistemin bankar. Në vitin 2005, llogaritë bankare të organizatës dhe shkollës së ngritur prej saj janë konfiskuar në bazë të procedimit penal për veprën penale “Financimi i terrorizmit”, parashikuar në nenin 230/a të Kodit Penal. Sanksionet u pezulluan më datë 23.06.2015 për mungesë provash.

### *Rasti Studimor 2* *Anonim*

OJF-ja është nën hetim për një transaksion të marrë nga një OJF e themeluar në Mbretërinë e Bashkuar. OJF-ja synon “nxitjen dhe propagandimin e besimit fetar; zhvillimin dhe përhapjen e fesë myslimane; edukimin e opinionit publik dhe veçanërisht brezit të ri në frymën e njohjes së fesë myslimane dhe përmirësimin e jetës shpirtërore të besimtarëve myslimanë”. OJF-ja është në pronësi shqiptare.

### *Rasti Studimor 3* *Anonim*

OJF-ja është nën hetim për transaksionet e kryera nëpërmjet sistemit bankar nga Katari. Kjo OJF-ja është degë e një OJF mëmë me bazë në Katar, e dyshuar se përdoret nga elementët e listuar për çështje të financimit të terrorizmit ose pastrimit të parave. OJF-ja synon “nxitjen dhe propagandimin e besimit fetar, zhvillimin dhe përhapjen e fesë myslimane, edukimin e opinionit publik dhe veçanërisht brezin e ri me frymën e njohjes së fesë myslimane dhe përmirësimin jetën shpirtërore të besimtarëve myslimanë”. OJF-ja është në pronësi të huaj.

### *Rasti Studimor 4* *Anonim*

OJF-ja është nën hetim për një shumë të konsiderueshme parash të marra nga Irani, e cila konsiderohet si një kërcënim për shkak të pranisë së komunitetit muxhahidin në Shqipëri. OJF-ja është në pronësi të huaj. OJF-ja synon “Promovimin dhe përhapjen e besimit fetar Shia në Shqipëri”

OJF-ja është nën hetim për marrjen e një sasive të konsiderueshme parash nga vende të konsideruara me rrezik si Katari, Kuvajti dhe Arabia Saudite. OJF-ja është në pronësi shqiptare. Veprimtaria e saj ka në fokus promovimin e fesë islame nëpërmjet botimit të librave, kurseve, etj.

92. DPPPP-ja raportoi se numri i RAD-ve për dyshimet e përfshirjes së OJF-ve në FT është shumë i ulët në krahasim me numrin total të RAD-ve. Për periudhën 2015-2018 u dërguan gjithsej 10 nga 5,520 RAD të OJF-ve për FT (0.18%). E njëjta tendencë vërehet edhe për periudhën 2019 – 2021, gjatë së cilës vetëm 2-3 RAD-e në vit janë identifikuar si të dyshimta të OJF-ve për FT-në. Gjithashtu, DPPPP-ja raportoi se nuk kanë të dhëna/tregues për prezencë të financimit të terrorizmit në sektorin e OJF-ve.
93. Çështje të tjera hetimi që nuk lidhen me FT-në raportohen nga DPT-ja. Katër çështje të OJF-ve të dyshuara për evazion fiskal, me vlerë 54,196,234 lekë. Tre çështje të OJF-ve referohen për veprat penale të fshehjes së të ardhurave, të parashikuara në nenin 180 të Kodit Penal të Shqipërisë. Karakteristikat e OJF-ve dhe veprimtaritë e tyre janë të shumëllojshme, si menaxhimi i burimeve natyrore, veprimtaritë në fushën e arsimit dhe kulturës, shtëpitë e të moshuarve dhe personave me çrregullime të rënda mendore, si dhe aktivitetet e shoqatave dhe organizatave ekonomike dhe të punëdhënësve.
94. Një rast i korrupsionit pasiv u raportua nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku përfshihet një OJF, qëllimi i të cilës është të kontribuojë në zgjidhjen e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve të tjera, për të parandaluar fenomenin e gjakmarrjes.
95. Nga të dhënat e marra nga intervistat me institucionet publike, mund të konstatohet se numri i rasteve të OJF-ve të dyshuara apo të hetuara për FT është i ulët. Karakteristikat kryesore të abuzimit janë transferimi i një sasive të konsiderueshme parash përmes sistemit bankar nga OJF-të e huaja, apo vende në rrezik. Abuzime të tjera të raportuara përfshijnë evazionin fiskal, korrupsionin pasiv dhe fshehjen e të ardhurave.
96. Institucionet e tjera nuk raportuan të dhëna për çështjet e mësipërme.

## Rishikimi i literaturës

97. Shqipëria ka bërë disa përpjekje për të vlerësuar rreziqet e PP/TF-së lidhur me veprimtarinë e OJF-ve në vend. Në vitin 2012, DPPPP-ja publikoi dokumentin “Vlerësimi i Sektorit të OJF-ve në Shqipëri”, dhe në vitin 2015, u realizua një analizë e kufizuar mbi rreziqet për sektorin e OJF-ve në kuadër të VKRR-së. Asnjë nga këto dy analizat nuk identifikuan nëngrupin e organizatave që përkojnë me përkufizimin e FATF-së për OJF-të.
98. Sipas raportit MER 2019, vlerësimi i rrezikut për OJF-të, i kryer nga Shqipëria ishte i kufizuar dhe analiza e veçantë e sektorit nuk zbuloi lidhjet e FT-së për nëngrupin e OJF-ve të analizuara. Sipas legjislacionit të PPP/LFT, autoritetet shqiptare i trajtojnë të gjitha OJF-të me rrezik të lartë për FT-në. Një perceptim i tillë shpjegohet të rrjedhë për arsye historike. Sipas autoriteteve shqiptare, radikalizmi fetar ka qenë një problem madhor në vitet 2000-2010, me komunitetet e vetëshpallura (të paligjshme), komuniteteve të zotëruara ose të kontrolluara nga, përfshirë ato të listuara në UNSCR përkatëse.
99. Në përgjithësi, ekipi i vlerësimit për RVN 2018 evidentoi se pavarësisht se Shqipëria në përgjithësi ka një ide për funksionimin e rrezikut të PP-së dhe FT-së për sektorin e OJF-ve, autoritetet nuk arritën të identifikonin nëngrupin e organizatave që bëjnë pjesë në përkufizimin e FATF-së për OJF-të, apo tipareve dhe llojet e OJF-ve, të cilat për shkak të veprimtarive ose karakteristikave të tyre ka të ngjarë të jenë në rrezik të abuzimit të FT-së. Shqipëria zbaton masa të zgjeruara për të gjitha OJF-të duke përdorur qasjen “njësoj për të gjitha”, e cila përsëri nuk siguron fokusin tek ato që paraqesin rrezik ndaj FT-së. Një qasje e tillë gjithashtu nuk siguron shpërndarje efektive të burimeve dhe mund të pengojë veprimtaritë legjitime të OJF-ve dhe të ketë një efekt dekurajues për këto organizata.

## Vlerësimi cilësor i rrezikut të FT

100. Agjencitë mbikëqyrëse dhe ato të zbatimit të ligjit ranë dakord mbi opinionin e tyre për madhësinë dhe natyrën e rrezikut të FT-së për OJF-të në vend.
101. Këto institucione publike e konsiderojnë rrezikun e FT-së për OJF-të nga një nivel mesatar drejt një niveli të ulët. Pesë institucione, përkatësisht, Gjykata, CVE-ja, Policia e Shtetit dhe AMF-ja e konsiderojnë rrezikun e ulët, DPPPP-ja e konsideron rrezikun mesatar në të ulët, BSH e vlerëson si rrezik të mesëm.
102. Vlerësimi i DPT-së përmend shfrytëzimin e OJF-ve nga terroristët dhe organizatat që financojnë terrorizmin për të mbledhur fonde, për të siguruar mbështetje logjistike dhe për të inkurajuar ose lehtësuar rekrutimin e terroristëve.

Kryesisht ato OJF që ushtrojnë veprimtari jashtë një vendi, janë të mëdha dhe kanë donatorë (individë, qeveri, biznese, etj.) nga vende të ndryshme, kanë një rrezik më të lartë të FT-së.

*Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve*

103. Numri i lartë i OJF-ve, mungesa e mbikëqyrjes nga një autoritet, dhurimet nga donatorë individualë që nuk banojnë në Shqipëri dhe prania e disa OJF-ve që përdorin fondet e tyre për të bërë propagandë për radikalizmin fetar, janë konsideruar si arsye për vlerësimin e rrezikut të FT-së si të mesëm.

Nuk ka faktorë kyç që vërtetojnë lidhjen me rreziqet e FT-së, por një faktor potencial rreziku mund të jetë vendndodhja ku funksionojnë këto OJF, veçanërisht nëse ato janë në zona të largëta.

*Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave*

104. Mungesa e provave për OJF-të e krijuara në Shqipëri që funksionojnë në zonat e konfliktit apo në zonat kufitare, apo OJF-të e krijuara në zonat e konfliktit apo në zonat kufitare, apo OJF-të e përfshira ose me rrezik rekrutimi personash, duke u kujdesur për vigjilencë të shtuar ndaj OJF-ve nga institucionet financiare, dhe ndryshimet e kufizimet në kuadrin ligjor përmenden si faktorë për vlerësimin e rrezikut si të ulët.
105. Institucionet financiare (banka dhe jo-banka) bien dakord gjithashtu mbi opinionin e tyre për madhësinë dhe natyrën e rrezikut të FT-së për OJF-të në vend (shih Seksionin A për detaje).

Veprimtaritë terroriste kërkojnë mbështetje financiare, dhe një mënyrë për ta siguruar atë është përmes mbledhjes së fondeve, që duken se janë të destinuara për qëllime humanitare, një veprimtari tipike për OJF-të.

*Banka e Shqipërisë*

106. Institucionet financiare e konsiderojnë rrezikun e FT-së për OJF-të nga një nivel mesatar drejt një niveli të lartë. Gjashtë prej tyre e konsiderojnë rrezikun e lartë, gjashtë e konsiderojnë atë të mesëm, dy të ulët dhe një institucion financiar jo bankë mendon se nuk ka kërcënim të FT-së për OJF-të. Vlerësimi nga institucionet financiare bazohet kryesisht në legjislacionin dhe rregulloret ekzistuese të Këshillit të Ministrave dhe të Bankës së Shqipërisë<sup>29</sup> dhe raportet ndërkombëtare të vlerësimit, në vend që të bazohet tek përvoja konkrete me OJF-të (asnjë prej tyre nuk raportoi ndonjë rast/përvojë në lidhje me FT për OJF-të). Nisur nga kjo, disa prej tyre kanë vendosur të mos punojnë me OJF-të.

<sup>29</sup> Rregullore nr. 44 datë 10.06.2009 "Mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", Shtojca 1 "Udhëzues për vlerësimin e rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit", pika 2, shkronja b.

Edhe pse në bazë të kërkesave ligjore, OJF-të konsiderohen si subjekte me rrezik të lartë të FT ose PP, ne mendojmë se në përgjithësi, duke pasur parasysh përvojën tonë me OJF-të, bazuar në veprimtarinë dhe programet e tyre, mënyrën organizative dhe financimin e tyre, rreziku është i një niveli të mesëm.

### *Institucion financiar - Bankë*

- 107.** Arsyet e dhëna nga bankat për vlerësimin e tyre lidhen me paqëndrueshmërinë politike, nivelin e korrupsionit, papunësinë, shkallën e varfërisë, mungesën e monitorimit nga institucionet publike për shkak të numrit të lartë të OJF-ve, transaksioneve të parave në rrugë jo zyrtare, si dhe besimit të lartë që publiku ka për OJF-të, duke qenë se këta të fundit ushtrojnë veprimtaritë e ndihmave humanitare, gjë që i bën ata një objektiv abuzimi.

Nuk kemi asnjë rast konkret të raportuar, por ekzistenca e një numri relativisht të lartë të OJF-ve që promovojnë ideologjinë fetare dhe që veprojnë gjithashtu si organizata bamirëse, është një rrezik potencial. Niveli i varfërisë është gjithashtu një kërcënim, ndaj e konsideroj rrezikun të lartë.


### *Institucion financiar - Bankë*

Sektori i OJF-ve është shumë i larmishëm dhe për këtë arsye shkalla e ekspozimit ndaj riskut të financimit të terrorizmit ndryshon në varësi të strukturës organizative dhe fushës së veprimtarisë së OJF-ve. OJF-të që operojnë në Shqipëri mund të kenë një risk më të lartë të financimit të terrorizmit në rastet kur përdorin shërbime alternative të dërgesave të parave apo paguajnë për mallrat ose shërbimet kryesisht në formën e parasë fizike (cash), kur angazhojnë individë apo organizata të tjera për të ofruar shërbimet, pa kryerjen paraprakisht të proceseve të përzgjedhjes dhe kur nuk janë në gjendje të ushtrojnë kontroll të drejtpërdrejtë mbi programet ose projektet që zbatohen përmes nënkontraktimit.

### *Institucion financiar - Jo Bankë*


- 108.** Cënueshmëria e OJF-ve ndaj rrezikut të FT-së, sipas institucioneve jo banka lidhet me besimin e publikut ndaj OJF-ve dhe praninë e gjerë të tyre në vend.
- 109.** Anketimi për OJF-të matë perceptimin e këtyre të fundit për rrezikun e financimit të terrorizmit. Ai zbuloi se OJF-të e perceptojnë rrezikun e keqpërdorimit të OJF-të për FT të ulët dhe për to si organizatë nuk ka rrezik të keqpërdoren për FT.
- 110.** Siç paraqitet në figurën 13, gjysma e OJF-ve pjesëmarrëse në anketim e konsiderojnë sektorin me rrezik të ulët për FT (15% rrezik shumë i ulët; 32% rrezik i ulët; dhe 6% pa rrezik fare), ndërsa 18% e tyre nuk kanë asnjë ide për këtë.

**Figura 13: Rreziku i keqpërdorimit të sektorit të OJF-ve për TF (Burimi: Anketimi për OJF-të, nr. = 153 OJF)**




**111.** Kur u pyetën për nivelin e rrezikut të organizatës së tyre, shumica (78%) përmendën se nuk asnjë rrezik që ata të keqpërdoren për FT-në, siç paraqitet në Figurën 14.

**Figura 14: Rreziku që OJF-ja mund të keqpërdoret për FT. (Burimi: Anketimi për OJF-të, nr. = 153 OJF)**




**112.** Nuk ka dallim në përgjigjet e OJF-ve në bazë të formës së tyre ligjore (qendra, fondacione, shoqata) për nivelin e rrezikut në sektor, ndërkohë që vihet re një ndryshim i vogël në përgjigjet e tyre për nivelin e rrezikut të organizatës së tyre. Siç paraqitet në figurën 15, fondacionet priren ta perceptojnë veten me rrezik shumë të vogël ndaj FT-së (35%), më shumë se qendrat dhe shoqatat (16% dhe 12% përkatësisht).

**Figura 15: Rreziku që OJF-të mund të keqpërdoren për FT-në, sipas formës ligjore të OJF-ve (Burimi: Anketimi për OJF-të, nr. = 153 OJF)**




**Figura 16: Perceptimi i OJF-ve për rrezikun e FT të organizatës së tyre (Burimi: Anketimi për OJF-të, nr. = 153 OJF)**



**113.** Kur u kërkua të vlerësonin rreziqet e mëposhtme për organizatën e tyre: Pastrimi i Parave, Financimi i Terrorizmit, Korrupsioni, Mashtrimi, të anketuarit e konsideruan mashtrimin (44%) si rrezikun më të lartë për organizatën e tyre, të ndjekur nga korrupsioni (27%), ndërsa financimi i terrorizmit konsiderohet si rreziku më i ulët (86%), i ndjekur nga pastrimi i parave, të cilët 24% e të anketuarve e konsiderojnë si rrezikun më të ulët.

**114.** Vetëm 4 OJF (nga 153) e kanë cilësuar FT-në si rrezikun më të lartë. Të gjitha ato ushtrojnë veprimtari në fushën e fuqizimit të grave, barazisë dhe politikave gjinore dhe zhvillimit të vullnetarizmit. Të ardhurat e tyre vjetore janë më pak se 5 milionë lekë (rreth 41,000 euro), burimet e fondeve që zënë më shumë se 5% janë grantet, kontratat dhe dhurimet e marra nëpërmjet bankës në mënyrë zyrtare.

**Figura 17: Perceptimi i mashtrimit, korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (Burimi: Anketimi për OJF-të, nr. = 153 OJF)**



## Natyrë e çdo rreziku të financimit të terrorizmit për sektorin e OJF-ve

**115.** Siç u përshkrua më lart, janë katër raste nën hetim për FT të raportuara nga Policia e Shtetit. Rastet kanë disa elemente/karakteristika të përbashkëta, si në vijim:

- Të gjithë kanë qenë/janë nën hetim për transaksione të një shume të konsiderueshme parash nga vende të huaja si Britania e Madhe, Irani (i konsideruar si kërcënim për shkak të pranisë së komunitetit Muxhahedin në Shqipëri) dhe Katari përmes sistemit bankar.
- Të gjitha organizatat kanë aktivitet fetar.
- Ato janë degë (dy prej tyre) të organizatave të huaja, njëra prej të cilave është një organizatë bamirëse me qendër në Mbretërinë e Bashkuar, të dyshuara për keqpërdorim fondesh dhe devijime të bamirësisë, dhe tjetra është OJF me seli në Katar, e dyshuar se është përdorur nga elementë të listuar për çështje të financimit të terrorizmit apo pastrimit të parave.

**116.** Në mungesë të provave primare, çdo vlerësim mbi OJF-të të cilat mund të jenë potencialisht në rrezik duhet të mbështetet nga (1) analiza dytësore sipas analogjisë (një analizë e rasteve që kanë një nga karakteristikat e mësipërme për të identifikuar çdo faktor të përbashkët përkatës) dhe (2) vlerësimi cilësor i ekspertëve dhe palëve të interesuara (zyrtarët përkatës të qeverisë dhe të OJF-ve).

**117.** Raste analoge (1): TF-ja në OJF jashtë Shqipërisë. Institucioni Horizontal i Këshillit të Evropës për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë II Veprimi kundër Krimin Ekonomik (HFII-AEC-REG) ka shkruar një dokument teknik për të vlerësuar rreziqet rajonale të abuzimit të financimit të terrorizmit të OJF-ve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi<sup>30</sup>. Në kohën e shkrimit të këtij raporti, rezultatet nuk ishin publikuar. Vlerësimi i rrezikut identifikoi 10 (dhjetë) rreziqe, të listuara më poshtë:

- OJF-të fetare/etnike/kulturore;
- OJF-të humanitare, bamirëse dhe organizata të cilat japin ndihma;

<sup>30</sup> Vlerësimi i rrezikut rajonal të financimit të terrorizmit të sektorit jofitimprurës (OJF) në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi – 2020/2021

- Financimi i huaj për OJF-të që vijnë nga vende me rrezik të lartë ose burime të paverifikueshme;
- Financimi i OJF-ve të huaja që vijnë nga diaspora;
- Mbledhja e fondeve me para fizike (cash);
- Shërbimet e transfertave të parave dhe kanale të tjera alternative për lëvizjen e fondeve, përveç sektorit formal bankar;
- OJF-të që janë aktive në zonat me rrezik të lartë në juridiksion të tyre;
- Luftëtarët e huaj terroristë që janë kthyer në atdheun e tyre;
- OJF-të që përdoren/abuzohen për promovimin e propagandës që synon të radikalizojë individët drejt ekstremizmit dhe terrorizmit;
- Migrimi i paligjshëm ose i parregullt në rajon.

**118.** Vlerësimi cilësor (1): Zyrtarët qeveritarë. Organeve mbikëqyrëse dhe zyrtarët e zbatimit të ligjit të anketuar dhe intervistuar iu kërkua të identifikonin se cilët mund të jenë faktorët e mundshëm të rrezikut për financimin e terrorizmit tek OJF-të. U vunë në dukje faktorët në vijim:

**Faktor rreziku 1: Financimi i huaj (shuma të mëdha).** Transaksioni i shumave të konsiderueshme të parave që vijnë nga vendet e huaja nëpërmjet sistemit bankar.

**Faktor rreziku 2: Burimet e financimit (burime me rrezik të lartë).** Burime financimi të dyshimta, të padeklaruar dhe të paidentifikuara, veçanërisht financime të huaja që vijnë nga vende të ndryshme, kryesisht nga zonat e konfliktit, dhe ku ka veprimtari terroriste.

**Faktor rreziku 3: Aktiviteti fetar.** OJF-të që promovojnë ideologjinë fetare të përfshira në bamirësi dhe ndihma humanitare për njerëzit në nevojë (pavarësisht fesë së tyre), përmenden si në rrezik për t'u keqpërdorur për TF.

**Faktor Rreziku 4: Degët e organizatave të huaja (të dyshimta).** Bazuar në të dhënat e marra, shumica e organizatave që janë nën hetim për TF-në janë degë të organizatave të huaja, të dyshuara në vendin e tyre për shpërdorim fondesh.

**Faktori 5 i rrezikut: Vendndodhja e organizatës.** OJF-të që punojnë në zona të njohura për veprimtari terroriste, OJF-të e vendosura në zona të largëta ose ato që nuk kanë një vendndodhje të qartë të deklaruar konsiderohen të rrezikuara nga FT-ja.

## Identifikimi i tipareve dhe llojeve të OJF-ve që mund të jenë 'në rrezik' nga TF

**119.** Në përputhje me 'Identifikimin e veçorive dhe llojeve të OJF-ve të cilat për shkak të aktiviteteve ose karakteristikave të tyre, ka të ngjarë të jenë në rrezik të abuzimit me financimin e terrorizmit (Metodologjia FATF 8.1(i))': Bazuar në faktorët e rrezikut të identifikuar si më sipër, dhe provat nga rastet e hetimit të ofruara nga institucionet shtetërore, aktivitetet dhe karakteristikat e mëposhtme të OJF-ve mund të rrisin rrezikun e abuzimit me TF-në.

### **OJF-të dhe aktivitetet e OJF-ve që ka të ngjarë të jenë në rrezik në rritje të abuzimit me TF**

1. OJF-të me veprimtari humanitare dhe bamirëse.
2. Veprimtari bamirëse dhe/ose edukative e OJF-ve fetare.
3. Shuma të mëdha financimi të huaja nga burime me rrezik të lartë.
4. Përdorimi i parasë fizike (cash) apo transaksioneve alternative jashtë sistemit formal bankar.
5. Aktivitete në zona të thella.



Më shumë detaje për këta faktorë rreziku jepen më poshtë:

- 120. Organizatat me veprimtari humanitare dhe bamirëse.** Sipas informacionit të dhënë nga DPT-ja në maj 2021, organizatat humanitare, fetare dhe bamirëse përfaqësojnë vetëm 3,1% nga 2,372 organizata të regjistruara në DPT. Nga ana tjetër, sipas anketës me OJF-të, 21% e 153 organizatave të anketuara kanë raportuar se ofrojnë ndihmë humanitare. Intervistat me autoritetet shtetërore dhe institucionet financiare sugjerojnë se këto organizata konsiderohen më të cënueshme dhe me rrezik më të lartë për t'u keqpërdorur për abuzim të TF-së, sepse aktivitetet humanitare mund të përdoren si mundësi për mbledhjen e fondeve për veprimtari terroriste, apo fondet e mbledhura për qëllime bamirësie, mund të përdoret për TF-në ose aktivitete të tjera të paligjshme. Këto organizata kanë një nivel të lartë besimi në komunitet, i cili mund të përdoret nga grupet terroriste për të financuar aktivitetin e tyre të paligjshëm.
- 121. Aktivitet bamirësie dhe/ose edukative të OJF-ve fetare.** Këto organizata grupohen nga DPT-ja së bashku me organizatat humanitare dhe bamirëse, duke përfaqësuar 3.1% të të gjitha organizatave të regjistruara në DPT. Nga anketa me OJF-të, vetëm 2% kanë raportuar promovimin e besimit fetar si fushë të veprimtarisë së tyre. Numri i organizatave fetare të përzgjedhura nga databaza e DPT-së të OJF-ve për të marrë pjesë në anketë ishte më i lartë, por shkalla e përgjigjeve ishte e ulët. Sipas intervistave me autoritetet publike dhe institucionet financiare, rreziku me këtë grup organizatash mbështetet në shfrytëzimin për përhapjen e orientimeve radikale. Këto organizata konsiderohen se kanë aftësi më të larta për mbledhjen e fondeve dhe mund të lidhen me organizata terroriste jashtë vendit. Të gjitha rastet që janë nën hetim për TF-në janë nën këtë kategori organizatash.
- 122. Shuma të mëdha financimi të huaja nga burime me rrezik të lartë.** Sipas intervistave me autoritetet publike dhe institucionet financiare, financimi i aktiviteteve radikale që promovojnë disa OJF fetare që janë jashtë kontrollit të pesë bashkësive fetare në Shqipëri, bëhet me fonde të huaja që vijnë nga vende të njohura për veprimtari terroriste. Nga anketa me OJF-të rezultoi se një shumicë e madhe e OJF-ve të anketuara (86%) marrin fonde, mallra apo shërbime nga vende të tjera, por shumica e këtyre fondeve (92%) vijnë nga grante dhe kontrata me institucione shtetërore të huaja dhe janë të kanalizuar përmes sistemit bankar. Të gjitha rastet janë nën hetim për transaksione të dyshimta të shumave të mëdha nga burime me rrezik të lartë (vende apo organizata).
- 123. Përdorimi i parasë fizike (cash) ose i transaksioneve alternative jashtë sistemit bankar formal.** Ekzistenca e një ekonomie informale të bazuar në para fizike në vend besohet nga disa të intervistuar si një faktor që ndihmon grupet terroriste që mund të përfitojnë nga kjo për të financuar aktivitetin e tyre. Bazuar në intervistat me institucionet financiare, perceptohet se OJF-të që mbledhin fonde në mënyra jo të zakonshme si kriptovalutat, Paypal, etj., janë në rrezik më të lartë të TF-së. Por, nga anketimi me OJF-të, rezultoi se **asnjë nga OJF-të e anketuara nuk raporton të marrë fonde nëpërmjet kanaleve jo-banka**, si ofruesit e shërbimeve monetare, apo kripto-valutat.
- 124. Veprimtari në zona të thella.** Disa autoritete shtetërore dhe institucione financiare të intervistuar e konsiderojnë këtë si faktor rreziku dhe e lidhin me mungesën e kontrollit të duhur nga autoritetet shtetërore. Nuk ka të dhëna të disponueshme për numrin e OJF-ve apo aktivitetet e tyre në zona të thella.

**125. Tabela 2: Prevalenca e faktorëve të rrezikut (burimet e listuara)**

Faktori i Rrezikut	Prevalenca	Burimi
OJF-të me veprimtari humanitare dhe bamirëse	E ulët në mesatare: ndërmjet 3.1% - 21%	Databaza e DPT-së, Anketimi me OJF
Veprimtari bamirëse dhe/ose edukative e OJF-ve fetare	E ulët: 2%- 3.1 %	Databaza e DPT-së, Anketimi me OJF-të – niveli i përgjigjeve ishte i ulët

Shuma të mëdha financimi të huaja nga burime me rrezik të lartë	3.17% e financimeve të huaja vijnë nga juridiksione të FATF-së nën monitorim më të lartë në 2021 <sup>31</sup>	Banka e Shqipërisë
(i) Përdorimi i parave fizike (cash) ose transaksionet alternative jashtë sistemit bankar formal	(i) E ulët-mesatare (para fizike (cash)) (ii) Asnjë (Burime të tjera alternative)	Anketimi me OJF-të
Aktivitete në zona të thella	E panjohur	Nuk ka

126. Tabela 3: Relevanca e faktorëve të rrezikut (burimet e listuara)

Faktori i Rrezikut	Prevalenca	Relevanca
OJF-të me veprimtari humanitare dhe bamirëse	E ulët në mesatare: ndërmjet 3.1% - 21%	E Mesme – E Lartë
Veprimtari bamirëse dhe/ose edukative e OJF-ve fetare (përfshirë degët e organizatave të huaja	E ulët: 2%- 3.1 %	E Lartë
Shuma të mëdha financimi të huaja nga burime me rrezik të lartë	E ulët: 3.17%	E Lartë
(i) Përdorimi i parave fizike (cash) (ii) Përdorimi ose transaksionet alternative jashtë sistemit bankar formal	(i) E ulët-mesatare (para fizike (cash)) (ii) Zero (metoda alternative)	E ulët – E mesme
Aktivitete në zona të thella	E panjohur	E Panjohur

**127. Vlerësimi përfundimtar i rrezikut të qenësishëm të OJF-ve në Shqipëri.** Nuk ka asnjë provë përfundimtare për abuzimin e OJF-ve për financimin e terrorizmit në Shqipëri, megjithëse ka katër hetime në vazhdim. Perceptimi i rrezikut ndryshon, megjithëse vihet re se autoritetet me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për luftimin e financimit të terrorizmit vlerësojnë vazhdimisht rrezikun si më të ulët se të anketuarit e tjerë. Ndërsa vlerësimi i përgjithshëm i nivelit të rrezikut nuk është i qartë, ka më shumë konsistencë në faktorët specifikë të rrezikut (shih më sipër).

**128. Në këtë kontekst, rreziku i abuzimit me financimin e terrorizmit të OJF-ve në Shqipëri vlerësohet si i ulët.** Për shumicën e OJF-ve rreziku është shumë i ulët. Për OJF-të humanitare dhe bamirëse dhe organizatat fetare që kryejnë veprimtari edukative dhe/ose bamirëse, rreziku vlerësohet si i ulët i mesëm.

<sup>31</sup> Juridiksionet nën monitorim të shtuar po punojnë në mënyrë aktive me FATF-në për të adresuar mangësitë strategjike në regjimet e tyre për të luftuar pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes. Kur FATF vendos një juridiksion nën monitorim të shtuar, kjo do të thotë se vendi është angazhuar të zgjidhë menjëherë mangësitë strategjike të identifikuara brenda afateve kohore të dakorduara dhe i nënshtrohet një monitorimi të shtuar. Kjo listë shpesh quhet nga jashtë si "lista gri". FATF nuk kërkon aplikimin e masave të kujdesit të shtuar për këto juridiksione, por inkurajon anëtarët e saj dhe të gjitha juridiksionet që të marrin parasysh informacionin në analizën e tyre të rrezikut. Gjeni këtu listën e juridiksioneve nën monitorim të shtuar [http://www.fatf-gafi.org/publications/high-risk-and-other-monitored-jurisdictions/?hf=10&b=0&s=desc\(-fatf\\_releasedate\)](http://www.fatf-gafi.org/publications/high-risk-and-other-monitored-jurisdictions/?hf=10&b=0&s=desc(-fatf_releasedate))

Rreziku i Qenësishëm i FT-së për OJF-të  
I ULËT

# Shtojca 1: Rekomandimet e FATF-së të rëndësishme për OJF-të

## Rekomandimi 8 për Organizatat Jofitimprurëse

### 8. Organizatat Jofitimprurëse

Vendet duhet të rishikojnë përshtatshmërinë e ligjeve dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me grupimin e OJF-ve, të cilin vendi e ka identifikuar si më të cënueshëm për abuzim ndaj financimit të terrorizmit. Vendet duhet të ndërmarrin masa të përqëndruara dhe proporcionale, në linjë me qasjen e bazuar në rrezik, për këto OJF, në mënyrë që ti mbrojnë ato nga abuzimi i financimit të terrorizmit, duke përfshirë:

- organizatat terroriste, të cilat paraqiten si subjekte legjitime;
- shfrytëzimin e subjekteve legjitime si kanale për financimin e terrorizmit, përfshirë qëllimin e shmangies nga masat e ngrirjes së pasurive; dhe
- duke fshehur ose mbuluar devijimin e fondeve të destinuar për qëllime të ligjshme tek organizatat terroriste”.

Është shkëputur nga **Rekomandimet e FATF-së: Standartet Ndërkombëtare në Luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe Përhapjes së Armëve të Shkatërrimit në Masë** (FATF, Qershor 2016).

Metodologjia për Vlerësimin e Përputhjes Teknike me Rekomandimet e FATF-së dhe Efektivitetin e Sistemeve të PPP/LFT (FATF (2013)) ofron udhëzime për vlerësuesit mbi vlerësimin e përputhshmërisë me Rekomandimin 8. Ajo përcakton pyetjet që vlerësuesit duhet të kërkojnë përgjigje në procesin e Vlerësimit të Ndërsjelltë. Metodologjia për Rekomandimin 8 është si vijon:

### Ndërmarrja e një qasjeje të bazuar në rrezik

#### 8.1 Vendet duhet:

- Pa paragjykuar kërkesat e Rekomandimit 1, pasi që jo të gjitha OJF-të paraqesin një rrezik të lartë (disa mund të përfaqësojnë pak ose aspak rrezik), të identifikojnë se cili grup i organizatave bën pjesë në përkufizimin e OJF-ve sipas FATF-së. Për të arritur këtë, vendet duhet të përdorin të gjitha burimet përkatëse të informacionit, në mënyrë që të identifikojnë tiparet dhe llojet e OJF-ve të cilat për shkak të aktiviteteve ose veçorive të tyre, mund të jenë në rrezik nga abuzimi i financimit terrorist;
- Të identifikojnë natyrën e kërcënimeve nga ana e subjekteve terroriste drejt OJF-ve të cilat janë në rrezik, si dhe sesi subjektet terroriste abuzojnë me këto OJF;
- Të rishikojnë përshtatshmërinë e masave, përfshirë ligjet dhe rregulloret, që kanë të bëjnë me grupin e OJF-ve që mund të abuzohen për mbështetjen e financimit të terrorizmit në mënyrë që të jenë në gjendje të ndërmarrin veprime proporcionale dhe efektive për të adresuar rreziqet e identifikuara; dhe
- Vlerësojnë periodikisht sektorin duke rishikuar informacionin e ri mbi cënueshmërinë e mundshme të sektorit ndaj aktiviteteve terroriste për të siguruar zbatimin efektiv të masave.

### Shtrirje e qëndrueshme në lidhje me çështjet e financimit të terrorizmit

#### 8.2 Vendet duhet:

- Të kenë politika të qarta për të promovuar përgjegjshmërinë, integritetin dhe besimin e publikut në administrimin dhe menaxhimin e OJF-ve;
- Të inkurajojnë dhe të ndërmarrin programe arsimore dhe educative për të rritur dhe thelluar ndërgjegjësimin ndërmjet OJF-ve, si dhe komunitetit të donatorëve në lidhje me cënueshmërinë e mundshme të OJF-ve ndaj abuzimit të financimit të terrorizmit dhe risqeve të financimit të terrorizmit, dhe masat që OJF-të mund të marrin për të mbrojtur veten e tyre ndaj një abuzimi të tillë;

- c) Të punojnë me OJF-të për të zhvilluar dhe përmirësuar praktikat më të mira për të adresuar rreziqet dhe çënueshmëritë e financimit të terrorizmit dhe, në këtë mënyrë, t'i mbrojnë ato nga abuzimi i financimit të terrorizmit; dhe
- d) Të inkurajojnë OJF-të të kryejnë transaksione përmes kanaleve të rregulluara financiare, kurdo që të jetë e mundur, duke mbajtur parasysh kapacitetet e ndryshme të sektorëve financiarë në vende të ndryshme dhe fushave të ndryshme të problematikave urgjente bamirëse dhe humanitare.

### **Mbikqyrje apo monitorim i synuar i rrezikut të OJF-ve**

8.3 *Vendet duhet të ndërmarrin hapa për të promovuar mbikëqyrje ose monitorim efektiv, dhe ato janë në gjendje të tregojnë që masat e bazuara në rrezik aplikohen tek OJF-të, që janë në rrezik të abuzimit të financimit të terrorizmit.*

8.4 *Autoritetet përkatëse duhet:*

- a) Të monitorojnë pajtueshmërinë e OJF-ve me kërkesat e këtij Rekomandimi, përfshirë dhe masat e bazuara në rrezik që aplikohen për to, sipas 8.3; dhe
- b) Të jenë në gjendje të zbatojnë sanksione efektive, proporcionale dhe bindëse për shkeljet nga OJF-të ose personat që veprojnë në emër të këtyre OJF-ve.

### **Mbledhja dhe investigimi efektiv i informacionit**

8.5 *Vendet duhet:*

- a) Të sigurojnë bashkëpunim efektiv, koordinim dhe shkëmbim informacioni në masën e duhur ndërmjet të gjitha niveleve të autoriteteve të përshtatshme apo organizatave që zotërojnë informacion të rëndësishëm mbi OJF-të;
- b) Të kenë ekspertizë hetimore dhe aftësi për të shqytruar OJF-të e dyshuara ose të shfrytëzuara nga veprimtaritë terroriste apo që mbështesin aktivisht organizatat terroriste;
- c) Të sigurojnë që aksesit plotë në informacionin mbi administrimin dhe menaxhimin e OJF-ve specifike (përfshirë informacionin financiar dhe programatik) mund të merret gjatë një hetimi; dhe
- d) Të krijojnë mekanizma të përshtatshëm për tu siguruar se, kur ekziston dyshimi ose baza të arsyeshme për të dyshuar se një OJF specifike: (1) është e përfshirë në abuzimin e financimit të terrorizmit dhe/ose është fasadë për ngritjen e fondeve nga një organizatë terroriste; (2) po shfrytëzohet si një kanal për financimin e terrorizmit, duke përfshirë qëllimin e shmangies së masave të rrepta të ngrirjes së aseteve, ose formave të tjera të mbështetjes së terrorizmit; ose (3) është duke fshehur ose po abuzon me devijimin e paligjshëm të fondeve të destinuara për qëllime të ligjshme duke i përcjellë ato për përfitime të terroristëve ose organizatave terroriste, duhet që ky informacion të ndahet menjëherë me autoritetet përkatëse kompetente, në mënyrë që të marrin masa parandaluese ose hetimore.

### **Kapacitete efektive për t'iu përgjigjur kërkesave ndërkombëtare për informacion në lidhje me një OJF që ngjall shqetësim.**

8.6 *Vendet duhet të identifikojnë pikat e duhura të kontaktit dhe procedurat për t'iu përgjigjur kërkesave ndërkombëtare për informacion në lidhje me OJF specifike të dyshuara për financimin e terrorizmit ose përfshirje në forma të tjera të mbështetjes së terrorizmit.*

Shkëputur nga **Metodologjia për Vlerësimin e Përputhjes Teknike me Rekomandimet e FATF-së dhe Efektivitetin e Sistemeve të PPP/LFT (FATF, rishikuar Shkurt 2019)**

## 🔗 Rezultati i Drejtëpërdrejtë 10

**Rezultati i drejtëpërdrejtë 10:** Terroristët, organizatat terroriste dhe financuesit e terrorizmit pengohen nga mbledhja, lëvizja dhe përdorimi i fondeve, si dhe nga abuzimi me sektorin e OJF-ve.

**Karakteristikat e një sistemi efektiv:** Terroristët, organizatat terroriste dhe rrjetet e mbështetjes terroriste identifikohen dhe privohen nga burimet dhe mjetet për të financuar ose mbështetur aktivitetet dhe organizatat terroriste. Kjo përfshin zbatimin e duhur të sanksioneve financiare të synuara kundër personave dhe subjekteve të përcaktuara nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara dhe sipas regjimeve të zbatueshme të sanksioneve kombëtare ose rajonale. Vendi gjithashtu ka një kuptim të mirë të rreziqeve të financimit të terrorizmit dhe ndërmer veprime të përshtatshme dhe proporcionale për të zbutur këto rreziqe, duke përfshirë masat që parandalojnë mbledhjen dhe lëvizjen e fondeve përmes subjekteve ose metodave që janë në rrezikun më të madh për t'u keqpërdorur nga terroristët. Në fund të fundit, kjo redukton flukset e financimit të terrorizmit, gjë që do të parandalonte aktet terroriste. Ky rezultat lidhet kryesisht me Rekomandimet 1, 4, 6 dhe 8, si dhe me elementet e Rekomandimeve 14, 16, 30 deri në 32, 37, 38 dhe 40."

IO.10 ofron shembuj informacioni që mund të mbështesin konkluzionet e vlerësuesve:

### 🔗 a) Shembuj informacioni që mund të mbështesin konkluzionet mbi çështjet thelbësore

1. Përvojat e autoriteteve të zbatimit të ligjit, NjIF dhe kundër terrorizmit (p.sh., tendencat që tregojnë se financuesit e terrorizmit po hulumtojnë metoda alternative për mbledhjen/transmetimin e fondeve; raportimi i inteligjencës/burimit që tregon se organizatat terroriste kanë vështirësi në mbledhjen e fondeve në vend).
2. Shembuj të ndërhyrjeve dhe konfiskimeve (p.sh.; ... hetimet dhe ndërhyrjet në OJF-të e keqpërdorura nga terroristët).
- ...4. Informacion mbi mbikëqyrjen dhe monitorimin e OJF-ve (p.sh. shpeshësia e rishikimit dhe monitorimit të sektorit të OJF-ve (përfshirë vlerësimet e rrezikut); shpeshësia e angazhimit dhe komunikimit (përfshirë udhëzimet) ndaj sektorit të OJF-ve në lidhje me masat dhe tendencat e CFT-së; masat korrigjuese dhe sanksionet e marra ndaj OJF-ve)."

Më tej jep shembuj të faktorëve specifikë që mund të mbështesin konkluzionet e vlerësuesve.

### 🔗 b) Shembuj të Faktorëve Specifikë që mund të mbështesin konkluzionet mbi çështjet thelbësore

- ...10. Cili është niveli i licencimit apo regjistrimit për OJF-të? Deri në çfarë mase ndërmerret një qasje e ndjeshme ndaj rrezikut për të mbikëqyrur ose monitoruar OJF-të në rrezik nga abuzimi terrorist dhe miratohen veprimet dhe mekanizmat e duhur të bashkëpunimit parandalues, hetimor, penal, civil ose administrativ?
11. Sa mirë i kuptojnë OJF-të dobësitë e tyre dhe i respektojnë masat për t'u mbrojtur nga kërcënimi i abuzimit terrorist?"

Metodologjia për Vlerësimin e Përputhshmërisë Teknike ofron 'Shënime për Vlerësuesit' se si të vlerësohet IO.10. Shënimet që lidhen me OJF-të janë si më poshtë:

🔗 **Shënim për vlerësuesit:** Vlerësuesit duhet gjithashtu të marrin në konsideratë gjetjet përkatëse mbi nivelin e bashkëpunimit ndërkombëtar në të cilin po marrin pjesë autoritetet kompetente kur vlerësojnë këtë Rezultat të Menjëhershëm.

**Çështjet thelbësore që duhen marrë parasysh në përcaktimin nëse Rezultati është duke u arritur.**

...10.2. Deri në çfarë mase, pa ndërprerë aktivitetet legjitime të OJF-ve, vendi ka zbatuar një qasje të synuar, ka kryer kontakte dhe ka ushtruar mbikëqyrje në trajtimin e OJF-ve që janë në rrezik nga kërcënimi i abuzimit terrorist?...

...10.4. Deri në çfarë mase masat e mësipërme janë në përputhje me profilin e përgjithshëm të rrezikut të TF?"

Shkëputur nga **Metodologjia për Vlerësimin e Përputhjes Teknike me Rekomandimet e FATF-së dhe Efektivitetin e Sistemeve të PPP/LFT (FATF, 2013)**

## Shtojca 2: Kategorizimi i vendeve sipas rrezikut terrorist

Duke përdorur të dhëna nga Indeksi i Terrorizmit Global 2022: Matja e Ndikimit të Terrorizmit (Instituti për Ekonomi dhe Paqe, Gl, Sydney, Mars, 2022) në dispozicion nga:

<https://reliefweb.int/report/world/global-terrorism-index-2022>

Rrezik shumë i lartë	Afganistan, Irak, Somali, Burkina Faso, Siri, Nigeri, Mali
Rreziku i lartë	Nigeri, Pakistan, Kamerun, Indi, Mozambik, Kolumbi, Egjipt, Filipine, Republika Demokratike e Kongos, Kili, Çad, Kenia
E mesme	Jemen, Tajlandë, Turqi, Indonezi, Sri Lanka, Libi, Iran, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Greqi, Izrael, Mbretëri e Bashkuar, Palestinë, Gjermani, Nepal, Francë, Tanzani, Peru, Tunizi, Algjeri, Bangladesh, Zelandë e Re, Bregu i Fildishtë, Burundi, Rusi, Ugandë, Venezuelë
E ulët	Taxhikistan, Kanada, Etiopi, Itali, Liban, Austri, Benin, Arabi Saudite, Spanjë, Ekuador, Argjentinë, Jordani, Zvicër, Australi, Meksikë, Ukrainë, Malajzi, Paraguaj, Bahrein, Holandë
Shumë e ulët	Kinë, Belgjikë, Suedi, Senegal, Japoni, Uruguai, Ruandë, Afrikë e Jugut, Togo, Marok, Norvegji, Irlandë, Rumani, Finlandë, Brazil, Qipro, Lituani, Mauritani, Vietnam, Angolë, Republikë Çeke, Danimarkë, Gabon, Kosovë, Sudan, Tajvan
Asnjë ndikim	Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Butan, Bolivi, Bosnje dhe Hercegovinë, Botsvanë, Bullgari, Kamboxhia, Republika e Afrikës Qendrore, Kosta Rika, Kroaci, Kubë, Xhibuti, Republika Domenikane, El Salvador, Guinea Ekuatoriale, Eritrea, Estoni, Gjeorgji, Gana, Guatemala, Guinea, Guinea-Bissau, Guajana, Haiti, Honduras, Hungari, Islandë, Xhamajkë, Kazakistan, Kuvajt, Republika e Kirgistanit, Laos, Letoni, Lesoto, Liberi, Maqedoni (IRJ), Madagaskar, Malavi, Mauritius, Moldavi, Mongoli, Mali i Zi, Namibia, Nikaragua, Koreja e Veriut, Omani, Panamaja, Papua Guinea e Re, Polonia, Portugali, Katar, Republika e Kongos, Serbi, Sierra Leone, Singapor, Sllovaki, Slloveni, Koreja e Jugut, Sudani i Jugut, Swaziland, Shqipëri, Gambia, Timor-Leste, Trinidad dhe Tobago, Turkmenistan, Emiratet e Bashkuara Arabe, Uzbekistan, Zambia, Zimbabve.





# Pjesa e dytë

Rishikimi i Masave për  
të Zbutur Rreziqet  
e Financimit të  
Terrorizmit në sektorin e  
OJF-ve në Shqipëri

Raporti i Rrezikut të  
Mbetur

## Shkurtime

AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
BSH	Banka e Shqipërisë
DPPPP	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
FATF	Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar
FT	Financimi i Terrorizmit
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH
MF	Ministria e Financave
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MONEYVAL	Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
OJF	Organizata jofitimprurëse
PPP/LFT	Parandalimi i Pastrimit të Parave / Lufta kundër Financimit të Terrorizmit
PP	Pastrimi i Parave
PSH	Policia e Shtetit
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
RVN	Raporti i Vlerësimit të Ndërsjelltë
VKRR	Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut

# A. HYRJE

## Konteksti për Rishikimin

1. Fushata e vazhdueshme ndërkombëtare kundër financimit të terrorizmit ka identifikuar tipologji në mbarë botën ku terroristët dhe organizatat terroriste shfrytëzojnë sektorin e organizatave jofitimprurëse (OJF) nëpërmjet: mbledhjes, konsolidimit/grumbullimit, transferimit, shpërndarjes dhe përdorimit të fondeve të mbledhura (ajo që njihet edhe si cikli i financimit); ofrimit të mbështetjes logjistike; nxitjes së rekrutimit të terroristëve; mbështetjes së organizatave dhe veprimeve terroriste; krijimit të fushatave mashtruese bamirësie; ose përfshirjes në skema mashtruese të gjenerimit të të ardhurave për qëllime të tilla.
2. Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF) është organi ndërkombëtar i përcaktimit të standardeve në fushën e Parandalimit të Pastrimit të Parave/Luftës kundër Financimit të Terrorizmit (PPP/LFT). Dy pjesë të standardeve të FATF-së i referohen drejtpërdrejt OJF-ve - Rekomandimi 8 dhe Rezultati e Drejtpërdrejtë 10. Paragrafi 8.1 (c) i Metodologjisë së FATF-së thekson se vendet duhet të:

*8.1 (c) rishikojnë përshtatshmërinë e masave, përfshi ligjet dhe rregulloret, që lidhen me grupin e OJF-ve që mund të abuzohen për mbështetje të financimit të terrorizmit, me qëllim që të jenë të afta të marrin veprime proporcionale dhe efektive për të adresuar rreziqet e identifikuara.*
3. Shqipëria është anëtare e MONEYVAL (Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit) organi rajonal i FATF-së për Evropën. Në raportin e tij të 5-të të Vlerësimi të Ndërsjellë, 2018, Shqipëria u vlerësua si **Pjesërisht në Përputhje** në lidhje me Rekomandimin 8, bazuar në mangësitë e mëposhtme: analiza mbi sektorin e OJF-ve nuk ka identifikuar ato OJF në rrezik ndaj abuzimit të financimit të terrorizmit (FT) dhe natyrën e kërcënimeve të paraqitura; nuk është ndërmarrë asnjë rishikim i kuadrit ligjor dhe masave nga këndvështrimi i FT-së; Shqipëria nuk ka politika të qarta, për të promovuar përgjegjshmërinë, integritetin dhe besimin e publikut në administrimin dhe menaxhimin e OJF-ve; Shqipëria ka një kontaktim (outreach) të kufizuar në sektorin e OJF-ve dhe komunitetin e donatorëve në lidhje me çështjet e FT-së; Shqipëria nuk ka asnjë dokument të praktikave më të mira të hartuar me përfshirjen e OJF-ve; Shqipëria nuk ka ndërmarrë hapa për të promovuar mbikëqyrjen ose monitorimin sipas një qasjeje të bazuar në rrezik ndaj OJF-ve; kompetencat mbikëqyrëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) janë të kufizuara dhe nuk mbulojnë gjerësisht aspektet e LFT-së.
4. Në dhjetor 2019, MONEYVAL publikoi Raportin e Parë Përcjellës të Përmirësuar<sup>1</sup>, në të cilin **Rekomandimi 8** u rivlerësua si **Gjerësisht në Përputhje**. Rivlerësimi u bazua në arritjet e mëposhtme: kryerja e një raundi të dytë të rishikimit të Vlerësimi Kombëtar të Rrezikut (VKR) të PP-së dhe FT-së, i cili përfshiu një vlerësim të përgjithshëm të rrezikut rreth cënueshmërisë dhe kërcënimeve të OJF-ve; miratimi i udhëzimeve të reja "Për Mbikëqyrjen e Organizatave Jofitimprurëse në funksion të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit" (Udhëzimet) duke përmirësuar bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP<sup>2</sup>) dhe DPT-së në lidhje mbi mbikëqyrjen e OJF-ve, të cilat parashikojnë publikimin e një raporti vjetor për çështjet e identifikuara në lidhje me OJF-të e mbikëqyrura dhe rivlerësimin periodik të sektorit të OJF-ve. Udhëzimet parashikojnë gjithashtu masa për mbikëqyrjen dhe monitorimin e OJF-ve nga DPT-ja duke zbatuar qasjen e bazuar në rrezik; prezantimi i disa masave të rëndësishme për të promovuar përgjegjshmërinë, integritetin dhe besimin e publikut në administrimin dhe menaxhimin e OJF-ve, nëpërmjet ndryshimeve në Ligjin për Procedurat Tatimore dhe nëpërmjet Udhëzimit "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë". Këto masa përfshijnë detyrimin që OJF-të të kenë një llogari bankare dhe ta deklarojnë atë në administratën tatimore. Kjo kërkesë e re inkurajon OJF-të të kryejnë transaksione nëpërmjet kanaleve financiare të rregulluara. Ndryshimet në Ligjin për Procedurën Tatimore gjithashtu vendosën sanksione për mospërbushjen e detyrimeve lidhur me regjistrimin apo përditësimin e të dhënave;

<sup>1</sup> MONEYVAL, 2019, "Masat Kundër Pastrimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Raporti Pasues" [Online] <https://rm.coe.int/committee-of-experts-on-the-evaluation-of-anti-moneylaundering-measur/16808ff13>

<sup>2</sup> Njësia Financiare e Inteligjencës është Drejtorja e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave

5. Në lidhje me kontaktimin (outreach) e OJF-ve rreth cënueshmërive potenciale të OJF-ve lidhur me çështjet e FT-së, ky raport thekson se **Shqipëria ka ende nevojë të hartojë dokumentin përkatës të praktikave më të mira me përfshirjen e sektorit të OJF-ve.**
6. Kjo metodologji e vlerësimit të rrezikut të OJF-ve u zbatua në kuadrin e një Marrëveshjeje Mirëkuptimi ndërmjet Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ). Ajo u finalizua me mbështetjen e Greenacre Associates përmes financimit të GIZ. Metodologjia është në përputhje me angazhimin e Qeverisë së Shqipërisë si anëtare e Rrjetit Global të Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar<sup>3</sup> për të luftuar financimin e terrorizmit.

Vlerësimi i rrezikut identifikoi 3 (tre) kategoritë e mëposhtme të OJF-ve që bëjnë pjesë në përkufizimin e FATF-së për OJF-të.

	Lloji	Ligji përkatës	FATF ekskluzivisht për OJF-të
1	OJF-të (përfshirë shoqatat, fondacionet, qendrat, degët e OJF-ve të huaja e ndërkombëtare) të regjistruara në Shqipëri. <sup>4</sup>	Ligji Nr.8788, datë 7.5.2001 për OJF-të	Në masë të gjerë
2	Pesë bashkësitë fetare të themeluara si subjekte juridikë përmes marrëveshjeve me Qeverinë (të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë).	Marrëveshjet, ligje dhe marrëveshje të tjera përkatëse të ratifikuara me ligj	Po
3	Kryqi i Kuq Shqiptar	Ligji për Kryqin e Kuq Shqiptar	Po

7. Qëllimi i këtij raporti është të “rishikojë përshtatshmërinë e masave, përfshi ligjet dhe rregulloret, që lidhen me grupin e OJF-ve që mund të abuzohen për mbështetje të financimit të terrorizmit, me qëllim që të jenë të afta të marrin veprime proporcionale dhe efektive për të adresuar rreziqet e identifikuar” siç kërkohet nga R.8 (c) i Metodologjisë së FATF-së.
8. “Kategoritë e sektorit të OJF-ve që mund të abuzohen për mbështetje të FT-së” u identifikuan në Vlerësimin e Rrezikut për Financimin e Terrorizmit për sektorin e OJF-ve në Shqipëri, në përputhje me “identifikimin e tipareve dhe llojeve të OJF-ve të cilat për shkak të aktiviteteve ose karakteristikave të tyre, kanë të ngjarë të jenë në rrezik të abuzimit me financimin e terrorizmit (Metodologjia e FATF-së 8.1 (i)). Bazuar në Raportin e Rrezikut të Qenësishëm, pesë veçori, karakteristika, apo aktivitete të OJF-ve u analizuan për të vlerësuar nëse ato mund të vendosnin OJF-të “në rrezik” të FT-së. Analiza identifikoi se tre nga këta faktorë rreziku mund të shoqërohen me rrezik të rritur të FT-së për OJF-të, bazuar në rastet nën hetim, intervistat me autoritetet publike dhe institucionet financiare, dhe vlerësimin cilësor nga ekspertët. Dy fusha u identifikuan, për të cilat ka nevojë për më shumë kërkim.

<sup>3</sup> Shqipëria është anëtare e MONEYVAL, Struktura përgjegjëse për Evropën

<sup>4</sup> OJF-të që nuk bëjnë pjesë në përjashtimet në vijim: a) Grupe joformale njerëzish që nuk plotësojnë përkufizimin e rregullimit ligjor; b) Personat juridikë ose angazhime apo organizata që nuk janë krijuar për “vepra të mira”, të tilla si partitë politike, sindikatat ose kooperativat të cilat janë të angazhuara kryesisht në aktivitete ekonomike për përfitimin financiar të anëtarëve; c) Personat juridikë ose angazhimet apo organizatat që nuk merren me mbledhjen ose dhënien e fondeve si qëllim kryesor. Kjo mund të përfshijë ato klube sportive, shoqata sociale ose grupe fetare që nuk ose angazhohen rastësisht në ngritjen apo disbursimin e fondeve.

**OJF-të dhe aktivitetet e OJF-ve që mund të jenë më në rrezik të abuzimit për TF:**

1. Organizata me veprimtari humanitare dhe bamirëse
2. Veprimtari bamirëse dhe/ose edukative e OJF-ve fetare
3. Shuma të mëdha financimi të huaja nga burime me rrezik të lartë

**OJF-të dhe aktivitetet e OJF-ve për të cilat ka nevojë për më shumë kërkim:**

4. Përdorimi i parasë fizike (cash) apo transaksioneve alternative jashtë sistemit formal bankar
5. Aktivitete në zona të thella

**9. Vlerësimi i rrezikut identifikoi edhe natyrën e kërcënimit të FT-së për OJF-të në Shqipëri, si më poshtë:**

**Kërcënimi i mundshëm i FT-së për OJF-të në Shqipëri:**

1. Grupet ekstremiste fetare (të huaja)

**Si mund terroristët të abuzojnë me OJF-të:**

1. Financimi i huaj për simpatizantët vendas të lidhur me OJF-të
2. Përdorimi i OJF-ve për të përhapur propagandën ekstremiste
3. Përdorimi i OJF-ve për të rekrutuar luftëtarë të huaj terroristë

**10.** Si përfundim, vlerësimi i rrezikut të qenësishëm në përgjithësi, vuri në pah se nuk ka prova direkte përfundimtare të abuzimit të OJF-ve për financimin e terrorizmit në Shqipëri, por ai nje prezencën e një kërcënimi terrorist dhe potencialin që ky kërcënim të ndikojë mbi OJF-të.

**11.** Në këtë kontekst, **rreziku i përgjithshëm i qenësishëm për abuzimin e OJF-ve për financimin e terrorizmit në Shqipëri u vlerësua I ULËT.** Për shumicën e OJF-ve rreziku është **SHUMË I ULËT**, ndërsa për organizatat me veprimtari humanitare dhe bamirëse dhe organizatat fetare që ushtrojnë veprimtari bamirësie dhe/ose edukuese rreziku është **I ULËT-I MESËM.**

# B. METODOLOGJIA

12. Standardet e FATF-së “nuk përshkruajnë një metodë specifike apo format të caktuar për vlerësimin e rrezikut” të financimit të terrorizmit për OJF-të<sup>5</sup>. Praktikën më të mira për vlerësimet e rrezikut dhe rishikimet për sektorin e OJF-ve janë të përfshira në Udhëzuesin e FATF-së për Vlerësimin e Rrezikut të Financimit të Terrorizmit (FATF, 2019). Përveç saj, Udhëzuesi i FATF-së: Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut ndaj Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (FATF, 2013) ofron udhëzime mbi vlerësimet e rrezikut dhe rishikimet në përgjithësi.
13. Bazuar në udhëzuesit e FATF-së dhe qasjen e ndjekur nga disa vende<sup>6</sup>, dy përjasje metodologjike u konsideruan për këtë rishikim:
- I. **Modeli i Analizës së Rastit:** Vlerësimi i efektivitetit të vetëm atyre masave zbutëse që lidhen me faktorët e identifikuar të rrezikut.
  - II. **Analiza e Mangësive:** Vlerësimi i të gjitha masave zbutëse për të identifikuar çdo cënueshmëri të mundshme (kundrejt cënueshmërive të një rreziku specifik të identifikuar).
14. Kjo metodologji përshtat përjasjen e “analizës së rastit”, me efektivitetin e masave zbutëse dhe vlerësimin e rrezikut të mbetur të fokusuar në aktivitetet dhe tipet e OJF-ve të identifikuara si “në rrezik” në vlerësimin e rrezikut të qenësishëm, në përputhje me 8.1 (c) të metodologjisë së FATF-së.
15. Ky është një rishikim i fokusuar tek OJF-të. Ai nuk synon të zëvendësojë Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut, Raportin e Vlerësimit të Ndërsjellët (RVN), apo rishikime të tjera të masave PPP/LFT, të cilat rastësisht, dhe jo specifikisht, adresojnë OJF-të. Kështu, ky rishikim shqyrton masat thelbësore specifike që duhet të merren në sektorin e OJF-ve lidhur me LFT-në me qëllim korrigjimet efektive që lidhen me to.
16. Ky rishikim është i bazuar sa më shumë në kërkesat dhe udhëzuesit e FATF-së. Kërkesat dhe udhëzuesit përkatës të FATF-së janë theksuar përkatësisht në tekst. Kur nuk ka udhëzues përkatës të FATF-së për një çështje, vlerësimet janë bërë bazuar në ekspertizën dhe eksperiencën e ekspertëve.
17. Rishikimi mbulon tre fusha: (1) ligjet dhe rregulloret; (2) masat e politikës dhe kontaktimin (outreach); dhe (3) masat vetërregulluese dhe vetëqeverisëse.
18. Kriteret e përdorura në rishikim janë marrë nga R8 dhe dokumenta të tjerë të FATF-së. Supozimet fillestare janë që masat janë ‘efektive’, ‘të bazuara në rrezik’ dhe ‘jo-penguese’:
1. **‘Efektive’.** Rezultatet e Drejtpërdrejta janë një vlerësim i “efektivitetit” të masave PPP/LFT. Shënimi Shpjegues 8 u kërkon vendeve të përshtasin “masa efektive” në luftën ndaj financimit të terrorizmit<sup>7</sup>. Masat efektive kanë burime të përshtatshme<sup>8</sup>.
  2. **‘Të bazuara në rrezik dhe të targetuara’.** FATF-ja thekson se një “Qasje e bazuar në rrezik” është parimi thelbësor për të gjitha vlerësimet e FATF-së<sup>9</sup>. Shënimi Shpjegues (INR8) “kërkon” që vendet të miratojnë “masa proporcionale”<sup>10</sup> dhe shton se “një qasje e bazuar në rrezik që zbaton masa të fokusuara në trajtimin e kërcënimeve të identifikuara të abuzimit të financimit të terrorizmit ndaj OJF-ve është thelbësore”<sup>11</sup>.

<sup>5</sup> Udhëzuesi i Vlerësimit të Rrezikut të Financimit të Terrorizmit (FATF, 2019).

<sup>6</sup> Shembuj nga UK, Kanadaja, Australia, Arabia Saudite, Indonezia dhe Filipinet.

<sup>7</sup> 4(c), Shënimi Shpjegues R8.

<sup>8</sup> “Vendet duhet t’i pajisin autoritetet e tyre, që janë përgjegjëse për supervizionin, monitorimin dhe hetimin e sektorit të tyre të OJF-ve, me burime të përshtatshme financiare, njerëzore dhe teknike.

<sup>9</sup> Shiko Rekomandimi 1 i FATF-së.

<sup>10</sup> 4(c), Shënimi Shpjegues R8.

<sup>11</sup> 4(a), Shënimi Shpjegues R8.

Ky parim ripërsëritet si në terma të përgjithshëm ashtu edhe në lidhje me aktivitete specifike përmes dokumentacionit të FATF-së<sup>12</sup>.

3. ‘**Jo-penguese**’. Sigurimi që masat nuk pengojnë veprimtarinë legjitime të OJF-ve<sup>13</sup>; që ato përshtaten me rrethanat lokale<sup>14</sup>; se ato janë në përputhje me detyrimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut<sup>15</sup>.

19. Rishikimi përfshin një vlerësim të ‘Rrezikut të mbetur’ në Përmbledhjen Ekzekutive. Rreziku i mbetur llogaritet si më poshtë:

Rreziku i Qenësishëm<sup>16</sup> – Ndikimi i Masave Zbutëse = Rreziku i Mbetur.

20. Ky rishikim, duke përfshirë vlerësimin e Rrezikut të Mbetur, kombinon vlerësimin sasior dhe cilësor të të dhënave dhe burimeve. Natyra e burimeve, natyra e procesit të shqyrtimit dhe mungesa e provave të drejtpërdrejta të abuzimit të financimit të terrorizmit të OJF-ve në Shqipëri garantojnë që vlerësimi të jetë kryesisht cilësor.

21. Vlerësimi i rrezikut u përfundua duke përdorur Metodologjinë e ofruar nga Greenacre Associates. Ai u zbatua nga një Ekip Lokal Vlerësimi. Partnerët Shqipëri udhëhoqi procesin e mbledhjes dhe analizës së të dhënave me ekspertizën e një eksperti vendas dhe asistencën teknike të Greenacre Associates.

22. Vlerësimi u mbikëqyr nga Grupi Mbikëqyrës i Metodologjisë së Vlerësimit të Rrezikut të OJF-ve, i përbërë nga përfaqësues të institucioneve dhe organizatave të mëposhtme:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)
2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)
3. Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë (KNFSh)
4. Prokuroria e Përgjithshme (PP)
5. Policia e Shtetit Shqiptar
6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Zyra përgjegjëse për regjistrin e OJF-ve)
7. Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri (CVE)
8. Komiteti Shtetëror për Kultet
9. Komuniteti Mysliman Shqiptar
10. Dorcas Aid International Albania
11. Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS
12. Qendra “Hapa të Lehta”
13. Qendra “Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim” (SCiDEV)

23. Vlerësimi i efektivitetit të masave zbutëse u përfundua gjatë 1 (një) seminari ditor të mbajtur në Shqipëri, më 16 qershor 2022. Në seminar morën pjesë 10 përfaqësues të autoriteteve publike dhe organizatave jofitimprurëse të mëposhtme, anëtarë të Grupit Mbikëqyrës të Metodologjisë së Vlerësimit të Rrezikut të OJF-ve:

<sup>12</sup> Shiko edhe paragrafët 19, 21, 23, 24, 29, 32 dhe 35 të Dokumentit të Praktikave më të Mira të FATF-së.

<sup>13</sup> “Deri në çfarë mase, pa cënuar aktivitetin legjitim të OJF-ve, vendi ka zbatuar një qasje të targetuar, ka kryer kontaktim (outreach) dhe ka ushtruar mbikëqyrje në trajtimin e OJF-ve që janë në rrezik nga kërcënimi i abuzimit terrorist?” Rezultati i Drejtpërdrejtë 10, 10.2 (shih Shtojcën 1). Shih gjithashtu INR8 paragrafët 4(a), 4(d) dhe 4(e) dhe Dokumentin e Praktikave më të Mira paragrafin 32(a).

<sup>14</sup> Dokumenti i praktikave më të mira thekson në mënyrë të përsëritur se nuk ka qasje “një madhësi që i përshtatet të gjithëve” ndaj masave të TF-së në sektorin e OJF-ve. Paragrafi 23(c) thotë se një qasje “një madhësi u përshtatet të gjithëve” nuk është një mënyrë efektive për të luftuar abuzimin terrorist të OJF-ve dhe ka më shumë gjasa të prishë ose dekurajojë aktivitetet e ligjshme bamirëse”, dhe kjo shprehje përsëritet në paragrafët 7(b), 18, 29, 32 (a) dhe 32 (e).

<sup>15</sup> Zbatimi i R8 duhet të jetë “në përputhje me detyrimet e vendeve për të respektuar lirinë e mbledhjes, tubimit, shprehjes, fesë ose besimit, dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare”.<sup>6</sup>, Dokument i Praktikave më të mira. Shih gjithashtu po aty 22 dhe Tipologjitë 28.

<sup>16</sup> Minus

1. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)
2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)
3. Prokuroria e Përgjithshme (PP)
4. Policia e Shtetit Shqiptar
5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Zyra përgjegjëse për regjistrin e OJF-ve)
6. Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri (CVE)
7. Komiteti Shtetëror për Kultet
8. Dorcas Aid International Albania
9. Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS
10. Qendra "Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim" (SCiDEV)

## Të dhënat dhe burimet

24. Në këtë rishikim janë përdorur informacione parësore dhe burimet e të dhënave të përmendura në seksionet vijuese të këtij raporti.

25. Të dhëna nga autoritetet kompetente.

- **Kërkesa për të dhëna dhe pyetësi.** Kërkesat me shkrim mbi të dhëna për financimin e terrorizmit në sektorin e OJF-ve, rastet studimore dhe anketimi i perceptimeve mbi rrezikun e FT-së, kërcënimeve dhe cënueshmërive të FT-së u siguruan nga përfaqësues të agjencive të mëposhtme:
  1. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)
  2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)
  3. Prokuroria e Përgjithshme (PP)
  4. Policia e Shtetit Shqiptar
  5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Zyra përgjegjëse për regjistrin e OJF-ve)
  6. Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri (CVE)
  7. Komiteti Shtetëror për Kultet
  8. Banka e Shqipërisë
  9. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)

26. Perceptimet nga Institucionet Financiare.

- **Pyetësi.** Anketimi i perceptimeve për rreziqet, kërcënimet dhe cënueshmëritë e FT-së për OJF-të janë marrë nga përfaqësues të Institucioneve Financiare (7 institucione bankare dhe 8 institucione jo bankare):
  1. Alpha Bank
  2. BKT
  3. Banka Credins
  4. Fibank
  5. Banka OTP
  6. Tirana Bank




7. Union Bank
8. EasyPay
9. AK Invest
10. Crimson Finance Fund Albania
11. Final
12. Fondi Besa
13. Kastrati
14. Micro Credit Albania
15. Raiffeisen Leasing Albania

**27.** Intervista me komunitetet fetare: Intervistë ballë për ballë me Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare.

**28.** Anketimi me OJF-të.

- Një anketim me 153 OJF, nga 2,372 OJF aktive të regjistruara në DPT u krye mbi perceptimin e rrezikut të FT-së dhe efektivitetin e masave zbutëse. Kampioni u zgjodh rastësisht nga lista e OJF-ve aktive të ofruara nga DPT-ja dhe kontaktet u nxorrën nga databaza e OJF-ve së Partnerëve Shqipëri. Pjesëmarrja në anketim u bazua në gatishmërinë e OJF-ve për të marrë pjesë në të. Anketimi u krye gjatë periudhës korrik – gusht 2021, nëpërmjet telefonit. Niveli i besimit është 80% dhe vlera reale është brenda  $\pm 5\%$  të vlerës së matur/ anketuar. Sipas formës ligjore, 48% e OJF-ve të anketuara janë shoqata, ndjekur nga qendrat (41%) dhe fondacione (11%).

**Figura 1: OJF-të sipas formës ligjore (Burimi: Anketimi me OJF-të, nr. = 153 OJF)**



**29.** Rishikimi ligjor.

Rishikimi ligjor konsistoi në ligjet dhe rregulloret e mëposhtme, duke përfshirë amendimet, rregulloret zbatuese dhe njoftimet. Rishikimi u plotësua nga intervistat me zyrtarët përgjegjës për zbatimin e tyre:

- Ligji nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil”, i ndryshuar (“KC”);
- Ligji nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar (“Ligji për PPP”);
- Ligji nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar (“Ligji i OJF-ve”);
- Ligji nr.8789, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”; dhe Ligji nr.80/2021 datë 02.08.2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”;

- Ligji nr.119/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”;
- Ligji nr.112/2020 “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues”;
- Ligji nr.154, datë 17.12.2020 “Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare”;
- Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Ligjin e Procedurave Tatimore”, i ndryshuar;
- Ligji nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor”, i ndryshuar;
- Ligji nr.8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9640, datë 9.11.2006 “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimin”,
- Ligji nr.10140, date 15.05.2009 “Për financimin nga buxheti i shtetit i komuniteteve fetare që kanë marrëveshje me Këshillin e Ministrave”;
- Ligji nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”
- Ligji nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar (“KPP”);
- Ligji nr.8391, datë 28.10.1998 “Për shërbimin inteligjent shtetëror”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit për auditimin ligjor and për kontabilistëve të certifikuar”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.663, datë 17.07.2013 “Për aprovimin e Strategjisë Ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikimit ilegal dhe terrorizmit 2013-2020 dhe Planit të Veprimit për vitet 2013-2016”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1137 datë 16.12.2020 Për aprovimin e Strategjisë Ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit 2021 – 2025, dhe planit të veprimit 2021-2023”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave 16/2009;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë 19/2019;
- Vendimi nr.44/2009 i Bankës së Shqipërisë;
- Regullorja e AMF-së nr.58, datë 30.06.2015 “Për masat e vigjilencës dhe përfshirja e subjekteve të ligjit mbi parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit<sup>17</sup> dhe “Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, publikuar nga AMF-ja;
- Vendimi nr.1, datë 19.02.2020 për krijimin e grupit ndërinstitucional i Komitetit për Koordinimin e Luftës kundër Pastrimit të Parave për ndjekjen dhe përmbushjen e rekomandimeve të FATF-së dhe ICRG-së;
- Dispozita të tjera ligjore përkatëse.

### 30. Raportet e mëposhtme për PPP/LFT për Shqipërinë u morrën në konsideratë:

- Raporti i Vlerësimit të ndërsjellë të MONEYVAL për Shqipërinë 2018.
- Raporti i parë Përcjellës i Përmirësuar i MONEYVAL, dhjetor 2019 Raporti i 2-të Përcjellës, i Përmirësuar, prill 2021<sup>18</sup>.
- Raporti i Vlerësimit për Kuadrin Ligjor dhe Rregullator mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftën kundër Financimit të Terrorizmit për Organizatat Jofitimpurëse në Shqipëri<sup>19</sup>.

<sup>17</sup> Ndryshuar me Vendimin e Bordit të AML-së nr.97, datë 29.07.2020 dhe Vendimi i Bordit nr.199, datë 29.12.2020

<sup>18</sup> Të gjitha raportet janë publikuar në faqen e internetit të Këshillit të Evropës

<sup>19</sup> <https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2021/07/Assessment-Report-on-Legal-and-Regulatory-Framework-on-Anti-Money-Laundering-for-NPOs.pdf>

- Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë 2020.
- Raporti Vjetor i AMF-së 2020<sup>20</sup>.
- Raporti Vjetor për Terrorizmin në Botë nga Departamenti Amerikan i Shtetit 2020.
- Raporti i Progresit i Bashkimit Evropian - 2021.

31. Informacioni dhe të dhënat dytësore të mëposhtme u përdorën për hartimin e këtij raporti. Informacioni dhe të dhënat dytësore nuk patën të njëjtën peshë si të dhënat parësore. Ato u përdorën jo vetëm për të ushqyer qasjen metodologjike, por edhe për të plotësuar me informacion vlerësimin për ato çështje ku të dhënat parësore nuk ishin të disponueshme:

- Shënimi Shpjegues për Rekomandimin 8 (shih Standardet Ndërkombëtare për Luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe Përhapjes – Rekomandimet e FATF-(2012, përditësuar 2016).
- Metodologjia për Vlerësimin e Përputhshmërisë Teknike të FATF-së.
- Rekomandimet e FATF dhe Efektivitetin e Sistemeve PPP/LFT (FATF, 2013).
- Praktikat më të mira ndërkombëtare: Lufta kundër Abuzimit të Organizatave Jofitimprurëse (FATF, 2015).
- Rreziku i Abuzimit Terrorist në Organizatat Jofitimprurëse (FATF, 2014).
- Udhëzimi për Vlerësimin e Rrezikut të Financimit të Terrorizmit (FATF, 2019).

<sup>20</sup> [https://amf.gov.al/pdf/publikime2/raport/RAPORTI\\_VJETOR\\_SHQIP\\_final.pdf](https://amf.gov.al/pdf/publikime2/raport/RAPORTI_VJETOR_SHQIP_final.pdf).

# C. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE DHE VLERËSIMI I RREZIKUT TË MBETUR

32. Nga vlerësimi i Rrezikut të Qenësishëm rezultoi se nuk ka prova përfundimtare të abuzimit të OJF-ve për qëllime të financimit të terrorizmit në Shqipëri, megjithëse janë katër hetime në proces. Perceptimi i rrezikut ndryshon, por vlen të theksohet se autoritetet që kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për luftimin e financimit të terrorizmit, në mënyrë të vazhdueshme e vlerësojnë rrezikun si më të ulët se të anketuarit e tjerë. Ndërkohë që vlerësimi i përgjithshëm i nivelit të rrezikut nuk është i qartë, ka një konsistencë më të lartë sa i përket faktorëve specifikë të rrezikut. Nga ky këndvështrim, rreziku i përgjithshëm i abuzimit të OJF-ve për qëllime të financimit të terrorizmit në Shqipëri vlerësohet **I ULËT**. Për shumicën e OJF-ve rreziku është **SHUMË I ULËT**. Megjithatë, u identifikuan pesë veçori, karakteristika ose aktivitete të OJF-ve që mund të shoqërohen me ekspozim më të madh ndaj rrezikut të abuzimit për qëllime të FT-së.
33. Ky raport vlerëson masat zbutëse në lidhje me pesë (5) kategoritë e mëposhtme të rrezikut të identifikuara në *Vlerësimin e Rrezikut*.
- Organizatat me veprimtari humanitare dhe bamirëse
  - Veprimtaria bamirëse dhe/ose edukative e OJF-ve fetare
  - Shuma të mëdha të financimeve të huaja nga burime me rrezik të lartë
  - Përdorimi i parave fizike (cash) ose transaksioneve alternative jashtë sistemit zyrtar bankar
  - Aktivitete në zona të thella.
34. Ky raport vlerëson efektivitetin e masave zbutëse për të ulur potencialisht nivelin e rrezikut të qenësishëm për secilin nga pesë faktorët e rrezikut dhe ofron disa rekomandime për të minimizuar rrezikun e mbetur.

## Gjetjet kryesore nga raporti:

35. Në përgjithësi, kuadri ligjor dhe rregullator për OJF-të në Shqipëri, konsiderohet si efektiv për të zbutur rrezikun e FT-së në këtë sektor. Ai nuk paraqet ndonjë problematikë madhore, megjithatë ka disa çështje që duhen trajtuar nga autoritetet për të siguruar që OJF-të të mos keqpërdoren për qëllime të FT-së dhe që masat të jenë të bazuara në rrezik, proporcionale dhe të mos dëmtojnë aktivitetin legjitim të OJF-ve.
36. Nuk ka një mekanizëm sistematik për të garantuar mbikëqyrje ose monitorim të targetuar dhe të bazuar në rrezik të OJF-ve për abuzim me financimin e terrorizmit, në përputhje me pikat 8.3 dhe 8.4 të Metodologjisë së FATF-së. Si rezultat, pavarësisht mungesës së rasteve dhe provave, si dhe pranimit të përgjithshëm nga autoritetet përkatëse shtetërore se ekziston një nivel i ulët rreziku që OJF-të të abuzohen për qëllime të FT-së, kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi i konsideron të gjitha OJF-të si “me rrezik të lartë” për qëllime të FT-së.
37. Masat për marrjen dhe shkëmbimin e informacionit, hetimeve dhe inteligjencës janë të duhura. Megjithatë, autoritetet përgjegjëse për regjistrimin dhe mbikëqyrjen e OJF-ve (autoritetet tatimore dhe Regjistri i OJF-ve) kanë burime njerëzore të kufizuara, jo të specializuara dhe jo të dedikuara vetëm për OJF-të.

38. Për shkak të disa mangësive në kuadrin ligjor dhe rregullator, masat zbutëse të ndërmarra nga qeveria nuk depërtojnë në disa kategori të OJF-ve, karakteristikat dhe aktivitetet e të cilave i ekspozojnë ato ndaj një rreziku më të lartë të FT-së sesa kategoritë e tjera të OJF-ve, për shembull OJF-të fetare që janë krijuar jashtë kontrollit të komuniteteve fetare që kanë një marrëveshje me Qeverinë Shqiptare, apo OJF-të në zonat rurale.
39. Mungon kontaktimi (outreach) i OJF-ve nga autoritetet shtetërore në lidhje me dobësitë e mundshme të OJF-ve ndaj abuzimit për qëllime të financimit të terrorizmit dhe rreziqeve të financimit të terrorizmit, si dhe masat që vetë OJF-të mund të marrin për t'u mbrojtur nga ky abuzim. Prandaj, ekziston një nivel i ulët informimi dhe ndërgjegjësimi i OJF-ve mbi rrezikun e mundshëm të FT-së për OJF-të, mbi legjislacionin, politikat dhe masat për të zbutur rrezikun e FT-së në sektorin e OJF-ve, rregulloret për financimin e terrorizmit për bankat ose institucionet financiare që ndikojnë tek OJF-të, etj.
40. Ka një ndërgjegjësim dhe angazhim të shtuar të OJF-ve për të rritur efikasitetin, transparencën dhe llogaridhënien e tyre. Anëtarësimi i OJF-ve të angazhuara drejt zhvillimit dhe ruajtjes së standardeve të larta në Kodin e Standardeve, i prezantuar nga Partnerët Shqipëri si një mekanizëm vetërregullues që promovon kulturën e integritetit dhe standardeve të larta brenda sektorit të OJF-ve, po rritet. Megjithatë, OJF-të duhet ende të rrisin kapacitetet e tyre për të zbatuar më mirë rregullat dhe detyrimet ligjore, për të kryer vigjilencën e duhur të donatorëve, partnerëve dhe përfituesve të tyre për të shmangur keqpërdorimin për qëllime të FT-së.
41. Tabela e mëposhtme përmbledh gjetjet kryesore të këtij vlerësimi:

Seksioni	Kategoria e Rrezikut	Përshtatshmëria e Masave Zbutëse
E	Organizatat me veprimtari humanitare dhe bamirëse	Mesatare
F	Veprimtaria bamirëse dhe/ose edukative e OJF-ve fetare	E ulët
G	Shuma të mëdha të financimeve të huaja nga burime me rrezik të lartë	E ulët
H	Përdorimi i parave fizike (cash) ose transaksioneve alternative jashtë sistemit zyrtar bankar	E ulët deri në mesatare
I	Aktivitete në zona të largëta	E ulët deri në mesatare

42. Masat zbutëse efektive reduktojnë rrezikun e qenësishëm për të prodhuar një rrezik të përgjithshëm të mbetur:

(Rreziku i Qenësishëm – Ndikimi i Masave Zbutëse) = Rreziku i Mbetur.

43. Ky raport vlerëson efektivitetin e masave zbutëse për çdo faktor rreziku, me masa efektive që mund të reduktojnë nivelin ose rrezikun e mbetur. Vlerësimet rezultojnë si më poshtë:

Kategoria e Rrezikut	Rreziku i Qenësishëm	Përshtatshmëria e Masave Zbutëse	Rreziku i Mbetur
Organizatat me veprimtari humanitare dhe bamirësie	I ulët deri në mesatar	Mesatare	I ulët
Veprimtari bamirëse dhe/ose edukative e OJF-ve fetare	I ulët deri në mesatar	E ulët	Mesatar

Shuma të mëdha të financimeve të huaja nga burime me rrezik të lartë	I ulët deri në mesatar	E ulët	Mesatar
Përdorimi i parave fizike (cash) ose transaksioneve alternative jashtë sistemit zyrtar bankar	I ulët deri në mesatar	E ulët deri në mesatare	I ulët deri në mesatare
Aktivitete në zona të largëta	I ulët deri në mesatar	E ulët deri në mesatare	I ulët deri në mesatar

Vlerësimi i Rrezikut të Qenësishëm vlerësoi rrezikun e qenësishëm të FT-së për OJF-të në Shqipëri si **“I ULËT”**. Për shumicën e OJF-ve rreziku është **“SHUMË I ULËT”**. Reduktimi i rrezikut në nivel **“Shumë të Ulët”** për sektorin e OJF-ve në Shqipëri do të kërkonte marrjen e masave zbutëse gjithëpërfshirëse dhe efektive. Vlerësimi i rrezikut të mbetur për financimin e terrorizmit për OJF-të është **“I ULËT”**.

## Rreziku i mbetur i FT-së për sektorin e OJF-ve në Shqipëri

### I ULËT

## Rekomandime

44. Ky raport ofron rekomandime specifike për çdo faktor rreziku të përfshirë në këtë Raport, të cilat gjenden në fund të çdo seksioni, dhe disa rekomandime të përgjithshme që përfshihen në këtë seksion, si më poshtë:
45. Kuadri ligjor dhe rregullator, konkretisht Ligji nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, dispozitat e rregulloreve të BSH-së dhe ato të legjislacionit lidhur me AMF-në që klasifikojnë të gjitha OJF-të si “klient me rrezik të lartë” ndaj të cilave duhet kryer vigjilencën e duhur, duhet të ndryshohen për të pasqyruar kategorizimin e sektorit sipas vlerësimeve të rrezikut të sektorit të OJF-ve, në përputhje me metodologjinë e FATF-së.
46. Kategorizimi i OJF-ve në regjistrin online të OJF-ve sipas fushës kryesore të veprimtarisë së tyre duhet të konsiderohet si prioritet nga autoritetet përkatëse përgjegjëse gjatë përgatitjes së modeleve të regjistrimit, si pjesë e punës për hartimin e regjistrin online të OJF-ve. Ky kategorizim nevojitet për të mundësuar zbatimin e qasjes së bazuar në rrezikun e FT-së ndaj OJF-ve.
47. Duhet të krijohet një strukturë e përbashkët ndërsektoriale për të identifikuar dhe diskutuar çështjet që lidhen me rreziqet e FT-së në sektorin e OJF-ve dhe politikat e lidhura me FT-në që prekin OJF-të. Struktura duhet të përfshijë përfaqësues nga strukturat shtetërore mbikëqyrëse dhe rregullatore të OJF-ve, intelijenca, agjencitë e zbatimit të ligjit, OJF-të, sektori financiar dhe komuniteti i donatorëve.
48. Autoritetet (DPPPP-ja, DPT-ja, Regjistri i OJF-ve në Gjykatë) duhet të zgjerojnë ndjeshëm programet e tyre të informimit për çështjet që lidhen me FT-në. Këto programe duhet të përfshijnë trajnimin e OJF-ve lidhur me praktikën më të mirë, duke përfshirë mënyrën si ato mund të identifikojnë rreziqet e mundshme të FT-së dhe si të identifikojnë nivelin e rrezikut të FT-së për OJF-të e tyre; udhëzuesit e synuar dhe trajnime për OJF-të me rrezik më të lartë, duke përfshirë shpjegime të hollësishme mbi detyrimet e tyre ligjore, menaxhimin e rrezikut dhe vigjilencën e duhur. Ato duhet të përfshijnë gjithashtu prezantimin e raporteve të vlerësimit të rrezikut tek institucionet e tjera, OJF-të, sektori privat, komuniteti i donatorëve dhe publiku.
49. Duhet vlerësuar kapacitetet e autoriteteve publike me detyra funksionale në lidhje me sektorin e OJF-ve për të identifikuar nëse kanë burimet e nevojshme për të zbatuar legjislacionin përkatës dhe informuar publikun, pasuar nga masat konkrete për të adresuar mangësitë e identifikuar. Disa nga mangësitë janë identifikuar tashmë në këtë raport dhe mund të shërbejnë si bazë për vlerësimin.

50. OJF-të duhet të rrisin kapacitetet e tyre për të respektuar më shumë kërkesat ligjore dhe raportimin, për të shmangur kryerjen e kontrolleve abuzive për qëllime të FT-së. Kodi i Standardeve, si një mekanizëm vetërregullues për sektorin, duhet të promovohet më tej në sektor dhe të njihet si një nismë e rëndësishme e sektorit për përmirësimin e qeverisjes, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së OJF-ve.
51. Vazhdimi i punës për të kuptuar më mirë rrezikun e FT-së në sektorin e OJF-ve, së bashku me më shumë kërkime mbi rreziqet e identifikuara, për të cilat ka pak informacion në dispozicion, si për shembull aktiviteti i OJF-ve në zonat rurale dhe mbledhja e fondeve në para.

# D. ANALIZA E MANGËSIVE

52. Në Shqipëri ekziston një kuadër ligjor që rregullon krijimin, regjistrimin dhe veprimtarinë e të gjitha OJF-ve. Prandaj, është bërë një vlerësim i të gjithë kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës të zbatueshëm për OJF-të, i njohur si metodologjia e 'Analizës së Mangësive' siç shpjegohet në Seksionin A, më sipër, për të vlerësuar efektivitetin e masave zbutëse për sektorin e OJF-ve në tërësi, e ndjekur nga një vlerësim i masave zbutëse për secilin nga faktorët e rrezikut të identifikuar në Raportin e Rrezikut të Qenësishëm.

## Analiza e Mangësive

	Emri i ligjit
Ligji(et) përkatëse	Ligjet kryesore përkatëse janë: Ligji për OJF-të, Ligji për Regjistrimin e OJF-ve, Legjislacioni Tatimor, Kodi Doganor, Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
Natyra e OJF-ve	"Organizata jofitimprurëse" nënkupton shoqatat, fondacionet dhe qendrat dhe degët e OJF-ve të huaja ose ndërkombëtare, të cilat kryejnë veprimtarinë e tyre (veprimtari joekonomike ose ekonomike) në mënyrë të pavarur dhe pa undikuar nga shteti shqiptar.
Numri (OJF-të / numri i përgjithshëm)	Deri në fund të vitit 2020, në Regjistrin e OJF-ve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë regjistruar 11,962 OJF. Deri në maj 2021, në DPT janë regjistruar 5,295 OJF. Prej tyre, 2,372 OJF janë me status aktiv dhe 2,923 OJF me status pasiv.
Agjencia mbikëqyrëse	Nuk ka një agjenci shtetërore që mbikëqyr specifikisht veprimtarinë e OJF-ve në Shqipëri. Ekzistojnë vetëm autoritetet publike që mbajnë Regjistrin publik të OJF-ve (informacionet për OJF-të), inspektojnë dhe kontrollojnë performancën financiare dhe fiskale të OJF-ve, dhe licensimin. Pa rënë në kundërshtim me sa më sipër, DPT-ja ka autoritetin të veprojë si organ mbikëqyrës për sektorin e OJF-ve për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe FT-së.



	Emri i ligjit
<b>Regjistrimi</b>	<p>Çdokush ka të drejtë të organizohet dhe të operojë si organizatë e paregjistruar pa pasur nevojë për krijimin dhe regjistrimin e një OJF-je.</p> <p>OJF-të (qendrat, shoqatat dhe fondacionet) fitojnë personalitetin e tyre juridik pas themelimit dhe regjistrimit në gjykatë. Degët e OJF-ve të huaja ose ndërkombëtare i nënshtrohen të njëjtave procedura regjistrimi.</p> <p>OJF-të e huaja mund të operojnë përkohësisht (jo më shumë se 6 muaj) në Shqipëri, me pëlqimin paraprak të organit shtetëror me fushë veprimtarie të njëjtë ose të ngjashme me OJF-në e huaj, pa regjistrim. Aktivitetet e përkohshme, që zgjasin jo më shumë se për 30 ditë rresht, nuk kanë nevojë për leje të përkohshme.</p>
<b>Marrja e informacionit të pritur<sup>21</sup></b>	<p>I gjithë informacioni mblidhet pas regjistrimit dhe mbahet në Regjistrin e OJF-ve dhe nga organet tatimore. Të dhënat për pronarët përfitues të OJF-ve mbahen në Regjistrin e Pronarëve Përfitues që administrohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit.<sup>22</sup> Deri më sot, emri i OJF-së, Numri i Identifikimit Tatimor (NUIS), adresa e zyrës ligjore, dhe data e themelimit, dorëzohen në Regjistrin e OJF-ve në kopje fizike; Regjistri i OJF-ve do të jetë online duke filluar nga janari 2024. Fusha e veprimtarisë, pasqyrat financiare vjetore dhe llogaritë bankare duhet të dorëzohen përkatësisht në Regjistrin e OJF-ve dhe në organet tatimore.</p>
<b>Publikimi i informacionit<sup>23</sup></b>	<p>Emri i OJF-së, forma juridike, qëllimi dhe fushëveprimi i OJF-së, kohëzgjatja (nëse ka afat të caktuar), anëtarët e organeve drejtuese, informacioni identifikues i themeluesve të OJF-së (në rastin e personave juridikë të gjitha informacionet përkatëse që identifikojnë personin juridik) dhe detajet e kontaktit elektronik të tyre, selia ligjore, data e themelimit, shuma e fondeve fillestare/të regjistruara (në rastin e fondacioneve), firma e anëtarëve të organeve drejtuese, numri i identifikimit tatimor (NUIS) dhe pasqyrat financiare vjetore do të dorëzohen në Regjistrin e OJF-ve. I gjithë informacioni i mësipërm duhet të jetë publik. Megjithatë, deri më sot ky informacion nuk është publik online, dhe për momentin mund të merret vetëm në kopje fizike.</p>
<b>Ruajtja e informacionit<sup>24</sup></b>	<p>Legjislacioni në lidhje me Regjistrin e OJF-ve dhe legjislacioni në lidhje me Regjistrin Tregtar - Qendra Kombëtare e Biznesit (në lidhje me informacionin për pronarët përfitues të OJF-ve) parashikojnë që informacioni në këto regjistra duhet të përditësohet. Ndryshimet në informacionin organizativ dhe/ose aktet nënligjore të OJF-së dorëzohen në Regjistrin e OJF-ve. OJF-ve u kërkohet të mbajnë informacion fiskal për të paktën 10 (dhjetë) vite<sup>25</sup>; informacioni i ndjeshëm dhe sekret shtetëror rregullohet me dispozita të veçanta ligjore.</p> <p>Strukturat e verifikimit dhe kontrollit të administratës tatimore, identifikojnë OJF-të që operojnë në territorin e tyre dhe kontrollojnë periodikisht regjistrimin e tyre pranë organeve tatimore, përditësimin e informacionit përkatës, deklarimin e punonjësve dhe aktivitetin ekonomik sipas dispozitave ligjore në fuqi.</p>

<sup>21</sup> Në përputhje me Shënimin Interpretues të FATF-së për Rekomandimin 8, ky mbulon emrin, adresën, objektivat dhe dokumentin qeverisës të OJF-së; dhe emrin dhe adresën e kontrollorëve, mbajtësve të zyrave dhe/ose drejtuesit/ve të lartë. Ky seksion lidhet me informacionin e marrë dhe mbajtur nga rregullatori gjatë regjistrimit.

<sup>22</sup> Ky informacion është në përputhje me Shënimin Interpretues të FATF-së për Rekomandimin 8.

<sup>23</sup> I njëjti informacion si më sipër. Ky seksion lidhet me informacionin që palët e treta kanë në të drejtën e aksesit, qoftë nga regjistruesi ose nga OJF-ja. Për këtë shërbim mund të ketë një tarifë.

<sup>24</sup> I njëjti informacion si më sipër. Ky seksion mbulon mekanizmat për të siguruar që ky informacion të përditësohet rregullisht.

<sup>25</sup> Ligji 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

	Emri i ligjit
<b>Raportimi vjetor</b>	<p>OJF-të duhet të dorëzojnë pasqyrat financiare vjetore brenda 3 (tre) muajve pas përfundimit të vitit fiskal të mëparshëm, dokumente të tilla të nënshkruara nga Drejtori Ekzekutiv dhe kontabilisti i caktuar i regjistruar dhe audituesi i certifikuar (nëse ky i fundit përdoret ose zbatohet për OJF-në).</p> <p>Organizatat jofitimprurëse që kanë vlera aktive ose të ardhura më shumë se 5 milionë lekë, dorëzojnë të gjitha pasqyrat financiare duke përfshirë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e aktiviteteve dhe pasqyrën e fluksit të parasë. Të gjitha OJF-të e tjera që nuk plotësojnë këto kritere, aplikojnë kontabilitetin mbi baza monetare dhe dorëzojnë vetëm pasqyrën e fluksit të parasë të shoqëruar me shënime shpjeguese në lidhje me llojin e aktiviteteve apo shërbimeve që ofrojnë.</p>
<b>Kontabiliteti dhe auditimet</b>	<p>Çdo vit, financieri i regjistruar (i cili mund të kryejë edhe detyrat e Zyrtarit të Dosjeve Tatimore) i OJF-së duhet të paraqesë në organet vendimmarrëse të OJF-ve, në Regjistrin e OJF-ve dhe në organet tatimore pasqyrat financiare vjetore. Si praktikë, disa OJF auditojnë veprimtarinë e tyre financiare, duke ndjekur për analogji kërkesat e zbatueshme për bizneset (siç parashikohet nga Ligji për Auditimin e Certifikuar dhe Kontabilistin e Regjistruar<sup>26</sup>). Disa OJF të tjera përgatisin pasqyrat financiare vjetore të audituara kur kërkohet auditimi nga auditorët e pavarur të certifikuar nga donatorët që financojnë veprimtarinë e OJF-së.</p>
<b>Publikimi i informacionit financiar</b>	<p>Ligji ekzistues për Kontabilitetin parashikon detyrimin e OJF-ve me xhiro mbi 30,000,000 lekë të publikojnë pasqyrat financiare vjetore në faqen e tyre zyrtare të internetit. Gjithashtu, ato duhet të përgatisin dhe publikojnë një raport të performancës në lidhje me aktivitetin e tyre.</p> <p>Organet tatimore dhe Regjistri i OJF-ve nuk publikojnë pasqyrat financiare të OJF-ve. Kur të jetë aktiv, Regjistri i OJF-ve online do ta publikojë këtë informacion.</p>
<b>Inspektimet</b>	<p>Pasqyrat Financiare Vjetore të paraqitura pranë organeve tatimore mund të shqyrtohen nga zyrat përkatëse rajonale tatimore të DPT-së shqiptare, të cilat analizojnë burimet e fondeve, përdorimin e fondeve, aktivet e OJF-së dhe aktivitetin ekonomik të OJF-së (nëse ka).</p> <p>Sipas legjislacionit të Procedurave Tatimore, OJF-të (si çdo tatimpagues tjetër në Republikën e Shqipërisë) inspektohen ex-post për qëllime të përputhshmërisë tatimore.</p> <p>Sipas ligjit, Sektori i Kontrollit Tatimor pranë Drejtorive Rajonale Tatimore ushtron kontroll të thelluar operacional për rastet që paraqesin rrezik, bazuar në tipologjinë e rreziqeve në shtojcën përkatëse bashkëlidhur Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, dhe bazuar në treguesit e shtojcës 1 bashkëlidhur Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.19, datë 9.7.2019<sup>27</sup>.</p>

<sup>26</sup> Ligji nr.10091 datë 5.03.2009, i ndryshuar.

<sup>27</sup> Gjatë kontrolleve të tilla merren parasysh: të dhënat e burimit të fondeve, marrëveshjet e granteve, marrëveshjet për dhurime, dokumentacioni i kuotave të anëtarësimit, verifikimi i deklaratës në organin tatimor të llogarisë bankare ku bëhen dhurimet, verifikimi nëse fondet mbahen në llogari bankare dhe nëse transfertat ose transaksionet financiare që lidhen me këto fonde kanalizohen përmes sistemit bankar; kryerja e detyrave nga organi më i lartë vendimmarrës; nëse organizatat që kanë aktivitet ekonomik dhe gjenerojnë fitime i përdorin ato për të mbështetur misionin e tyre shoqëror.

	<b>Emri i ligjit</b>
<b>Verifikimi</b>	<p>Ligji nuk parashikon shprehimisht verifikimin e OJF-ve dhe/ose verifikimin e anëtarëve të Bordit, etj. Megjithatë, një lloj verifikimi zbatohet për OJF-të kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Një ose më shumë nga pronarët e tyre përfitues janë Persona të Ekspozuar Politikisht (sipas dispozitave të Ligjit për PPP/FT);</li> <li>- Paketa e aplikimit për financim nga shumica e donatorëve të huaj dhe vendas dhe Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, kërkon dorëzimin e të dhënave të pastra kriminale.</li> </ul>
<b>Kujdesi i duhur</b>	<p>Ligji nuk parashikon shprehimisht kujdesin e duhur të OJF-ve lidhur me FT-në, pasi OJF-të nuk janë subjekte të ligjit, por klientë të subjekteve të tij. Pavarësisht sa më sipër, bazuar në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, rregulloret e BSH-së dhe rregulloret e AMF-së përmbajnë dispozita për kujdesin e duhur para-miratues për qëllime të shërbimeve dhe produkteve financiare që u ofrohen klientëve OJF nga bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare jobanka dhe operatorët nën regjimin rregullator të AMF-së.</p> <p>Lidhur me kujdesin e duhur të OJF-ve për të reduktuar një rrezik të mundshëm të financimit të terrorizmit, 42% e OJF-ve të anketuara raportojnë se bëjnë kujdesin e duhur të përfituesve, 35% të donatorëve dhe 47% të partnerëve.</p>
<b>Hetimet dhe inteligjenca</b>	<p>Autoritetet tatimore kanë një drejtori të posaçme lidhur me hetimet dhe inteligjencën, duke përfshirë edhe çështjet e FT-së, që asistojnë edhe për përgatitjen e informacionit/raporteve drejtuar DPPP-së.</p>
<b>Sanksionet dhe kompetencat korrigjuese</b>	<p>Kërkesa për regjistrim refuzohet nga gjykata, nëse ndonjë nga themeluesit ose anëtarët e organeve vendimmarrëse të OJF-së, ndodhet në listën e zezë zyrtare të përgatitur dhe në dispozicion sipas legjislacionit në fuqi për masat kundër financimit të terrorizmit.</p> <p>Nëse një organizatë ka deklaruar të dhëna të rreme ose nuk është regjistruar në përputhje me Ligjin për Regjistrimin e OJF-ve brenda afateve, sanksionohet me gjobë. Përpara dhënies së vendimit përkatës, gjykata njofton OJF-në të paraqesë kërkesën për regjistrim ose të korrigjojë të dhënat brenda 30 ditëve nga njoftimi.</p> <p>Sanksionet specifike parashikohen edhe në Ligjin për Regjistrin e Pronarëve Përfitues nga mos regjistrimi.</p> <p>Ligji i Procedurës Tatimore parashikon sanksion specifik nëse OJF-ja (siçdo tatimpagues tjetër) nuk deklaron dhe dorëzon brenda afateve ligjore pasqyrat financiare vjetore.</p>
<b>Ndarja e informacionit</b>	<p>DPT-ja është e autorizuar të ndajë informacione lidhur me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit me çdo agjenci të zbatimit të ligjit ose autoritet tjetër përkatës. Gjithashtu, ekzistojnë procese formale për marrjen e informacionit nga Regjistri Qendror i Llogarive Bankare dhe Regjistri i Pronarëve Përfitues dhe për ndarjen e informacionit me agjencitë shtetërore, si DPPP-ja, e cila ka qasje të pakufizuar në secilin regjistër, me policinë e shtetit, prokurorinë speciale kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, etj.</p>
<b>Kontaktimi (Outreach)</b>	<p>Sipas Ligjit për Procedurat Tatimore, autoritetet fiskale kanë për detyrë të informojnë tatimpaguesin për çështjet fiskale, duke përfshirë por pa u kufizuar në çështjet që lidhen me PPP-në dhe FT-në. Çështjet specifike të FT-së shpesh diskutohen gjatë dhe identifikohen në raportet pas inspektimeve tatimore.</p>

	Emri i ligjit
<b>Kapaciteti rregullator</b>	Regjistri i OJF-ve ka vetëm 1 (një) zyrtar që menaxhon Regjistrin e gjithsej 11,962 OJF-ve. Në DPT nuk ka staf të dedikuar vetëm për OJF-të, por ka staf të trajnuar për mbikëqyrjen e OJF-ve.
<b>Mbikëqyrja e synuar e bazuar në rrezik</b>	Deri më sot, mbikëqyrja e synuar e OJF-ve bazuar në rrezikun e FT-ve është synuar, por nuk është formalizuar me legjislacion specifik. Zyra e Tatimeve Rajonale përkatëse duhet të raportojë (nëse evidentohet) rastet e financimit që paraqet rrezik sipas tipologjisë së rreziqeve të paraqitura në Shtojcën 1 (Lista e treguesve për veprimtari të dyshimtë) të Udhëzimit të MF nr.16, datë 16.2.2009 “Për PPP dhe FT në sistemin tatimor” dhe treguesit e Shtojcës 1 të Udhëzimit të MFE nr.19, datë 9.7.2019 “Për mbikëqyrjen e OJF-ve që lidhen me PPP/FT”, pranë njësisë qendrore tek DPT-ja. Pas vlerësimit të rastit, njësia e dërgon atë në DPPPP.

## Vlerësimi i përshtatshmërisë së masave zbutëse – Ligjet dhe Rregulloret

53. Si konsideratë e përgjithshme, miratimi i legjislacionit të ri konsiderohet si efektiv për të zbutur rrezikun e FT-së në sektorin e OJF-ve. Masat e mëposhtme, të miratuara së fundmi, të zbatueshme për sektorin e OJF-ve në përgjithësi janë efektive për të zbutur rrezikun e FT-së në këtë sektor:

- ✓ Miratimi i dy udhëzimeve të MF-së nr.16/2009 dhe MFE nr.19/2019 lidhur me kërkesat për dokumentacionin në lidhje me financimin e OJF-ve.
- ✓ Miratimi i Ndryshimit të Ligjit për Procedurat Tatimore (2019) lidhur me kërkesën e detyrueshme që OJF-të të kenë të paktën 1 (një) llogari bankare; çdo llogari bankare e OJF-së e mbajtur në Shqipëri ose jashtë vendit duhet të deklarohet në organet tatimore.
- ✓ Miratimi i Ligjit të ri për Regjistrimin e OJF-ve.
- ✓ Miratimi i Ligjit për Pronarët Përfitues.
- ✓ Miratimi i Ligjit për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare.
- ✓ Miratimi i kërkesave ligjore për përgatitjen dhe publikimin e raportit të performancës në faqen përkatëse të internetit të OJF-ve, të parashikuara nga Ligji i Kontabilitetit.
- ✓ Miratimi i kërkesës për standarde specifike kombëtare të kontabilitetit të zbatueshme për OJF-të mundëson transparencën financiare të OJF-ve, duke përfshirë transparencën e nevojshme për qëllimet e FT-së.
- ✓ Miratimi i ligjit për sistemin e monitorimit të faturave dhe qarkullimit (fiskalizimi).
- ✓ Miratimi dhe ndryshimet e ligjit për PPP-në dhe FT-në.
- ✓ Ndryshimi i vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar të kryer nga AMF-ja për subjektet e Ligjit për PPP-në dhe FT-në (2020).<sup>28</sup>

54. Kërkesat e regjistrimit dhe informacionit për OJF-të janë kryesisht në përputhje me kërkesat e pjesëve 8.3 dhe 8.4 të Metodologjisë së FATF-së, dhe me paragrafin 6(b)(i), (ii), (iii), (iv) dhe (vi) të Shënimit Shpjegues. Në mënyrë të veçantë, OJF-ve u kërkohet të:

- regjistrohen dhe mbajnë informacion mbi qëllimin dhe objektivat e aktiviteteve të tyre të deklaruara;<sup>29</sup>
- ruajnë informacionin mbi “identitetin e personit(ave) që zotërojnë, kontrollojnë ose drejtojnë aktivitetet e tyre, duke përfshirë zyrtarët e lartë, anëtarët e bordit dhe të besuarit (trustees)”;<sup>30</sup>

<sup>28</sup> Vendimi i Bordit të AMF-së nr.97, datë 29.07.2020 dhe Vendimi i Bordit nr.199, datë 29.12.2020, ka ndryshuar Rregulloren nr.58, datë 30.06.2015 “Për masat e kujdesit të zakonshëm dhe të thelluar ndaj subjekteve të Ligjit për AML dhe CFT”.

<sup>29</sup> 6(b)(i) dhe (ii), të Shënimit Shpjegues të Rekomandimit 8.

<sup>30</sup> po aty, 6(b)(ii).

- kenë kontrolle të duhura për të siguruar që të gjitha fondet janë llogaritur plotësisht;<sup>31</sup>
  - prodhojnë pasqyra financiare vjetore që ofrojnë ndarje të detajuara të të ardhurave dhe shpenzimeve;<sup>32</sup>
  - mbajnë të dhëna financiare për një periudhë prej të paktën 5 (pesë) vitesh.<sup>33</sup>
55. Transparenca është një parim kyç në mbikëqyrjen e OJF-ve. Regjistri online i OJF-ve (dhe Regjistri Tregtar (QKB) i cili administron Regjistrin e Pronarëve Përfitues, duke përfshirë të dhënat përkatëse të marra nga Regjistri i OJF-ve online) pritet të prezantojë masa të reja për të zbatuar me efektivitet dispozitat ligjore ekzistuese për të rritur transparencën e OJF-ve, duke përfshirë transparencën organizative dhe financiare. Pritet që informacioni për fushën e veprimtarisë së OJF-ve, identiteti i themeluesve, organet vendimmarrëse, përfaqësuesit ligjorë dhe informacione të tjera financiare të publikohen nga Regjistri i OJF-ve,<sup>34</sup> përveç informacionit për pronarët përfitues që do të mbahet nga Regjistri i Pronarëve Përfitues.
56. Autoritetet publike dhe institucionet financiare vlerësojnë se kuadri ligjor, si dhe masat mbikëqyrëse dhe parandaluese të zbatuara nga institucionet ligjzbatuese në luftën kundër financimit të terrorizmit, janë në përputhje me standardet dhe konventat ndërkombëtare dhe përbëjnë një faktor pozitiv për zbutjen e rrezikut.
57. Sipas tyre, zbatimi efektiv i legjislacionit ekzistues ndikohet nga mungesa e kapaciteteve monitoruese (kapacitetet njerëzore dhe teknike, mungesa e strukturave të specializuara), numri i madh i OJF-ve në vend, si dhe niveli i komunikimit, i koordinimit dhe i bashkëpunimit ndërmjet strukturave ekzistuese. Një aspekt tjetër që ndikon në zbatimin efektiv është mungesa e besimit midis autoriteteve shtetërore dhe OJF-ve.
58. Analiza e ligjit dhe intervistat me zyrtarë sugjerojnë se masat për marrjen dhe shkëmbimin e informacionit, hetimeve dhe inteligjencës (8.5 dhe 8.6 të Metodologjisë së FATF-së) janë të duhura. Disa analiza specifike janë dhënë këtu më poshtë.
59. Lidhur me 8.5.(a) të Metodologjisë së FATF-së: Analiza e ligjit dhe intervistat me zyrtarë publikë sugjerojnë se ekziston një sistem efektiv për ndarjen e informacionit ndërmjet agjencive përkatëse, kryesisht ndërmjet DPPP-së, PSh-së dhe DPT-së si organ mbikëqyrës për OJF-të.
60. Lidhur me 8.5.(b) të Metodologjisë së FATF-së: Inspektimet dhe hetimet nga autoritetet publike, kontrollet ligjore të OJF-ve nga bankat dhe institucionet financiare jobanka (nën regjimin rregullator të BSH-së) dhe nga operatorët e tjerë financiarë (nën regjimin rregullator të AMF-së) deri më sot, tregojnë se nuk ka asnjë rast të shkeljeve për qëllime të FT-së në sektorin e OJF-ve, duke sugjeruar se masat janë të përshtatshme. Megjithatë, mungesa e kontaktimit (outreach) dhe kontrollit të organeve mbikëqyrëse në të gjithë vendin dhe ndaj të gjitha kategorive të OJF-ve, pengon një vlerësim të plotë të përshtatshmërisë dhe efektivitetit të këtyre masave.
61. Në lidhje me 8.5.(c) të Metodologjisë së FATF-së: Legjislacioni në lidhje me Regjistrin e OJF-ve dhe Regjistrin Tregtar (në lidhje me informacionin për pronarët përfitues të OJF-ve), Ligji për Procedurat Tatimore dhe Kodi Penal, kanë kompetencat e nevojshme sanksionuese dhe korrigjuese.
62. Deklarimi i të dhënave të pavërteta në regjistrin e OJF-ve dhe mospërbushja e detyrimit për regjistrim (regjistrimi fillestar dhe të tjera të detyrueshme) konsiderohen kundërvajtje administrative të sanksionuara me gjobë. Niveli i gjobave shkon nga 0,1% në 1% të të ardhurave vjetore të deklaruar nga organizata jofitimprurëse. Në çdo rast, masa e gjobës nuk mund të jetë më e vogël se 30,000 (tridhjetë mijë) lekë (rreth 260 euro). Kjo dispozitë ligjore nuk është në përputhje me kërkesat e FATF-së R8.4(b) që sanksionet të jenë proporcionale, veçanërisht, mungesa e nivelit maksimal të gjobës.<sup>35</sup> Dispozitat e përmendura më sipër, lejojnë vendosjen e niveleve të ndryshme të gjobave për të njëjtën shkelje; shumica e gjobës varet nga të ardhurat e OJF-së, dhe kjo është në kundërshtim me parimin e barazisë, dhe në kundërshtim me legjislacionin përkatës, të drejtat njerëzore dhe kushtetuese.
63. Nuk ka një mekanizëm sistematik për të siguruar mbikëqyrje ose monitorim të synuar, të bazuar në rrezik të OJF-ve për abuzim me financimin e terrorizmit, në përputhje me 8.3 dhe 8.4 të Metodologjisë së FATF-së.

<sup>31</sup> *po aty, 6(b)(iv).*

<sup>32</sup> *po aty, 6(b)(iii).*

<sup>33</sup> *po aty, 6(b)(vi).*

<sup>34</sup> FATF 'e inkurajon' këtë qasje, por nuk e kërkon atë. Shih Shënimin Interpretues të Rekomandimit 8, paragrafët 6(b)(i) dhe 6(b)(ii).


<sup>35</sup> Mungesa e nivelit maksimal të gjobës është gjithashtu në kundërshtim me Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative", sipas të cilit duhet të zbatohen kufijtë maksimalë dhe minimalë të gjobave..

64. Autoritetet tatimore kanë regjime të kufizuara monitorimi mbi OJF-të, të përbëra nga kontrolle dhe inspektime financiare (8.3 dhe 8.4 të Metodologjisë FATF-së). Fushëveprimi është në verifikimin e përputhshmërisë ligjore dhe financiare. Për më tepër, as regjistri i OJF-ve dhe as autoritetet tatimore nuk kanë një kategorizim të standardizuar dhe targetim të bazuar në rrezik të OJF-ve; nuk ka asnjë masë të fokusuar në dobësitë ose rreziqet e FT-së, bazuar në ndonjë metodologji të rrezikut të OJF-ve. Legjislacioni parashikon disa tregues të rrezikut, që mund të përdoren nga organet tatimore gjatë kryerjes së kontrollit të thelluar mbi OJF-të (nënkuptohej që ky kontroll përfshin edhe kontrollin operacional).
65. Përputhshmëria me kërkesat për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore në Regjistrin e OJF-ve është e ulët<sup>36</sup>; megjithatë, OJF-të përbushin në masë të madhe kërkesën për t'i dorëzuar këto deklarata pranë zyrave përkatëse rajonale tatimore. Bazuar në informacionin e dhënë nga DPT-ja, për vitin 2021 janë 472 subjekte (vetëm 5% e të gjitha OJF-ve aktive të regjistruara në DPT) të penalizuara për mos deklarim të pasqyrave financiare brenda afatit ligjor me vlerën 10,000 lekë, nga të cilat: 2 subjekte janë organizata fetare, humanitare dhe bamirëse; 6 janë subjekte të organizimit politik; 464 janë organizata jofitimprurëse.
66. Kapacitete të ulëta të burimeve njerëzore të institucioneve përkatëse publike për t'u marrë me OJF-të, p.sh. Regjistri i OJF-ve ka vetëm 1 (një) zyrtar; ndërsa tek organet tatimore mungojnë inspektorët e dedikuar për OJF-të.

## Vlerësimi i përshtatshmërisë së masave zbutëse – Kontaktimi (outreach) dhe Masat e OJF-ve

67. Kontaktimi (outreach) është mekanizmi kryesor përmes të cilit qeveritë mund të ndikojnë përmirësimet e masat zbutëse të zbatuara nga OJF-të (shih gjithashtu paragrafin 8.2 të Metodologjisë së FATF-së). Sipas RVN 2018, DPT-ja ka zhvilluar disa takime me përfaqësues të sektorit të OJF-ve për të ndarë dhe shkëmbyer informacionin përkatës mbi rreziqet e FT-së. Megjithatë, Shqipëria ka ende nevojë të zhvillojë dokumentin e saj përkatës të praktikave më të mira me përfshirjen e gjerë të sektorit të OJF-ve.
68. Masat kundër FT-së nga qeveria që synojnë ndërgjegjësimin dhe kontaktimin e publikut (outreach) nuk po depërtojnë mjaftueshëm në sektorin e OJF-ve. Nga anketimi me 153 OJF, 63% raportojnë se nuk janë në dijeni të masave të qeverisë për PPP/FT.

Figura 2: Ndërgjegjësimi i OJF-ve për masat e qeverisë lidhur me PPP/FT (Burimi: Anketimi me OJF-të, nr. = 153 OJF)




69. Nga 153 OJF të anketuara, vetëm 38 prej tyre (25%) janë në dijeni të masave dhe politikave të marra nga qeveria për të reduktuar rreziqet e financimit të terrorizmit për OJF-të. Kur u pyetën për efektivitetin e këtyre masave, 18 nga 38 OJF që ishin në dijeni të tyre, zgjodhën si më të vërtetë alternativën se masat e fundit në mënyrë efektive ulin me të vërtetë rrezikun e mundshëm të financimit të terrorizmit, ndërsa 17 OJF zgjodhën si më të vërtetë alternativën se këto masa kufizojnë aftësinë e OJF-ve për të punuar në mënyrë efektive.

<sup>36</sup> Më pak se 50%, sipas një interviste me Regjistrarin e Shoqatave.

70. Lidhur me masat e OJF-ve, gjatë anketimit OJF-ve iu kërkua të vetë-raportonin mbi nëntë praktikat më të mira, të cilat janë të rëndësishme për reduktimin e rreziqeve të FT-së. Shumica e OJF-ve të anketuara raportojnë se aplikojnë praktikat më të mira në sistemet e menaxhimit të projekteve (90%), sistemet e menaxhimit financiar (87%) dhe masat e qeverisjes (83%). Sa i përket vlerësimit formal të rrezikut të FT-së, 26% raportuan se kanë bërë një vlerësim të tillë.

**Figura 3: Praktikak më të mira të raportuara nga OJF-të (Burimi: Anketimi me OJF-të, nr.= 153 OJF)**



71. Në vitin 2019, Partnerët Shqipëri nëpërmjet Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile, filloi zbatimin e Kodit të Standardeve për OJF-të (<https://standards4npo.al/>), bazuar në modelet më të mira ndërkombëtare. Kodi synon të përmirësojë efektivitetin e OJF-ve dhe të rrisë besimin e mbështetësve, përfituesve dhe palëve të tjera të interesit duke rritur qeverisjen e mirë, transparencën dhe llogaridhënien e sektorit. Kodi është një mekanizëm vetërregullues i ndërmarrë me vullnetin e lirë të OJF-ve dhe një mekanizëm mundësues për të gjitha OJF-të që duan të avancojnë standardet e punës së tyre. Që nga fillimi i tij në shtator 2020, anëtarësimi i Kodit numëron 21 OJF në të gjithë vendin dhe 10 OJF janë duke kaluar aktualisht në procesin e Vlerësimit.

## Vlerësimi i përgjithshëm

72. Ekziston një sistem ligjor dhe rregullator i mirë-krijuar dhe gjithëpërfshirës, i cili ofron bazën për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e informacionit për të gjitha OJF-të, si dhe për ndarjen e informacionit dhe hetimin. Kjo është kryesisht efektive, megjithëse ka disa shqetësime në lidhje me nivelin e burimeve njerëzore dhe teknike në disa fusha, dhe përputhshmëria me kërkesat e raportimit mund të përmirësohet. Zhvillimet e fundit priten të sjellin më tepër transparencë. Sistemet ekzistuese për klasifikimin e OJF-ve nuk lehtësojnë identifikimin dhe targetimin e OJF-ve 'në rrezik' për qëllime FT-së. Nuk ka masa ose udhëzime të mjaftueshme për zyrtarët mbi mbikëqyrjen dhe monitorimin e synuar, të bazuar në rrezik për qëllime të FT-së. Masat aktuale të kontaktimit (outreach) nuk janë të mjaftueshme.

73. Përshtatshmëria e masave zbutëse për OJF-të vlerësohet E Mesme.

## Përshtatshmëria e Masave Zbutëse: I gjithë sektori i OJF-ve

### E MESME

74. Masat zbutëse efektive reduktojnë rrezikun e qenësishëm për të prodhuar një rrezik të përgjithshëm të mbetur:

(Rreziku i Qenësishëm – Ndikimi i Masave Zbutëse) = Rreziku i Mbetur

Kategoria e Rrezikut	Rreziku i Qenësishëm	Përshtatshmëria e Masave Zbutëse	Rreziku i Mbetur
I gjithë sektori i OJF-ve	I ulët	I mesëm	I ulët

## Rekomandime

75. Regjistri i ri online i OJF-ve duhet të jetë i pajisur me bazën ligjore dhe teknikalitete përkatëse për kategorizimin e OJF-ve në sistemin online të Regjistrimit të OJF-ve sipas fushës së veprimtarisë së tyre; një kategorizim i tillë do të lehtësonte zbatimin e një qasjeje të bazuar në rrezik në sektorin e OJF-ve për qëllime të FT-së.

76. Ligji për Regjistrimin e OJF-ve duhet të rishikohet për të adresuar mangësitë e identifikuar nga OJF-të dhe t'i prezantohet ligjvënësve, duke përfshirë nivelin joproporcional të gjobave për deklarimin e të dhënave të pavërteta dhe/ose mospërbushjen e detyrimeve për regjistrimin fillestar, apo regjistrime të tjera të detyrueshme.

77. Legjislacioni dytësor përkatës që zbaton Ligjin për Regjistrimin e OJF-ve, i cili do të miratohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të prezantojë një sistem formal për kategorizimin e OJF-ve (siç udhëhiqet edhe nga legjislacioni për PPP dhe FT), i cili do të lehtësojë identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve, duke përfshirë rreziqet e FT-së, nga autoritetet përkatëse të PPP/FT-së (përfshirë autoritetet tatimore), dhe do të sigurojë në përgjithësi që subjektet me rrezik më të lartë të përballen me një kontroll shtesë për t'u zbatuar nga autoritetet përkatëse shtetërore.

78. Duhet të zhvillohet një sistem strategjik i vlerësimit të rrezikut duke mbështetur dhe bashkuar elementet individuale të mbikëqyrjes në regjistrim, raportim dhe monitorim nëpërmjet pasqyrave financiare vjetore dhe inspektimeve. Në mënyrë të veçantë, sistemi duhet të përfshijë:

- ✓ Një sistem për kategorizimin e OJF-ve, sipas fushës së tyre të veprimtarisë në Regjistrin e ri online të OJF-ve. Kjo duhet të merret parasysh në përgatitjen e formularëve të regjistrimit të OJF-ve, për krijimin e regjistrimit online të OJF-ve. Një kategorizim i tillë do të udhëzonte për zbatimin e një qasjeje të bazuar në rrezik në sektorin e OJF-ve për qëllime të FT-së;
- ✓ Një sistem për identifikimin e karakteristikave ose aktiviteteve që i vendosin OJF-të në rrezik më të lartë (duke vazhduar dhe duke u mbështetur në punën e Raportit të Vlerësimit të Rrezikut të OJF-ve);
- ✓ Një sistem për të siguruar që këto konkluzione të jenë të integruara në mekanizmat ekzistuese rregullatore (si p.sh., një sistem vlerësimi për identifikimin e OJF-ve që shfaqin karakteristika me rrezik të lartë);
- ✓ Një sistem masash të përshtatshme shtesë për OJF-të e identifikuar me rrezik më të lartë (d.m.th. një kontroll më i madh përmes inspektimeve);



- ✓ Një mekanizëm reagimi, në mënyrë që intelijenca e fituar përmes monitorimit shtesë të përdoret për të identifikuar më mirë faktorët e rrezikut;
- ✓ Sistemi duhet të bazohet në kritere objektive ose kërkesa për shqyrtim. Ai duhet të shmangë hapësirën për gjykimin njerëzor kur zyrtarët e lartë dëshirojnë të shtojnë ose heqin OJF-të nga mbikëqyrja shtesë;
- ✓ Ai duhet të mbështetet nga një sistem i formalizuar dhe i standardizuar i bazuar në kritere objektive për monitorimin e pasqyrave financiare vjetore, për të identifikuar subjektet me rrezik të lartë.

**79.** Duhet të rriten kapacitetet e burimeve njerëzore të autoriteteve shtetërore përgjegjëse për regjistrimin dhe mbikëqyrjen e OJF-ve. Regjistri i OJF-ve duhet të ketë numër të mjaftueshëm zyrtarësh për të mundësuar shërbime cilësore nga Regjistri i OJF-ve; autoritetet tatimore duhet të kenë staf të dedikuar, të mjaftueshëm dhe të trajnuar për t'iu shërbyer nevojave të specializuara të OJF-ve, në mënyrë që kontrolli i tyre të mos fokusohet vetëm në çështjet që lidhen me evazionin fiskal, por të përfshijë edhe mbikëqyrjen lidhur me FT-në. Kjo duhet të bazohet në disa udhëzime të përgatitura për inspektorët tatimorë se si të ushtrorjnë funksionin e tyre në lidhje me FT-në në sektorin e OJF-ve. Udhëzimet mund të përfshijnë pyetje specifike, ndoshta nëpërmjet një pyetësi të veçantë, për të identifikuar faktorë të veçantë rreziku, si transaksionet me juridiksione me rrezik të lartë, ekspozimi ndaj ndikimeve ekstremiste, ose përdorimi i transferimit të fondeve alternative.

**80.** Zyra e Regjistrimit të OJF-ve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, DPT-ja dhe DPPPP-ja duhet të zgjerojnë ndjeshëm programin e tyre të kontaktimit (outreach). Programi duhet të mbulojë një sërë temash të rëndësishme dhe specifike për FT-në për një audiencë të gjerë. Ai duhet të përfshijë:

- ✓ Programe të përgjithshme për rritjen e ndërgjegjësimit që synojnë donatorët dhe publikun për çështjet që kanë të bëjnë me FT-në dhe tregojnë se ku ka nevojë për këshilla të mëtejshme.
- ✓ Këshilla të përgjithshme dhe/ose trajnime për OJF-të mbi praktikën më të mirë, duke përfshirë mënyrën e identifikimit të FT-së së mundshme dhe si të identifikohet nëse OJF-ja është me rrezik më të lartë.
- ✓ Këshilla, udhëzime dhe/ose trajnime të synuara për OJF-të me rrezik më të lartë, duke ofruar shpjegime të hollësishme të detyrimeve ligjore dhe udhëzime të praktikave më të mira për çështje kyçe si qeverisja, financa, menaxhimi i projektit, menaxhimi i rrezikut dhe kujdesi i duhur.
- ✓ Ndarja e raportit të Vlerësimit të Rrezikut dhe gjetjeve të tij kryesore ndërmjet palëve të interesuara të qeverisë, OJF-ve dhe sektorit privat.

**81.** Duhet të përmirësohet komunikimi dhe bashkëpunimi i agjencive shtetërore me OJF-të dhe palët e tjera të interesit, nëpërmjet krijimit të një strukture të përbashkët të përhershme për të identifikuar dhe diskutuar çështje që lidhen me FT-në, rreziqet e FT-së dhe politikat e FT-së duke përfshirë institucionet që rregullojnë veprimtarinë e sektorit financiar dhe OJF-ve, intelijencën, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe OJF-të përfaqësuese (duke përfshirë ato nga kategoritë me rrezik më të lartë), donatorët kryesorë dhe institucionet financiare.

# E. ORGANIZATA ME VEPRIMTARI HUMANITARE DHE BAMIRËSE


82. Vlerësimi i Rrezikut të Qenësishëm vë në dukje se nuk ka raste të organizatave humanitare dhe bamirëse të përdorura për qëllime FT-je të identifikuara në Shqipëri. Megjithatë, intervistat me autoritetet shtetërore dhe institucionet financiare sugjerojnë se organizatat me veprimtari humanitare dhe bamirëse konsiderohen të cënueshme dhe me një rrezik potencial më të lartë për t'u keqpërdorur për qëllime të FT-së, sepse aktivitetet e tyre mund të përdoren si një mundësi për mbledhjen e fondeve për aktivitete terroriste ose aktivitete të tjera të paligjshme. Këto organizata kanë një nivel të lartë besimi në komunitet, i cili mund të përdoret nga grupet terroriste për të financuar aktivitetin e tyre të paligjshëm.

Sipas Vlerësimit të Rrezikut të Qenësishëm,  
Prevalenca e këtij faktor rreziku është **E ULËT – E MESME** dhe Relevanca është  
**E MESME – E LARTË**

83. Sipas informacionit të dhënë nga DPT-ja në maj 2021, organizatat humanitare, fetare dhe bamirëse përfaqësojnë vetëm 3,1% nga 2,372 organizata të regjistruara në DPT.


84. Sipas anketimit me 153 OJF, 21% e tyre (32 OJF), kanë raportuar se ofrojnë ndihmë humanitare. Sipas formës ligjore të regjistrimit, 47% e këtyre organizatave janë shoqata, 31% janë fondacione dhe 22% janë qendra.

**Figura 4: OJF-të që raportojnë veprimtari të ndihmës humanitare sipas formës ligjore (Burimi: Anketimi me OJF-të, nr. = 32 OJF)**




85. Vetëm 1 (një) prej këtyre OJF-ve është me qendër në Tiranë, ndërsa të gjitha 31 OJF-të e tjera e kanë zyrën ligjore në qytete të tjera.
86. Për sa i përket të ardhurave vjetore, 31% e këtij grupi OJF-sh (10 OJF) raportuan të ardhura mbi 30 milionë lekë, që përbën gjysmën e të gjitha OJF-ve të anketuara që kanë raportuar të ardhura totale vjetore mbi 30 milionë lekë.

**Figura 5: OJF-të që raportojnë veprimtari të ndihmës humanitare sipas të ardhurave vjetore (Burimi: Anketimi me OJF-të, nr=32 OJF)**



87. Sa i përket burimeve të fondeve, pothuajse të gjitha, 94% ose 30 OJF që ofrojnë ndihmë humanitare, raportojnë se kanë marrë fonde nga grantet ose kontratat.

**Figura 6: Burimi i fondeve të OJF-ve që raportojnë veprimtari të ndihmës humanitare (Burimi: Anketimi me OJF-të, nr.= 32 OJF, me shumë zgjedhje)**



## Vlerësimi i përshtatshmërisë së masave zbutëse – Ligjet dhe Rregulloret

88. OJF-të me veprimtari humanitare dhe bamirëse nuk i nënshtrohen ligjeve apo rregulloreve specifike në lidhje me aktivitetet e tyre specifike humanitare. Kuadri ligjor i zbatueshëm për këtë grup është në shumicën e aspekteve i njëjtë si për të gjitha OJF-të dhe është analizuar në seksionin D të lartpërmendur këtu. Megjithatë, legjislacioni ose rregulloret specifike të mëposhtme zbatohen në mënyrë specifike për këtë grup OJF-sh dhe janë analizuar si më poshtë:


- ✓ Ligji nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr.102/2014, datë 31.7.2014 “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat në zbatim të ligjit nr.102/2014, Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- ✓ Aktet e tjera nënligjore që zbatojnë ligjet e lartpërmendura.

89. Legjislacioni doganor parashikon disa përjashtime për mallrat e importuara në Shqipëri për organizatat bamirëse dhe filantropike, dhe legjislacioni tatimor parashikon që ndihma humanitare dhe importet e lidhura me bamirësinë që kryhen nga organizata humanitare dhe bamirëse në Shqipëri, përjashtohen nga taksat doganore dhe TVSH-ja në import; legjislacioni tatimor parashikon gjithashtu që norma prej 0% zbatohet për eksportet e kryera nga OJF-të humanitare. Legjislacioni dytësor ekzistues nuk është mjaftueshëm i detajuar për të shmangur diskrecionin e autoriteteve përkatëse tatimore dhe doganore mbi OJF-të që kryejnë veprimtari humanitare dhe bamirëse dhe kjo rrit potencialin për shënjestrim të panevojshëm dhe shumë të gjerë të këtyre OJF-ve për qëllime të luftës kundër FT-së.

## Vlerësimi i përshtatshmërisë së masave zbutëse – Kontaktimi (outreach) dhe Masat e OJF-ve


90. Kontaktimi nga ana e shtetit (outreach) i OJF-ve me veprimtari humanitare dhe bamirëse për çështjet e FT-së, si për të gjitha OJF-të e tjera, është i pamjaftueshëm. Kjo mbështetet nga gjetjet e anketimit me OJF-të, sipas të cilave 72% e këtij grupi të OJF-ve nuk janë në dijeni për masat e qeverisë për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit.

**Figura 7: Ndërgjegjësimi lidhur me masat e qeverisë i OJF-ve që raportojnë veprimtari të ndihmës humanitare (Burimi: Anketimi me OJF-të, nr.= 32 OJF)**



91. Në anketim iu kërkua OJF-ve të vetë-raportojnë mbi nëntë praktikat më të mira të cilat janë të rëndësishme për reduktimin e rreziqeve të FT-së. Sa i përket 32 OJF-ve me veprimtari humanitare dhe bamirëse që morën pjesë në anketim, pothuajse të gjitha (91%) raportuan aplikimin e praktikave më të mira në menaxhimin financiar, dhe (84%) në menaxhimin e projekteve. Duke iu referuar praktikave më të mira në financimin e terrorizmit, vërehet se një numër i vogël OJF-sh me veprimtari humanitare dhe bamirëse raportojnë zbatimin e tyre, ku vetëm 25% (8 OJF) raportojnë se kanë bërë vlerësimin formal të rrezikut të FT-së dhe 31% (10 OJF) raportojnë se trajnojnë stafin për rrezikun nga FT-ja.

**Figura 8: Praktikave më të mira të vetë-raportuara nga OJF-të që raportojnë veprimtari humanitare (Burimi: Anketimi me OJF-të, nr. = 32 OJF)**



## Vlerësimi i përgjithshëm

92. Aktiviteti i organizatave me veprimtari humanitare dhe bamirëse rregullohet nga i njëjti legjislacion (me disa përjashtime tatimore si më sipër) që rregullon sektorin e OJF-ve në Shqipëri. Për rrjedhojë, i njëjti vlerësim për masat zbutëse dhe kontaktimin nga institucionet shtetërore (outreach) si në analizën e mangësive (Seksioni D) zbatohet edhe për këtë grup OJF-sh.

93. Në lidhje me masat specifike vetërregulluese nga OJF-të me veprimtari humanitare dhe bamirëse, gjetjet nga anketimi me 153 OJF, tregojnë për një aplikim të gjerë të praktikave më të mira të menaxhimit organizativ midis këtij grupi OJF-sh.

94. Përshtatshmëria e masave zbatuese për OJF-të me veprimtari humanitare dhe bamirëse vlerësohet si E Mesme.

## Përshtatshmëria e Masave Zbutëse: OJF-të me aktivitet humanitar dhe bamirësie

### E MESME

95. Masat zbutëse efektive reduktojnë rrezikun e qenësishëm për të prodhuar një rrezik të përgjithshëm të mbetur:

$$(\text{Rreziku i Qenësishëm} - \text{Ndikimi i Masave Zbutëse}) = \text{Rreziku i Mbetur}$$

Kategoria e Rrezikut	Rreziku i Qenësishëm	Përshtatshmëria e Masave Zbutëse	Rreziku i Mbetur
OJF-të me veprimtari humanitare dhe bamirëse	I ulët deri në I mesëm	E mesme	I ulët - I mesëm

## Rekomandime

96. Legjislacioni ekzistues dytësor në lidhje me përfitimet tatimore dhe doganore të zbatueshme për veprimtarinë bamirëse dhe humanitare të OJF-ve duhet të përmirësohet me dispozita ligjore ose rregullore specifike. Së pari, kjo është e rëndësishme, sepse nga pikëpamja strikte ligjore, këto organizata kanë të drejtë të kenë përfitime efektive (disa përjashtime dhe lehtësime nga taksat dhe doganat) të cilat transferohen në dobi të grupeve të synuara që këto OJF i kushtojnë ndihmën e tyre humanitare dhe bamirësi. Së dyti, miratimi i dispozitave ligjore dhe rregulloreve specifike në aktet nënligjore do të ofrojë udhëzime më të mira për autoritetet përkatëse duke synuar shmangien e diskrecionit të autoriteteve publike, përfshirë autoritetet tatimore dhe doganore, dhe më pak shënjestrimin e këtyre OJF-ve për qëllime të luftës kundër FT-së, ndërkohë që këto autoritetet u japin këtyre OJF-ve miratime për përfitimet tatimore dhe doganore. Kjo gjithashtu do të stimulonte më tej veprimtarinë humanitare dhe bamirëse të OJF-ve në Shqipëri.
97. Çdo legjislacion i ri që do të miratohet në Shqipëri gjatë transpozimit ose përafrimit të legjislacionit përkatës të BE-së, i cili mund të sjellë kërkesa dhe përfitime shtesë për OJF-të me veprimtari bamirëse dhe humanitare, duhet të plotësohet edhe me legjislacionin dytësor që duhet të jetë specifik me kërkesa dhe procedura të qarta që synojnë shmangien e çdo diskrecioni nga autoritetet publike, dhe më pak kontroll të panevojshëm për qëllime të FT-së.
98. Autoritetet shtetërore përkatëse duhe të rrisin kontaktimin (outreach) e OJF-ve me aktivitet humanitar dhe bamirës për të rritur ndërgjegjësimin e tyre dhe për të diskutuar mbi faktorët e mundshëm që mund t'i ekspozojnë ato ndaj një rreziku më të lartë abuzimi për qëllime të FT-së, masat zbutëse për t'i shmangur ato dhe çështje të tjera përkatëse.

# F. VEPRIMTARIA BAMIRËSE DHE/OSE EDUKATIVE E ORGANIZATAVE FETARE

99. Vlerësimi i Rrezikut të Qenësishëm vë në dukje se rreziku me këtë grup organizatash mbështetet në mundësinë e shfrytëzimit për përhapjen e orientimeve radikale, duke ofruar ndihmë ekonomike dhe mbështetje financiare në formën e pensioneve për jetimët dhe familjet në nevojë, bursat, sponsorizimin e udhëtimeve në vendet e kultit, etj. Organizatat fetare konsiderohen se kanë aftësi më të mëdha për mbledhjen e fondeve dhe rrezik potencial për marrëdhënie me organizatat terroriste jashtë vendit. Të gjitha rastet që janë nën hetim për FT-në bien nën këtë kategori organizatash.
100. Kushtetuta e Shqipërisë (neni 10) parashikon se: Në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare. Shteti është asnjëanës në çështjet e besimit dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike. Shteti njihet barazim dhe bashkësi fetare. Shteti dhe bashkësitë fetare respektojnë në mënyrë të ndërsjelltë pavarësinë e njëri-tjetrit dhe bashkëpunojnë në të mirë të secilit dhe të të gjithëve. Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen nga Kuvendi i Shqipërisë. Bashkësitë fetare janë persona juridikë. Ato kanë pavarësi në administrimin e pasurisë së tyre sipas parimeve, rregullave dhe kanuneve të tyre, për sa kohë që nuk cenohen interesat e të tretëve.
101. Në Shqipëri ekzistojnë 5 (pesë) komunitete fetare të krijuara me marrëveshje me Republikën e Shqipërisë, si më poshtë: Selia e Shenjtë e Kishës Katolike, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë. Në bazë të këtyre marrëveshjeve, secili prej këtyre komuniteteve mund të krijojë OJF që kryejnë aktivitete humanitare dhe/ose arsimore në vend.
102. Në Shqipëri funksionojnë edhe komunitete të tjera fetare të regjistruara si OJF, të cilat nuk kanë marrëveshje me shtetin.
103. Komiteti Shtetëror për Kultet është autoriteti publik i autorizuar për të vendosur marrëdhënie ndërmjet shtetit dhe komuniteteve fetare dhe çdo lloj organizate të shoqërisë civile që ndjek qëllime fetare. Ai ka 5 (pesë) zyrtarë përgjegjës, të cilët ndjekin marrëdhëniet dhe çështjet që lidhen me 5 (pesë) komunitetet kryesore fetare dhe besimet e tjera fetare. Njëri prej tyre është përgjegjës edhe për marrëdhëniet me organizatat humanitare-fetare.
104. Ekzistenca e OJF-ve që kryejnë veprimtari humanitare dhe/ose edukative të cilat nuk janë krijuar dhe janë jashtë kontrollit të pesë komuniteteve fetare që kanë marrëveshje me Republikën e Shqipërisë, njihet dhe shprehet si shqetësim nga vetë komunitetet fetare, dhe autoritetet publike përkatëse.
105. Organizatat fetare grupohen nga DPT-ja së bashku me organizatat humanitare dhe bamirëse, duke përfaqësuar 3.1% të të gjitha organizatave të regjistruara në DPT (shih seksionin më lart). Nga anketa me 153 OJF, vetëm 2% e tyre kanë raportuar si fushë të veprimtarisë promovimin e besimit fetar.

Sipas Vlerësimit të Rrezikut të Qenësishëm,

Prevalenca e këtij faktori rreziku është **E ULËT** dhe Relevanca është **E LARTË**

## Vlerësimi i përshtatshmërisë së masave – Ligjet dhe Rregulloret

- 106.** Kuadri ligjor i zbatueshëm për OJF-të fetare që kryejnë veprimtari bamirësie dhe/ose edukative është në shumë aspekte i njëjtë si për të gjitha OJF-të e tjera. Masat e përgjithshme të zbatueshme për të gjitha OJF-të janë analizuar në seksionin D më lart.
- 107.** Megjithatë, ekziston një legjislacion specifik që parashikon përjashtime, lehtësime dhe/ose detyrime të zbatueshme për OJF-të e themeluara nga secili prej pesë komuniteteve fetare, të ndryshme nga përjashtimet, lehtësimet dhe/ose detyrimet e zbatueshme për të gjitha OJF-të e tjera. Marrëveshjet me pesë komunitetet dhe legjislacioni tjetër specifik përkatës janë renditur dhe analizuar më poshtë:
- ✓ Ligji nr.8902, datë 23.05.2002 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”
  - ✓ Ligji nr.9365, datë 31.03.2005 “Për procedurat e njohjes së aftësisë juridike të personave juridikë kishtarë të Kishës Katolike”.
  - ✓ Ligji nr.9865, datë 31.01.2008 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për disa çështje ekonomike dhe tatimore”.
  - ✓ Ligji nr.10056, datë 22.01.2009 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”.
  - ✓ Ligji nr.10057, datë 22.01.2009 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”.
  - ✓ Ligji nr.10058, datë 22.01.2009 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshit Botërore Bektashiane për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”.
  - ✓ Ligji nr.10394, datë 10.03.2011 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkësisë Fetare “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë” për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”.
  - ✓ Ligji nr.10140, datë 15.05.2009 “Për financimin nga buxheti i shtetit të Bashkësive Fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”.
- 108.** Për sa i përket formës ligjore të pranisë ligjore të komuniteteve fetare në Shqipëri, duhet shpjeguar se secila nga 5 (pesë) komunitetet fetare (dhe bashkimet fetare) janë persona juridikë të krijuar me ligj që kryejnë aktivitet jofitimprurës; ato nuk janë krijuar në Shqipëri si OJF. Megjithatë, këta persona juridikë janë të regjistruar në Regjistrin e OJF-ve.
- 109.** Përveç mangësive të identifikuar në seksionin D, të cilat janë të zbatueshme për të gjitha OJF-të, mangësitë e mëposhtme janë identifikuar në lidhje me aktivitetin bamirës dhe/ose edukativ të kryer nga organizatat fetare:
- 110.** Detyrimi për transparencë financiare dhe operacionale për OJF-të nuk zbatohet për komunitetet fetare (të cilët ekzistojnë si persona juridikë në bazë të marrëveshjes me Qeverinë Shqiptare) dhe për OJF-të e themeluara nga këto 5 (pesë) komunitete fetare në Shqipëri. Pra, masat e zbatueshme për OJF-të e tjera, si detyrimi për të mbajtur regjistër kontabël dhe për të paraqitur e deklaruar pasqyrat financiare pranë organeve tatimore, etj., nuk zbatohen për komunitetet fetare dhe OJF-të e themeluara nga 5 (pesë) komunitetet fetare, duke pasur parasysh përjashtimet shprehëse të parashikuara në marrëveshjet ndërmjet pesë bashkësive dhe Qeverisë Shqiptare.
- 111.** Në veçanti, OJF-të e themeluara nga komunitetet fetare përfitojnë nga përjashtimet që u jepen nëpërmjet marrëveshjeve me Qeverinë Shqiptare (të ratifikuara me ligj) për bashkësive fetare përkatëse. OJF-të e tjera të themeluara nga palë të tjera private ose organizata fetare që nuk kanë marrëveshje me Qeverinë Shqiptare, nuk i nënshtrohen (d.m.th. nuk përfitojnë) përjashtimeve që u jepen komuniteteve fetare dhe OJF-ve të themeluara prej tyre.
- 112.** Duke pasur parasysh këto përjashtime që zbatohen për OJF-të fetare në bazë të marrëveshjeve ndërmjet bashkësive fetare dhe Qeverisë Shqiptare, autoritetet e inspektimit tatimor nuk mund të kryejnë në mënyrë efektive të drejtën e tyre për të monitoruar dhe inspektuar veprimtarinë dhe financat e organizatave fetare që kryejnë veprimtari bamirësie dhe/ose edukative.



113. Legjislacioni nuk ofron udhëzime për aktivitetet që konsiderohen si bamirësi dhe aktivitete edukative të kryera nga organizatat fetare duke lënë hapësirë për diskrecion nga ana e autoriteteve publike përkatëse.

## Vlerësimi i përshtatshmërisë së masave – Kontaktimi (outreach) dhe Masat e OJF-ve

114. Duke pasur parasysh mangësitë në kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e organizatave fetare, autoritetet publike dhe mbikëqyrëse kanë perceptimin se të gjitha organizatat fetare i nënshtrohen të njëjtit rregullim ligjor (përfshirë ato që zbatohen për ato të krijuara nga 5 (pesë) bashkësitë fetare, zbatohen për të gjitha OJF-të fetare) prandaj mungon kontaktimi (outreach), dhe ato janë jashtë mbikëqyrjes shtetërore.
115. Vetëm 3 nga 153 OJF-të që morën pjesë në anketim janë organizata fetare. Siç përmendet në pjesën e metodologjisë së raportit, numri i organizatave fetare të përzgjedhura për t'u përfshirë në anketim ishte më i lartë, por ekipi i studimit u përball me vështirësi për t'i arritur, për shkak të pasaktësisë së informacionit të kontaktit të dhënë në faqet e tyre zyrtare ose mungesës së gatishmërisë për të marrë pjesë. Për rrjedhojë, të dhënat e mëposhtme jepen me rezerva, pasi sasia shumë e vogël e kampionimit e limiton aftësinë për të dalë me një vlerësim të besueshëm.
116. Dy (2) nga OJF-të fetare pjesëmarrëse në anketim janë fondacione dhe një (1) është qendër. Të tre organizatat i kanë selitë e tyre jashtë Tiranës. Të gjitha kanë raportuar të ardhura vjetore më pak se 5 milionë lekë.
117. Referuar burimit të të ardhurave nga kanale të ndryshme, 2 OJF raportuan se kishin marrë dhurime përmes bankave. Burime të tjera të të ardhurave janë grantet ose kontratat (1 OJF), dhurimet në para fizike (1 OJF) dhe mbështetja jo-financiare (1 OJF). Burimi i dhurimeve në para fizike (cash) është bërë nga individë privatë.
118. Këto OJF kryejnë aktivitete në fushat e ndihmës humanitare, edukimit shkencor dhe mësimi gjatë gjithë jetës, asistencës për grupet e marginalizuara dhe personave me aftësi të kufizuara dhe zhvillimit të vullnetarizmit.
119. Tre OJF-të fetare të anketuara raportojnë se kanë zbatuar praktikën më të mirë të qeverisjes dhe sistemet më të mira të menaxhimit të projekteve dhe financave.
120. Vetëm 1 (një) organizatë fetare raporton se kryen vlerësimin formal të rrezikut, dhe kujdesin e duhur të donatorëve dhe partnerëve. Gjithashtu, kjo organizatë deklaron se është e vetëdijshme për masat ose politikat e marra nga qeveria për të reduktuar rrezikun e financimit të terrorizmit për OJF-të, ligjet, rregulloret ose politikat e përgjithshme dhe specifike për financimin e terrorizmit, të cilat zbatohen edhe për sektorin dhe vetë organizatën. OJF-ja raporton se masat e miratuara janë efektive në reduktimin e rrezikut të mundshëm të FT-së.

## Vlerësimi i Përgjithshëm

121. Ratifikimi me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë i marrëveshjeve të lidhura nga bashkësitë fetare me Qeverinë Shqiptare (plotësuar nga miratimi i ligjeve që zbatohen në mënyrë të ngjashme për të pesë komunitetet fetare, si ligji nr.10140, datë 15.05.2009, etj.) është një garanci ligjore për mbrojtjen e të drejtave ligjore dhe kushtetuese të këtyre komuniteteve dhe ushtrimin e veprimtarisë së tyre bazuar në dispozitat ligjore.
122. Trajtimi i diferencuar i bashkësive fetare dhe OJF-ve të krijuara prej tyre, nëpërmjet aplikimit të përjashtimeve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse me Qeverinë Shqiptare, krijon konfuzion dhe pengesa për autoritetet shtetërore për të kontaktuar (outreach) dhe zbatuar masa efektive zbutëse të FT-së, jo vetëm ndaj këtij grupi, por për të gjitha grupet dhe subjektet e tjera fetare të regjistruara si OJF.

**Përshtatshmëria e Masave Zbutëse:**  
**Veprimtaria bamirëse dhe/ose edukative e organizatave fetare**  
**E ULËT**

Masat zbutëse efektive reduktojnë rrezikun e qenësishëm për të prodhuar një rrezik të përgjithshëm të mbetur:  
 (Rreziku i Qenësishëm – Ndikimi i Masave Zbutëse) = Rreziku i Mbetur

Kategoria e Rrezikut	Rreziku i Qenësishëm	Përshtatshmëria e Masave Zbutëse	Rreziku i Mbetur
Veprimtaria bamirëse dhe/ose edukative e organizatave fetare	I ulët deri në I mesëm	E ulët	I mesëm

## Rekomandime

- 123.** Miratimi i një Ligji për Besimet dhe Komunitetet Fetare në Shqipëri për të rregulluar të gjitha komunitetet fetare përkatëse në Shqipëri (d.m.th. të rregullojë të gjitha komunitetet fetare duke përfshirë edhe komunitetet fetare që janë të pranishme në Shqipëri në formën e OJF-ve duke qenë se këto të fundit nuk kanë statusin ligjor të komuniteteve pasi nuk kanë hyrë/nënshkruar marrëveshje të posaçme me Qeverinë Shqiptare si pesë komunitetet e tjera ligjore në Shqipëri).
- 124.** Legjislacioni duhet të sigurojë domosdoshmërinë e transparencës (financiare dhe operacionale) të OJF-ve të themeluara nga komunitetet fetare përkatëse, siç është paraqitja e pasqyrave financiare vjetore, publikimi i informacionit operacional dhe financiar, etj. Këto OJF të themeluara nga komunitetet përkatëse fetare duhet t'u nënshtrohet të njëjtave rregulla dhe detyrime si çdo OJF tjetër që nuk është themeluar nga komunitetet fetare.
- 125.** Legjislacioni duhet të parashikojë të drejtën e autoriteteve inspektuese për të pasur akses edhe në organizatat fetare që kryejnë veprimtari bamirëse dhe edukative për monitorimin efektiv të veprimtarisë së tyre. Njëkohësisht, legjislacioni duhet të hartohet qartë për të mbrojtur të drejtat përkatëse kushtetuese, d.m.th. për të vendosur ekuilibrin ndërmjet të drejtës kushtetuese për besimin fetar, etj., kundrejt interesit publik për sigurinë publike.

# G. SHUMA TË MËDHA TË FINANCIMEVE TË HUAJA NGA BURIME ME RREZIK TË LARTË

- 126.** Vlerësimi i Rrezikut të Qenësishëm vëren se transaksioni i një sasive të konsiderueshme parash që vijnë nga vendet e huaja, është një nga çështjet që konsiderohet si një faktor rreziku potencial për financimin e terrorizmit në OJF-ve. “Burimet me rrezik të lartë” i referohet vendit të origjinës, ose dërguesit specifik fillestar të fondeve.
- 127.** Rastet nën hetim të raportuara nga PSh-ja, përfshijnë transaksione të një sasive të konsiderueshme parash nëpërmjet sistemit bankar nga vende dhe organizata të huaja të konsideruara si burime me rrezik të lartë.
- 128.** Të dhënat tregojnë se financimi i huaj është burimi kryesor i të ardhurave për sektorin e OJF-ve në Shqipëri. Nga anketimi i realizuar me 153 OJF rezulton se shumica e tyre (86%) marrin fonde, mallra apo shërbime të huaja nga vende të tjera. Shumica e këtyre fondeve (92%) burojnë nga grante dhe kontrata me institucione shtetërore të huaja dhe janë të kanalizuar përmes sistemit bankar.
- 129.** Sipas të dhënave të BSH-së, të marra zyrtarisht nga DPT-ja dhe të ofruara për përgatitjen e këtij raporti, në kuadër të Marrëveshjes së Mirëkuptimit për zbatimin e Metodologjisë së Vlerësimit të Rrezikut të OJF-ve ndaj FT-së, financimet (flukset) e huaja për OJF-të në Shqipëri<sup>37</sup> në 3 vitet e fundit rezultojnë si më poshtë:

Viti	2019	2020	2021
Shuma	154,69 mln euro	162,34 mln euro	183,11 mln euro

Shuma maksimale e një transferte hyrëse është si më poshtë:

Viti	2019	2020	2021
Shuma maksimale	3,799,985 USD	5,000,000 CHF	1,999,975 CHF

Duke iu referuar vendit nga vijnë këto fonde, vihet re se shumica e fondeve të huaja vijnë nga vendet e BE-së, si Gjermania, Italia, Austria, Belgjika, Franca etj., Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përqindja e fondeve që vijnë nga juridiksionet e FATF-së nën monitorim të shtuar<sup>38</sup>, janë si vijon:

<sup>37</sup> Bazuar në informacionin dytësor që disa banka dhanë për Partnerët Shqipëri, kategoria e OJF-ve në sistemin bankar përfshin: 1) OJF-të e regjistruara në Shqipëri sipas ligjit për OJF-të; 2) agjencitë dhe projektet e ndihmës së huaj që zbatohen në Shqipëri, si agjencitë e Kombeve të Bashkuara.

<sup>38</sup> Juridiksionet nën monitorim të shtuar po punojnë në mënyrë aktive me FATF-në për të adresuar mangësitë strategjike në regjimet e tyre për të luftuar pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë. Kur FATF-ja vendos një juridiksion nën monitorim të shtuar, kjo do të thotë se vendi është angazhuar të zgjidhë me shpejtësi mangësitë strategjike të identifikuara brenda afateve kohore të rëna dakord dhe i nënshtrohet një monitorimi të shtuar. Kjo listë shpesh njihet nga jashtë si “lista gri”. FATF-ja nuk bën thirrje për zbatimin e masave të kujdesit të shtuar për këto juridiksione, por inkurajon anëtarët e saj dhe të gjitha juridiksionet që të marrin parasysh informacionin në analizën e tyre të rrezikut.

Këtu gjeni listën e juridiksioneve nën monitorim të shtuar [http://www.fatf-gafi.org/publications/high-risk-and-other-monitored-jurisdictions/?hf=10&b=0&s=desc\(fatf\\_releasedate\)](http://www.fatf-gafi.org/publications/high-risk-and-other-monitored-jurisdictions/?hf=10&b=0&s=desc(fatf_releasedate))

Viti	2019	2020	2021
% e fondeve të huaja që vijnë nga juridiksione nën monitorim të shtuar	4.32%	26.49%	3.17%

Vlen të theksohet se nga juridiksionet me rrezik të lartë të FATF-së<sup>39</sup> nuk ka patur fonde për sektorin e OJF-ve në Shqipëri.

130. Lidhur me flukset dalëse të OJF-ve, situatat paraqiten si më poshtë. Siç u përmend, ka një ndryshim të madh midis flukseve hyrëse dhe dalëse të OJF-ve drejt vendeve të tjera.

Viti	2019	2020	2021
Shuma	3.63 mln euro	2.95 mln euro	6.85 mln euro

Shuma maksimale e një transferte dalëse është si më poshtë:

Viti	2019	2020	2021
Shuma maksimale	972,190 CHF	402,468 EUR	5.000.000 USD

Sipas Vlerësimit të Rrezikut të Qenësishëm,  
Prevalenca e këtij faktori rreziku është **E ULËT**, dhe Relevanca është  
**E LARTË**

## Përshtatshmëria e masave zbutëse – Ligjet dhe Rregulloret

131. Sistemi ligjor për OJF-të që marrin fonde të huaja nga burime me rrezik të lartë është në shumicën e aspekteve i njëjtë si për të gjitha OJF-të, pavarësisht nga veprimtaria e tyre dhe forma ligjore e regjistrimit. Kjo është analizuar në seksionin D më sipër. Megjithatë, legjislacioni ose rregulloret specifike të mëposhtme zbatohen për këtë faktor rreziku dhe janë analizuar këtu në veçanti:

- ✓ Rregulloret e BSH-së dhe Rregulloret e AMF-së;
- ✓ Udhëzime Speciale të DPPPP;
- ✓ Legjislacioni tatimor dhe legjislacioni doganor;
- ✓ Ligji për OJF-të dhe Ligji për Regjistrimin e OJF-ve.

132. Ligji për OJF-të njeh si burim të ardhurash për OJF-të: fondet, grantet dhe dhurimet që vijnë nga subjekte publike dhe private vendase dhe të huaja.

133. Më tej, legjislacioni parashikon qartë të drejtat specifike të autoriteteve përkatëse të inspektimit për të pasur qasje tek organizatat përkatëse që marrin shuma të mëdha të financimeve të huaja nga burime me rrezik të lartë për monitorim efektiv të veprimtarisë së tyre.

134. Si konsideratë e përgjithshme, miratimi i legjislacionit të ri konsiderohet si efektiv për të zbutur rrezikun e FT-së në sektorin e OJF-ve (shih më lart seksionin D lidhur me vlerësimin e përshtatshmërisë së masave të aplikueshme për gjithë sektorin e OJF-ve).

135. Përveç mangësive që janë të zbatueshme për të gjitha OJF-të, mangësitë e mëposhtme janë identifikuar veçanërisht me marrjen e shumave të mëdha të financimeve të huaja nga burime me rrezik të lartë: Rregulloret ekzistuese të BSH-së kërkojnë kujdes të duhur të zgjeruar për transaksionet me “rrezik të lartë”. Raportimet nga OJF-të sugjerojnë se kjo interpretohet nga institucionet financiare në mënyrë të tillë që shumë transaksione rutinë të OJF-ve i nënshtrohen kujdesit të zgjeruar, duke përfshirë


<sup>39</sup> Juridiksionet me rrezik të lartë kanë mangësi të rëndësishme strategjike në regjimet e tyre për të luftuar pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë. Për të gjitha vendet e identifikuara si me rrezik të lartë, FATF-ja u bën thirrje të gjithë anëtarëve dhe u kërkon të gjitha juridiksioneve të aplikojnë vigjilencë të duhur të zgjeruar dhe, në rastet më serioze, vendeve u kërkohet të aplikojnë kundërmasa për të mbrojtur sistemin financiar ndërkombëtar nga rreziqet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes (ML/TF/PF) që vijnë nga vendi. Kjo listë shpesh njihet nga jashtë si “lista e zezë”. Këtu gjeni listën e juridiksioneve me rrezik të lartë [http://www.fatf-afg.org/publications/high-risk-and-other-monitored-jurisdictions/?hf=10&b=0&s=desc\(fatf\\_releasedate\)](http://www.fatf-afg.org/publications/high-risk-and-other-monitored-jurisdictions/?hf=10&b=0&s=desc(fatf_releasedate))

transaksione me vlerë të ulët dhe transaksione nga burime me rrezik të ulët. Ndërsa konsiderohet e mundshme që transaksionet më të mëdha ose transaksionet nga burime me rrezik të lartë kanë më shumë gjasa të përballen me masa të tilla, ne nuk kemi të dhëna specifike për të mbështetur këtë supozim. Kjo ka efektin praktik të frenimit të veprimtarisë legjitime të OJF-ve, e cila bie ndesh me kërkesat e Rezultatit të Menjëhershëm 10.2; dhe nuk do të ishte në përputhje me qasjen e synuar, të bazuar në rrezik dhe proporcionale të mandatuar sipas Rekomandimit 8. Ndikimi i mundshëm negativ i këtyre masave është aktualisht në shqyrtim nga FATF-ja si pjesë e punës së saj lidhur me ‘Pasojat e padëshiruara’.

## Vlerësimi i përshtatshmërisë së masave zbutëse – Kontaktimi (outreach) dhe Masat e OJF-ve


- 136.** Anketimi me OJF-të tregoi se vetëm 18 OJF (12%) nga 153 OJF të anketuara ishin në dijeni të rregullave për financimin e terrorizmit për bankat dhe institucionet financiare që prekin organizatën e tyre, dhe gjysma e tyre (9 OJF) raportuan se masat janë efektive në reduktimin e rrezikut të mundshëm të financimit të terrorizmit.
- 137.** Anketimi i OJF-ve zbuloi se vetëm 35% e OJF-ve ose 54 OJF kryejnë verifikimin e donatorëve të tyre. Shumica nga ky grup OJF-sh janë të regjistruara si qendra (48%).

**Figura 9: OJF-të sipas formës ligjore që raportojnë verifikim të donatorëve (Burimi: Anketimi me OJF-të, nr. = 54 OJF)**




- 138.** Për sa i përket të ardhurave të tyre vjetore, 37% e këtij grupi OJF-sh që raportojnë për kryerjen e vigjilencës së duhur ndaj donatorëve, raportojnë se kanë të ardhura vjetore më pak se 5 milionë lekë, ndërsa 22% e tyre raportojnë se kanë të ardhura vjetore mbi 30 milionë lekë.

**Figura 10: Të ardhurat vjetore të OJF-ve që raportojnë verifikim të donatorëve (Burimi: Anketimi me OJF-të, nr. = 54 OJF)**



**139.** Për sa i përket aktivitetit të tyre, 54% e këtij grupi OJF-sh raportojnë se kryejnë aktivitete që lidhen me grupet e marginalizuara dhe personat me aftësi të kufizuara; 41% merren me aktivitete që synojnë fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore, dhe 39% e tyre raportojnë se kryejnë aktivitete në fushën e demokracisë, qeverisjes së mirë e sundimit të ligjit, dhe trajnime profesionale.

**Figura 11: Aktivitetet e OJF-ve që raportojnë kryerjen e verifikimit të donatorëve (Burimi: Anketimi me OJF-të, nr. = 54 OJF)**



## Vlerësimi i Përgjithshëm

140. Ka disa të dhëna që sugjerojnë që institucionet financiare, në përputhje me rregulloret e BSH-së, imponojnë gjerësisht masa kontrolluese, sikurse vigjilenca e zgjeruar, duke përfshirë edhe transaksionet me vlerë të ulët apo me rrezik të ulët. Puna e FATF-së lidhur me “pasoja të padëshiruara” ka ekzaminuar mundësinë që kontrole të tilla mund të rrisin pa dashje rrezikun duke i shtyrë OJF-të të përdorin rrugë alternative financimi me rrezik më të lartë për marrjen e fondeve të huaja, dhe/ose mund të pengojnë aktivitetin legjitim të OJF-ve. Të gjitha masat e hartuara për zbutjen e FT-së duhet të jenë të bazuara në rrezik, të targetuara dhe proporcionale. Nuk demonstron që legjislacioni dhe udhëzuesit aktualë janë në përputhje me këto parime.

### Përshtatshmëria e Masave Zbutëse:

Shuma të mëdha të financimeve të huaja nga burime me rrezik të lartë

**E ULËT**

141. Masat zbutëse efektive reduktojnë rrezikun e qenësishëm për të prodhuar një rrezik të përgjithshëm të mbetur:

$(\text{Rreziku i Qenësishëm} - \text{Ndikimi i Masave Zbutëse}) = \text{Rreziku i Mbetur}$

Kategoria e Rrezikut	Rreziku i Qenësishëm	Përshtatshmëria e Masave Zbutëse	Rreziku i Mbetur
Shuma të mëdha të financimeve të huaja nga burime me rrezik të lartë	I ulët deri në I mesëm	E ulët	I mesëm

## Rekomandime

142. Banka e Shqipërisë duhet të këshillojë stafin përkatës dhe të gjitha institucionet financiare brenda Shqipërisë për konkluzionet e këtij raporti të vlerësimit të rrezikut.

143. Banka e Shqipërisë, institucionet financiare dhe përfaqësues nga sektori i OJF-ve (duke përfshirë përfaqësues nga subjektet 'në rrezik' të financimit të terrorizmit) duhet të formojnë një grup pune për të rishikuar udhëzimet dhe rregulloret aktuale të BSH-së për institucionet financiare për identifikimin dhe zbutjen e rreziqeve të mundshme të FT-së në transaksionet që përfshijnë OJF-të. Udhëzimi dhe rregulloret duhet të bazohen në kuptimin e faktorëve të rrezikut të përcaktuar në këtë raport dhe duhet të rishikohen periodikisht për të siguruar që ato të mbeten në përputhje me kuptimin më të fundit të rrezikut të FT-së për OJF-të në Shqipëri.

# H. PËRDORIMI I PARAVE FIZIKE (CASH) OSE TRANSAKSIONEVE ALTERNATIVE JASHTË SISTEMIT ZYRTAR BANKAR

144. Vlerësimi i Rrezikut të Qenësishëm vë në dukje se ekzistenca e një ekonomie informale të bazuar në para fizike (cash) në Shqipëri besohet të jetë një faktor që ndihmon grupet terroriste që mund të përfitojnë nga kjo për të financuar aktivitetin e tyre. Në nivel ndërkombëtar ka shqetësime në lidhje me përdorimin e parasë fizike (cash), kriptomonedhave, crowdfunding dhe mekanizmat alternativë të financimit pasi ato janë thellësisht më të vështira për t'u verifikuar, megjithëse ka pak raste të njohura që përfshijnë këto metoda në nivel global. Edhe pse në Shqipëri po përdoren disa iniciativa për mbledhjen e fondeve në para, të tilla si crowdfunding, evente për mbledhjen e fondeve, etj., rastet e njohura të FT-së në Shqipëri nuk lidhen me këta faktorë si veçori dhe prandaj, rëndësia vlerësohet si e ulët - e mesme.
145. Bazuar në intervistat me institucionet financiare, perceptohet se OJF-të që mbledhin fonde në mënyra jo të zakonshme si kriptovalutat, Paypal, etj., janë në rrezik më të lartë të FT-së. Por, nga anketimi i realizuar me 153 OJF, rezulton se asnjëra prej tyre nuk raporton që merr fonde nëpërmjet kanaleve jo-bankare, të tilla si ofruesit e shërbimeve monetare, apo kripto-valutat.

Sipas Vlerësimit të Rrezikut të Qenësishëm,  
Prevalenca e këtij faktori rreziku është **E ULËT - E MESME** për përdorimin e parave fizike (cash) dhe **ZERO** për përdorimin e transaksioneve alternative jashtë sistemit zyrtar bankar dhe Relevanca është **E ULËT - E MESME**.

## Vlerësimi i përshtatshmërisë së masave zbutëse – Ligjet dhe Rregulloret

146. Kuadri ligjor i zbatueshëm për OJF-të që përdorin para fizike (cash) ose transaksione alternative jashtë sistemit zyrtar bankar në shumicën e aspekteve është i njëjtë për të gjitha OJF-të dhe analizohet në seksionin D të këtij raporti. Megjithatë, legjislacioni apo rregulloret specifike të mëposhtme zbatohen për këtë faktor rreziku dhe janë analizuar më poshtë:
- ✓ Rregullorja e BSH-së, duke përfshirë rregulloret që lidhen me shërbimet dhe produktet specifike financiare (si karta krediti, paraja elektronike, etj.) që synojnë shmangien e përdorimit të parasë fizike (cash) në tregun shqiptar dhe që ofrojnë kujdesin e duhur që duhet të kryhet nga operatorët përkatës për identifikimin e duhur të klientëve të bankave dhe/ose të institucioneve financiare jobankë;




- ✓ Rregullorja e AMF-së që promovon shërbimet financiare përkatëse të ofruara nga operatorët nën regjimin rregullator të AMF-së dhe që ofron kujdesin e duhur që duhet të kryhet nga operatorët përkatës në lidhje me identifikimin e duhur të klientëve të tyre;
  - ✓ Ligjet tatimore dhe doganore dhe legjislacioni zbatues dytësor që rregullon ndër të tjera edhe pragun e përdorimit të parave fizike (cash) në Shqipëri dhe të parave hyrëse në territorin doganor shqiptar.
- 147.** Si konsideratë e përgjithshme, miratimi i legjislacionit të ri (siç përmendet në pikat përkatëse të lartpërmendura në seksionin D) konsiderohet si masë efektive për të zbutur rrezikun e FT-së në sektorin e OJF-ve.
- 148.** Ndërkohë që ekzistojnë kufizimet për transaksionet fizike (cash) mbi 150,000 lekë ndërmjet tatimpaguesve në Shqipëri, ka kërkesa të zbatueshme për të gjithë personat juridikë që të kenë të paktën 1 (një) llogari bankare dhe që çdo llogari bankare e mbajtur nga tatimpaguesit në Shqipëri ose jashtë shtetit duhet të deklarohet pranë organeve tatimore shqiptare.
- 149.** Sipas ndryshimeve të fundit të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në lidhje me çdo transfertë dalëse dhe hyrëse, ofruesit e shërbimeve të transferimit të parave ose vlerave dhe ofruesit e shërbimeve të aseteve virtuale, duhet të marrin informacion për emrin, mbiemrin, adresën, numrin e identifikimit të dokumentit ose numrin e llogarisë së dërguesit dhe përfituesit, si dhe emrin e institucionit financiar të përfshirë në transfertë.
- 150.** Dispozitat e ligjit tatimor dhe sistemi i ri i fiskalizimit tashmë i miratuar dhe i zbatuar, pritet të shfaqin ndikim pozitiv edhe në raportimin e shtuar të transaksioneve me bazë fizike (cash) dhe një kontroll më të mirë nga autoritetet.
- 151.** Megjithatë, ka një informalitet ekzistues në lidhje me transaksionet e ligjshme ndërmjet individëve dhe/ose personave juridikë dhe anasjelltas dhe, për rrjedhojë, kjo përbën një pengesë për autoritetet kompetente që të kenë informacion të saktë edhe për paratë fizike (cash) që mund të përdoren potencialisht për qëllime të FT-së.
- 152.** Kuadri ligjor dhe rregullator në lidhje me përdorimin e parave fizike (cash) ose të transaksioneve të tjera alternative jashtë sistemit zyrtar bankar është specifik: ai përcakton në mënyrë specifike kufizime në lidhje me detyrimin e tatimpaguesve, përfshirë OJF-të, për transaksionet bankare dhe nëpërmjet shërbimeve/produkteve të tjera bankare, të tilla si kartat e debitit/kreditit etj., si dhe për shumën maksimale në vit që mund të përdoret/transferohet me para fizike (cash), si dhe për shumën maksimale të parave fizike (cash) që mund të hyjnë në territorin doganor shqiptar pa u deklaruar në kufi, etj.
- 153.** Legjislacioni nuk rregullon shprehimisht dhurimet në para fizike (cash) për OJF-të. Gjithsesi, rregulloret e BSH shprehen që në rast se një klient do të depozitohet para fizike (cash), duhet të deklarohet me shkrim që paraja fizike (cash-i) e ka origjinën nga burime të ligjshme. Gjithsesi, kjo kërkesë/dispozitë ligjore nuk duhet të inkurajohet refuzimin nga bankat të parasë fizike (cash-it) të kërkuar për t'u depozituar nga OJF-të apo institucionet fetare (kisha, xhami, etj.)
- 154.** Bazuar në përvojën e vendeve të tjera, format e mbledhjes së fondeve përfshijnë apelimet në gazeta, dërgimet me postë, apelimet telefonike (telefonata të papritura), apelimet me tekst, me e-mail, mbledhjet e parave në internet dhe grumbullimin e fondeve në masë (crowdfunding), sponsorizimet, llotaritë, ngjarjet për mbledhjen e fondeve dhe partneritetet me korporata. Edhe pse disa nga këto forma përdoren edhe në Shqipëri, nuk ka ligje që mbulojnë këto forma të mbledhjes së fondeve dhe përdorimin e firmave profesionale për mbledhjen e fondeve. Mbledhjet e fondeve në internet (online) dhe crowdfunding, veçanërisht, janë lidhur me raste të njohura të FT-së në juridiksione të tjera.
- 155.** Dispozitat ligjore ekzistuese detyrojnë tatimpaguesit, përfshirë OJF-të, të kenë të paktën 1 (një) llogari bankare dhe të deklarohet çdo llogari bankare të mbajtur nga tatimpaguesi shqiptar (pavarësisht nëse mbahet në banka në Shqipëri apo diku tjetër) pranë organeve tatimore përkatëse; dispozitat në lidhje me pragun specifik për transfertat e lejuara të parave fizike (cash); dispozitat për sasinë maksimale të parave fizike (cash) që mund të hyjnë në territorin doganor shqiptar pa u deklaruar në kufi; marrja e informacionit të detajuar për dërguesin dhe përfituesin e parave fizike (cash) për transaksione alternative; fiskalizimi i faturës, etj., nga pikëpamja e përpiktë ligjore konsiderohen si masa ligjore efektive për të minimizuar transfertat e parave fizike (cash) apo transaksionet alternative jashtë sistemit zyrtar bankar.

## Vlerësimi i mjaftueshmërisë së masave – Kontaktimi (outreach) dhe Masat e OJF-ve

156. Anketimi me OJF-të identifikoi se kuadri ligjor për mbledhjen e fondeve që trajton rrezikun e financimit të terrorizmit nuk është i njohur nga OJF-të; vetëm 6 (gjashtë) nga 153 OJF të anketuara (4% e të anketuarve) deklaruan se janë në dijeni të këtij kuadri ligjor. Gjysma e të anketuarve që kishin dijeni për ligjet (3 OJF) janë të mendimit se masat janë efektive në reduktimin e rreziqeve të mundshme të financimit të terrorizmit.
157. Dhurimet në para fizike (cash) janë të rralla. Vetëm 6% e OJF-ve të anketuara raportojnë se marrin dhurime në para fizike (cash), të cilat përbëjnë më shumë se 5% të të ardhurave të tyre totale. Individët privatë kanë më shumë gjasa të dhurojnë me para fizike (cash).

Figura 12: Dhurime në para fizike (cash) (Burimi: Anketimi me OJF-të, nr. = 153 OJF)



## Vlerësimi i Përgjithshëm

158. Në përgjithësi, masat që lidhen me miratimin dhe zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve, si dhe ato që lidhen me masat e OJF-ve vlerësohen si efektive, me disa mangësi siç u përmend më lart, veçanërisht në lidhje me paranë fizike (cash) dhe përdorimin e sistemeve të tjera alternative të dërgesave. Ekziston një boshllëk në lidhje me format e reja të gjenerimit të të ardhurave, dhe disa prej tyre, si p.sh. crowdfunding, janë lidhur me raste të njohura të FT-së në juridiksione të tjera. Këto janë dëshmi se këto metoda po përdoren në Shqipëri, megjithëse ende nuk janë shfaqur lidhje me shqetësimet e TF-së. Kontaktimi (outreach), si në të gjitha fushat e tjera, mbetet problematike pa veprime nga autoritetet shtetërore për të ofruar informacion, për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të ofruar udhëzime për OJF-të në lidhje me kuadrin ligjor, rreziqet (përfshirë rreziqet e FT-së, praktikat më të mira ose dhurimin e sigurt)<sup>40</sup>.

Mjaftueshmëria e Masave Zbutëse: Përdorimi i parave fizike (cash) ose transaksioneve alternative jashtë sistemit zyrtar bankar

E ULËT deri në E MESME

<sup>40</sup> Fushatat e 'dhurimit të sigurt' i referohen fushatës ndërgjegjësuere që synon të edukojë publikun se çfarë duhet të shikojnë kur bëhet fjalë për dhurimin ndaj një organizate, për t'u siguruar që ata e dinë se fondet e tyre po përdoren për qëllime legjitime. Këto kujtesa mund të jenë në TV ose në reklama gazetash ose rrjete sociale për të edukuar publikun se çfarë është dhurimi i sigurt ose i pasigurt dhe si mund të duket..

159. Masat zbutëse efektive reduktojnë rrezikun e qenësishëm për të prodhuar një rrezik të përgjithshëm të mbetur:

$$(\text{Rreziku i Qenësishëm} - \text{Ndikimi i Masave Zbutëse}) = \text{Rreziku i Mbetur}$$

Kategoria e Rrezikut	Rreziku i Qenësishëm	Përshtatshmëria e Masave Zbutëse	Rreziku i Mbetur
Përdorimi i parave <i>cash</i> ose transaksioneve alternative	I ulët deri në I mesëm	E ulët deri në E mesme	I ulët deri në I mesëm

## Rekomandime

160. Autoritetet tatimore (duke përfshirë inspektorët tatimorë) dhe autoritetet e zbatimit të ligjit, duhet të zbatojnë ligjin dhe të veprojnë në mënyrë efektive duke synuar të maksimizojnë përdorimin e llogarive bankare dhe të shërbimeve dhe produkteve financiare nga OJF-të dhe të minimizojnë përdorimin e parave fizike (*cash*) dhe të transfertave alternative të sistemit bankar, sa herë që është e mundur pa prishur veprimtarinë dhe funksionimin legjitim të OJF-ve.
161. Bankat dhe institucionet financiare jobanka duhet të shpërndajnë dhe rrisin numrin e shërbimeve dhe produkteve bankare dhe financiare në të gjithë Shqipërinë, duke synuar uljen e potencialeve ekzistuese për përdorimin e parave fizike (*cash*) dhe të mënyrave të tjera alternative jashtë sistemit bankar.
162. Miratimi i rregulloreve në lidhje me fushatat për mbledhjen e fondeve në para fizike (*cash*) konsiderohet i nevojshëm. Rregullimi i mbledhjes së fondeve në para fizike (*cash*) në mënyrë proporcionale dhe efektive kërkon zgjidhje të projektuara me kujdes, të përshtatshme në nivel lokal. Mbledhja e fondeve në para fizike (*cash*) është nga natyra joformale dhe anonime. Apelet për fatkeqësitë, për nga natyra e tyre, nuk janë të planifikuara paraprakisht. Rregulloret duhet të pranojnë natyrën (dhe rreziqet) e disa metodave të mbledhjes së fondeve në para fizike (*cash*) dhe të mos i bëjnë ato të pamundura. Zgjidhjet do të duhet të përshtaten me nevojat e vendit dhe të zhvillohen në konsensus me sektorin e OJF-ve. Kjo do të kërkojë një paketë masash, të cilat do të synojnë hartimin dhe zbatimin e disa rregulloreve të brendshme të synuara me kujdes për OJF-të lidhur me organizimin dhe menaxhimin e iniciativave të mbledhjes së fondeve në para fizike (*cash*), të shoqëruara më promovimin e praktikave vetërregulluese, si kodet e sjelljes, praktikat më të mira dhe fushatat ndërgjegjësuese, si për OJF-të ashtu edhe për publikun.
163. Në rregulloren(et) përkatëse të BSH sugjerohet të shtohen dispozita specifike që do të lejojnë depozitimin e parave fizike (*cash*) nga fushatat e mbledhjes së fondeve të parave fizike (*cash*) të organizuara nga organizatat jofitimprurëse dhe subjektet fetare, nëse këto organizata kanë vullnetin të deklarojnë me shkrim se paratë vijnë nga fushatat për mbledhjen e fondeve në para fizike (*cash*) të organizuara prej tyre.
164. Duhet të merren parasysh masa të reja për format e tjera të mbledhjes së fondeve, duke përfshirë ato të renditura më sipër, me fokus të veçantë “online crowdfunding”. Edhe nëse këto praktika nuk janë ende të pranishme në Shqipëri, masat duhet të merren parasysh. Nga perspektiva e FT-së, disa nga këto mënyra joformale të mbledhjes së fondeve janë më të cënueshme se të tjerat.
165. Duke pasur parasysh mungesën e informacionit, gamën e çështjeve të përfshira dhe kompleksitetin e zgjidhjeve të mundshme, rekomandohet që të bëhet një rishikim i veçantë për praktikën e mbledhjes së fondeve në para fizike (*cash*) dhe mbikëqyrjen e tyre në Shqipëri. Rishikimi duhet të hulumtojë praktikën dhe nivelet aktuale të mbledhjes së fondeve në para *cash*; të identifikojë çdo kriminalitet ose sjellje tjetër të pahijshme; të rishikojë efektivitetin e ligjeve aktuale; të marrë parasysh zhvillimet në mbledhjen e fondeve në para *cash* dhe rregullimin e tij nga juridiksione të tjera dhe të propozojë një paketë masash për të zbutur rreziqet e mundshme.

# I. AKTIVITETE NË ZONA TË THELLA

166. Organeve mbikëqyrëse dhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit të anketuar dhe të intervistuar iu kërkua të identifikonin se cilët mund të jenë faktorët e mundshëm të rrezikut për financimin e terrorizmit në sektorin e OJF-ve. Vendndodhja e organizatës ishte një nga rreziqet e mundshme të përmendura prej tyre. Ata konsiderojnë se rreziku i FT-së përfshin OJF-të që punojnë në zona të njohura për aktivitet terrorist, OJF-të e vendosura në zona të thella, ose ato që nuk rinovojnë adresën e selisë së tyre në regjistrin e OJF-ve.
167. DPPP-ja deklaroi se nuk ka të dhëna për OJF-të e regjistruara në Shqipëri që operojnë në zona me potencial konflikti (konflikte civile).
168. Nuk ka të dhëna të disponueshme mbi numrin e OJF-ve dhe aktivitetet e tyre në zona të thella, por raportet mbi zhvillimin e sektorit të OJF-ve në Shqipëri ndër vite, tregojnë se ka një numër shumë të ulët të OJF-ve të vendosura dhe që ushtrojnë veprimtari në zona të thella.
169. Niveli i ulët i aktivitetit të OJF-ve dhe ritmet e larta të migrimit në këto zona sugjerojnë për nivel të ulët të rrezikut të abuzimit të OJF-ve në zonat e thella për qëllime të FT-së. Megjithatë, nevojiten kërkime të mëtejshme për të bërë një vlerësim të informuar mbi këtë faktor rreziku.

Sipas Vlerësimit të Rrezikut të Qenësishëm,  
Prevalenca e këtij faktori rreziku është **E PANJOHUR** dhe Relevanca është **E PANJOHUR**

## Vlerësimi i përshtatshmërisë së masave zbutëse – Ligjet dhe Rregulloret

170. OJF-të aktive në zona të thella i nënshtrohen të njëjtit regjim ligjor dhe rregullator që zbatohet për të gjitha OJF-të. Analiza dhe rekomandimet mbi kuadrin ligjor dhe rregullator të zbatueshëm për të gjitha OJF-të, siç janë përcaktuar më lart në seksionin D, janë të vlefshme edhe këtu.
171. Një veçori lidhur me regjistrimin aktual të OJF-ve është centralizimi i Regjistrimit të OJF-ve në Tiranë (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë). Kjo përbën shqetësim, sepse mund të zvogëlojë respektimin e regjistrimit nga grupet e shoqërisë civile në zona të thella dhe, për rrjedhojë, kufizon aftësinë e autoriteteve për të mbikëqyrur një grup të OJF-ve potencialisht më në rrezik ndaj FT-së.
172. Regjistrimi i OJF-ve nëpërmjet platformës online (në Regjistrin online të OJF-ve), parashikuar në ligjin e fundit për regjistrimin e OJF-ve, do të lehtësojë regjistrimin në regjistrin e OJF-ve, të OJF-ve që ushtrojnë veprimtari në zonat e thella të Shqipërisë dhe do të japë informacion për të gjitha OJF-të, duke mundësuar identifikimin e lehtë të vendndodhjes së këtyre organizatave dhe të aktiviteteve të tyre.
173. Rregullorja e BSH nuk parashikon detyrimin e rreptë të bankave të nivelit të dytë për të pasur degë në çdo zonë urbane dhe rurale të Shqipërisë; vendndodhja e degëve të bankave udhëhiqet mbi të gjitha nga kërkesa përkatëse për produkte dhe shërbime bankare.

## Vlerësimi i përshtatshmërisë së masave zbutëse – Kontaktimi dhe Masat e OJF-ve

174. Nuk kemi të dhëna specifike për zbatimin e praktikave më të mira nga OJF-të në zonat e thella.

175. Nuk kemi informacion specifik për depërtimin e autoriteteve shtetërore përkatëse në lidhje me OJF-të në zona të thella. Ka gjasa që largësia e popullsisë dhe mundësia e një shkalle më të ulët regjistrimi, do të thotë se çdo masë ka më pak gjasa të depërtojë në këtë grup OJF-sh.

## Vlerësimi i Përgjithshëm

176. Në mungesë të të dhënave specifike për OJF-të me bazë ose që veprojnë në zonat e thella të Shqipërisë, vlerësimi përfundimtar ofrohet me një shkallë më të lartë pasigurie në krahasim me faktorë të tjerë rreziku. Duket e arsyeshme të arrihet në përfundimin se efektiviteti i masave zbutëse për këtë grup OJF-sh është në rastin më të mirë i barabartë me efektivitetin e masave për sektorin e OJF-ve në tërësi dhe në praktikë mund të jetë dukshëm më pak efektiv.

### Përshtatshmëria e Masave Zbutëse: Aktivitete në zona të thella

#### E ULËT deri në E MESME

177. Masat zbutëse efektive reduktojnë rrezikun e qenësishëm për të prodhuar një rrezik të përgjithshëm të mbetur:

$$(\text{Rreziku i Qenësishëm} - \text{Ndikimi i Masave Zbutëse}) = \text{Rreziku i Mbetur}$$

Kategoria e Rrezikut	Rreziku i Qenësishëm	Përshtatshmëria e Masave Zbutëse	Rreziku i Mbetur
Aktivitete në zona të thella	I ulët deri në I mesëm	E ulët deri në E mesme	I ulët deri në I mesëm

## Rekomandime

178. Kryerja e kërkimeve të mëtejshme për OJF-të me bazë ose që operojnë në zona të thella të Shqipërisë, me qëllim:

- Identifikimin e nivelit të aksesit të popullsisë shqiptare që banon në zona të thella në procesin e regjistrimit të OJF-ve.
- Identifikimin e niveleve të përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret, veçanërisht me kërkesat e regjistrimit të OJF-ve.
- Identifikimin e çdo dobësie specifike ndaj abuzimit, duke përfshirë abuzimin me financimin e terrorizmit.
- Vlerësimin e ndërgjegjësimit të tyre për ligjet, rregulloret dhe praktikat më të mira në përgjithësi.

- Vlerësimin e ndërgjegjësimit të tyre për rreziqet dhe masat zbutëse që lidhen me abuzimin e mundshëm për qëllime të financimit të terrorizmit.
- Vlerësimin e nivelit të zbatimit të praktikave më të mira në qeverisjen, menaxhimin financiar dhe menaxhimin e projekteve të këtyre OJF-ve.

**179.** BSH dhe AMF duhet të inkurajojnë përkatësisht bankat (nën regjimin rregullator të BSH) dhe operatorët e tjerë financiarë jo-bankë (nën regjimin rregullator të AMF) të hapin dhe ofrojnë shërbime përmes degëve të tyre në zonat e thella për të lehtësuar përdorimin e shërbimeve dhe produkteve zyrtare financiare nga të gjitha OJF-të në Shqipëri.

# J. POLITIKA E RIVLERËSIMIT

**180.** Metodologjia e FATF-së thotë se:

*8.1 Vendet duhet të...*

*(d) vlerësojnë periodikisht sektorin duke rishikuar informacionin e ri mbi cënueshmërinë e mundshme të sektorit ndaj aktiviteteve terroriste për të siguruar zbatimin efektiv të masave."*

**181.** Vlerësimi i rrezikut është një pamje çasti, bazuar në provat e disponueshme dhe kontekstin e pranishëm në atë kohë. FATF-ja është e qartë se të kuptuarit dhe rishikimi i natyrës së rrezikut të TF-së duhet të jetë një proces i vazhdueshëm dhe në zhvillim.

**182.** Arsyet për një rivlerësim të plotë të rrezikut të qenësishëm dhe atij të mbetur janë:

- a. Një vlerësim zyrtar ndryshon ndjeshëm vlerësimin e rrezikut të TF-së për OJF-të. Publikimet zyrtare mund të përfshijnë Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut ose Vlerësimin e Rrezikut të Financimit të Terrorizmit. Vlerësimi mund ta shohë rrezikun më të lartë ose më të ulët se ky raport.
- b. Një vlerësim zyrtar ndryshon ndjeshëm vlerësimin e tij për kërcënimin e përgjithshëm të financimit të terrorizmit në Shqipëri. Ky mund të jetë një ndryshim i rëndësishëm në natyrën e kërcënimit të përgjithshëm, ose një ndryshim në vlerësimin e nivelit të kërcënimit të përgjithshëm.
- c. Një OJF vërtetohet se është e përfshirë në financimin e një incidenti terrorist në Shqipëri;
- d. Kanë kaluar pesë vite nga vlerësimi i fundit i plotë i rrezikut.

**183.** Një rivlerësim i pjesshëm do të marrë në konsideratë një ose më shumë faktorë rreziku specifik (rreziku i qenësishëm) dhe/ose përshtatshmërinë e masave zbutëse në lidhje me atë rrezik. Arsyet për një rivlerësim të pjesshëm të rrezikut të qenësishëm dhe/ose të mbetur janë:

- e. Një ndryshim i rëndësishëm në kuadrin ligjor ose rregullator në lidhje me faktorin e rrezikut;
- f. Një incident i financimit të terrorizmit ndodh në të cilin faktori i rrezikut është material;
- g. Një vlerësim zyrtar rivlerëson një faktor rreziku (qoftë ky më i lartë ose më i ulët).

# Shtojca 1: Rekomandimet e FATF-së të rëndësishme për OJF-të

## Rekomandimi 8 për Organizatat Jofitimprurëse

### 8. Organizatat Jofitimprurëse

Vendet duhet të rishikojnë përshtatshmërinë e ligjeve dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me grupimin e OJF-ve, të cilin vendi e ka identifikuar si më të cënueshëm për abuzim ndaj financimit të terrorizmit. Vendet duhet të ndërmarrin masa të përqëndruara dhe proporcionale, në linjë me qasjen e bazuar në rrezik, për këto OJF, në mënyrë që ti mbrojnë ato nga abuzimi i financimit të terrorizmit, duke përfshirë:

- organizatat terroriste, të cilat paraqiten si subjekte legjitime;
- shfrytëzimin e subjekteve legjitime si kanale për financimin e terrorizmit, përfshirë qëllimin e shmangies nga masat e ngrirjes së pasurive; dhe
- duke fshehur ose mbuluar devijimin e fondeve të destinuar për qëllime të ligjshme tek organizatat terroriste”.

Është shkëputur nga **Rekomandimet e FATF-së: Standartet Ndërkombëtare në Luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe Përhapjes së Armëve të Shkatërrimit në Masë** (FATF, Qershor 2016).

Metodologjia për Vlerësimin e Përputhjes Teknike me Rekomandimet e FATF-së dhe Efektivitetin e Sistemeve të PPP/LFT (FATF (2013)) ofron udhëzime për vlerësuesit mbi vlerësimin e përputhshmërisë me Rekomandimin 8. Ajo përcakton pyetjet që vlerësuesit duhet të kërkojnë përgjigje në procesin e Vlerësimit të Ndërsjelltë. Metodologjia për Rekomandimin 8 është si vijon:

### Ndërmarrja e një qasjeje të bazuar në rrezik

#### 8.1 Vendet duhet:

- Pa paragjykuar kërkesat e Rekomandimit 1, pasi që jo të gjitha OJF-të paraqesin një rrezik të lartë (disa mund të përfaqësojnë pak ose aspak rrezik), të identifikojnë se cili grup i organizatave bën pjesë në përkufizimin e OJF-ve sipas FATF-së. Për të arritur këtë, vendet duhet të përdorin të gjitha burimet përkatëse të informacionit, në mënyrë që të identifikojnë tiparet dhe llojet e OJF-ve të cilat për shkak të aktiviteteve ose veçorive të tyre, mund të jenë në rrezik nga abuzimi i financimit terrorist;
- Të identifikojnë natyrën e kërcënimeve nga ana e subjekteve terroriste drejt OJF-ve të cilat janë në rrezik, si dhe sesi subjektet terroriste abuzojnë me këto OJF;
- Të rishikojnë përshtatshmërinë e masave, përfshirë ligjet dhe rregulloret, që kanë të bëjnë me grupin e OJF-ve që mund të abuzohen për mbështetjen e financimit të terrorizmit në mënyrë që të jenë në gjendje të ndërmarrin veprime proporcionale dhe efektive për të adresuar rreziqet e identifikuara; dhe
- Vlerësojnë periodikisht sektorin duke rishikuar informacionin e ri mbi cënueshmërinë e mundshme të sektorit ndaj aktiviteteve terroriste për të siguruar zbatimin efektiv të masave.

### Shtrirje e qëndrueshme në lidhje me çështjet e financimit të terrorizmit

#### 8.2 Vendet duhet:

- Të kenë politika të qarta për të promovuar përgjegjshmërinë, integritetin dhe besimin e publikut në administrimin dhe menaxhimin e OJF-ve;
- Të inkurajojnë dhe të ndërmarrin programe arsimore dhe educative për të rritur dhe thelluar ndërgjegjësimin ndërmjet OJF-ve, si dhe komunitetit të donatorëve në lidhje me cënueshmërinë e mundshme të OJF-ve ndaj abuzimit të financimit të terrorizmit dhe risqeve të financimit të terrorizmit, dhe masat që OJF-të mund të marrin për të mbrojtur veten e tyre ndaj një abuzimi të tillë;



- c) Të punojnë me OJF-të për të zhvilluar dhe përmirësuar praktikat më të mira për të adresuar rreziqet dhe çënueshmëritë e financimit të terrorizmit dhe, në këtë mënyrë, t'i mbrojnë ato nga abuzimi i financimit të terrorizmit; dhe
- d) Të inkurajojnë OJF-të të kryejnë transaksione përmes kanaleve të rregulluara financiare, kurdo që të jetë e mundur, duke mbajtur parasysh kapacitetet e ndryshme të sektorëve financiarë në vende të ndryshme dhe fushave të ndryshme të problematikave urgjente bamirëse dhe humanitare.

### **Mbikqyrje apo monitorim i synuar i rrezikut të OJF-ve**

8.3 *Vendet duhet të ndërmarrin hapa për të promovuar mbikëqyrje ose monitorim efektiv, dhe ato janë në gjendje të tregojnë që masat e bazuara në rrezik aplikohen tek OJF-të, që janë në rrezik të abuzimit të financimit të terrorizmit.*

8.4 *Autoritetet përkatëse duhet:*

- a) Të monitorojnë pajtueshmërinë e OJF-ve me kërkesat e këtij Rekomandimi, përfshirë dhe masat e bazuara në rrezik që aplikohen për to, sipas 8.3; dhe
- b) Të jenë në gjendje të zbatojnë sanksione efektive, proporcionale dhe bindëse për shkeljet nga OJF-të ose personat që veprojnë në emër të këtyre OJF-ve.

### **Mbledhja dhe investigimi efektiv i informacionit**

8.5 *Vendet duhet:*

- a) Të sigurojnë bashkëpunim efektiv, koordinim dhe shkëmbim informacioni në masën e duhur ndërmjet të gjitha niveleve të autoriteteve të përshtatshme apo organizatave që zotërojnë informacion të rëndësishëm mbi OJF-të;
- b) Të kenë ekspertizë hetimore dhe aftësi për të shqytruar OJF-të e dyshuara ose të shfrytëzuara nga veprimtaritë terroriste apo që mbështesin aktivisht organizatat terroriste;
- c) Të sigurojnë që aksesit plotë në informacionin mbi administrimin dhe menaxhimin e OJF-ve specifike (përfshirë informacionin financiar dhe programatik) mund të merret gjatë një hetimi; dhe
- d) Të krijojnë mekanizma të përshtatshëm për tu siguruar se, kur ekziston dyshimi ose baza të arsyeshme për të dyshuar se një OJF specifike: (1) është e përfshirë në abuzimin e financimit të terrorizmit dhe/ose është fasadë për ngritjen e fondeve nga një organizatë terroriste; (2) po shfrytëzohet si një kanal për financimin e terrorizmit, duke përfshirë qëllimin e shmangies së masave të rrepta të ngrirjes së aseteve, ose formave të tjera të mbështetjes së terrorizmit; ose (3) është duke fshehur ose po abuzon me devijimin e paligjshëm të fondeve të destinuara për qëllime të ligjshme duke i përcjellë ato për përfitime të terroristëve ose organizatave terroriste, duhet që ky informacion të ndahet menjëherë me autoritetet përkatëse kompetente, në mënyrë që të marrin masa parandaluese ose hetimore.

### **Kapacitete efektive për t'iu përgjigjur kërkesave ndërkombëtare për informacion në lidhje me një OJF që ngjall shqetësim.**

8.6 *Vendet duhet të identifikojnë pikat e duhura të kontaktit dhe procedurat për t'iu përgjigjur kërkesave ndërkombëtare për informacion në lidhje me OJF specifike të dyshuara për financimin e terrorizmit ose përfshirje në forma të tjera të mbështetjes së terrorizmit.*

Shkëputur nga **Metodologjia për Vlerësimin e Përputhjes Teknike me Rekomandimet e FATF-së dhe Efektivitetin e Sistemeve të PPP/LFT (FATF, rishikuar Shkurt 2019)**

## Rezultati i Drejtëpërdrejtë 10

☞ **Rezultati i drejtëpërdrejtë 10:** Terroristët, organizatat terroriste dhe financuesit e terrorizmit pengohen nga mbledhja, lëvizja dhe përdorimi i fondeve, si dhe nga abuzimi me sektorin e OJF-ve.

**Karakteristikat e një sistemi efektiv:** Terroristët, organizatat terroriste dhe rrjetet e mbështetjes terroriste identifikohen dhe privohen nga burimet dhe mjetet për të financuar ose mbështetur aktivitetet dhe organizatat terroriste. Kjo përfshin zbatimin e duhur të sanksioneve financiare të synuara kundër personave dhe subjekteve të përcaktuara nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara dhe sipas regjimeve të zbatueshme të sanksioneve kombëtare ose rajonale. Vendi gjithashtu ka një kuptim të mirë të rreziqeve të financimit të terrorizmit dhe ndërmer veprime të përshtatshme dhe proporcionale për të zbutur këto rreziqe, duke përfshirë masat që parandalojnë mbledhjen dhe lëvizjen e fondeve përmes subjekteve ose metodave që janë në rrezikun më të madh për t'u keqpërdorur nga terroristët. Në fund të fundit, kjo redukton flukset e financimit të terrorizmit, gjë që do të parandalonte aktet terroriste. Ky rezultat lidhet kryesisht me Rekomandimet 1, 4, 6 dhe 8, si dhe me elementet e Rekomandimeve 14, 16, 30 deri në 32, 37, 38 dhe 40."

IO.10 ofron shembuj informacioni që mund të mbështesin konkluzionet e vlerësuesve:

### ☞ a) Shembuj informacioni që mund të mbështesin konkluzionet mbi çështjet thelbësore

1. Përvojat e autoriteteve të zbatimit të ligjit, NjIF dhe kundër terrorizmit (p.sh., tendencat që tregojnë se financuesit e terrorizmit po hulumtojnë metoda alternative për mbledhjen/transmetimin e fondeve; raportimi i inteligjencës/burimit që tregon se organizatat terroriste kanë vështirësi në mbledhjen e fondeve në vend).
2. Shembuj të ndërhyrjeve dhe konfiskimeve (p.sh.; ... hetimet dhe ndërhyrjet në OJF-të e keqpërdorura nga terroristët).
- ...4. Informacion mbi mbikëqyrjen dhe monitorimin e OJF-ve (p.sh. shpeshtësia e rishikimit dhe monitorimit të sektorit të OJF-ve (përfshirë vlerësimet e rrezikut); shpeshtësia e angazhimit dhe komunikimit (përfshirë udhëzimet) ndaj sektorit të OJF-ve në lidhje me masat dhe tendencat e CFT-së; masat korrigjuese dhe sanksionet e marra ndaj OJF-ve)."

Më tej jep shembuj të faktorëve specifikë që mund të mbështesin konkluzionet e vlerësuesve.

### ☞ b) Shembuj të Faktorëve Specifikë që mund të mbështesin konkluzionet mbi çështjet thelbësore

- ...10. Cili është niveli i licencimit apo regjistrimit për OJF-të? Deri në çfarë mase ndërmerret një qasje e ndjeshme ndaj rrezikut për të mbikëqyrur ose monitoruar OJF-të në rrezik nga abuzimi terrorist dhe miratohen veprimet dhe mekanizmat e duhur të bashkëpunimit parandalues, hetimor, penal, civil ose administrativ?
11. Sa mirë i kuptojnë OJF-të dobësitë e tyre dhe i respektojnë masat për t'u mbrojtur nga kërcënimi i abuzimit terrorist?"

Metodologjia për Vlerësimin e Përputhshmërisë Teknike ofron 'Shënime për Vlerësuesit' se si të vlerësohet IO.10. Shënimet që lidhen me OJF-të janë si më poshtë:

☞ **Shënim për vlerësuesit:** Vlerësuesit duhet gjithashtu të marrin në konsideratë gjetjet përkatëse mbi nivelin e bashkëpunimit ndërkombëtar në të cilin po marrin pjesë autoritetet kompetente kur vlerësojnë këtë Rezultat të Menjëhershëm.

**Çështjet thelbësore që duhen marrë parasysh në përcaktimin nëse Rezultati është duke u arritur.**

...10.2. Deri në çfarë mase, pa ndërprerë aktivitetet legjitime të OJF-ve, vendi ka zbatuar një qasje të synuar, ka kryer kontakte dhe ka ushtruar mbikëqyrje në trajtimin e OJF-ve që janë në rrezik nga kërcënimi i abuzimit terrorist?...

...10.4. Deri në çfarë mase masat e mësipërme janë në përputhje me profilin e përgjithshëm të rrezikut të TF?"

Shkëputur nga **Metodologjia për Vlerësimin e Përputhjes Teknike me Rekomandimet e FATF-së dhe Efektivitetin e Sistemeve të PPP/LFT (FATF, 2013)**



# METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË RREZIKUT TË OJF-VE NDAJ FINANCIMIT TË TERRORIZMIT NË SHQIPËRI



## KONTAKT

**Partnerët Shqipëri për Ndryshim  
dhe Zhvillim**

Rruga e Elbasanit, Ndërtesa Park  
Gate, kati 10, Ap.71/73  
Tiranë

[www.partnersalbania.org](http://www.partnersalbania.org)  
[partners@partnersalbania.org](mailto:partners@partnersalbania.org)